**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE PUNONJËSVE ARSIMOR

EDICIONI I GJASHTË

Prishtinë, 2022

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE PUNONJËSVE ARSIMOR

EDICIONI I GJASHTË

Prishtinë, 2022

**Botues:**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)*

Përgatitur nga:

Osman Beka

Habibe Buzuku

Dizajni:

**Katalogu i programeve të aprovuara nga MASHTI-i për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimor është në dispozicion për shkarkim në uebfaqe të MASHTI-it:**

**http://www.masht-gov.net**

| Nr. | Titujt e programeve të aprovuara të katalogut të edicionit të gjashtë 2022 për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Punonjësve Arsimor | Organizata | Faqe |
|---|---|---|---|
| 1 | AKTIVITETET E PARAPARA NË SHKOLLË NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË NDËRLIDHURA ME ORIENTIMIN NË KARRIERË | Smart Bits LuxDev ProjectKSV/022 | 8 |
| 2 | BUSULLA COM -5 HAPAT E ORIENTIMIT NË KARRIERË | Smart Bits LuxDev ProjectKSV/021 | 10 |
| 4 | CERTIFIKIMI PËR DREJTUES TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR | BEINT | 12 |
| 5 | CERTIFIKIMI PËR VLERËSUES TË PËRFORMANCËS TË IAAP DHE MËSIMDHËNËSVE | BEINT | 16 |
| 6 | E DREJTA PËR PËRFAQËSIM PUBLIK - AVOKIMI | KEC | 20 |
| 7 | EDUKIMI DHE ZHVILLIMI I INTEGRUAR NË FËMIJËRI TË HERSHME | FAKULTETI I EDUKIMIT | 21 |
| 8 | EDUKIMI MUZIKOR DHE ASPEKTE TË RËNDËSISHME NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES SË INTEGRUAR/DIFERENCUAR | EDUMEN-K | 24 |
| 9 | EDUKIMI PËR DEMOKRACINË DHE TË DREJTAT E NJERIUT | KEC | 26 |
| 10 | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE | KEC | 29 |
| 11 | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE - AKTIVITETE PËR KLASË | KEC | 31 |
| 12 | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE - AKTIVITETE PËR TË RRITUR DHE FËMIJË | KEC | 33 |
| 13 | EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI | ABSM | 36 |
| 14 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI AVANCUES PËR EDUKATORË QË PUNOJNË ME FËMIJË TË MOSHAVE 3-6 VJEÇARE | KEC | 37 |
| 15 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI AVANCUES PËR KLASËN E PARË | KEC | 39 |
| 16 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI AVANCUES PËR MOTRA EDUKATORE/EDUKATORET QË PUNOJNË ME FËMIJË TË MOSHËS 0-3 VJEÇARE | KEC | 41 |
| 17 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI FILLESTAR PËR EDUKATORË QË PUNOJNË ME FËMIJË TË MOSHAVE 3-6 VJEÇ | KEC | 43 |
| 18 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI FILLESTAR PËR KLASËN E PARË | KEC | 45 |
| 19 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI PËR KLASËN E KATËRT | KEC | 47 |
| 20 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI PËR MENTOR PËR NGRITJE TË CILËSISË SË MËSIMDHËNIES | KEC | 49 |
| 21 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI FILLESTAR PËR MOTRA EDUKATORE/EDUKATORET QË PUNOJNË ME FËMIJË TË MOSHËS 0-3 VJEÇARE | KEC | 51 |
| 22 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI PËR KLASËN E DYTË | KEC | 53 |
| 23 | HAP PAS HAPI TRAJNIMI PËR KLASËN E TRETË | KEC | 55 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 24 | **HARTIMI DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE NË FUSHËN E ARSIMIT** | **EDUMEN-K** | **57** |
| 25 | **HULUMTIMI NË VEPRIM** | **KEC** | **59** |
| 26 | **IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIME DHE AZHURIMIN E STANDARDEVE TË PROFESIONIT PËRMES TNA/SKNA** | **Smart Bits LuxDev ProjectKSV/026** | **60** |
| 27 | **IDENTIFIKIMI I NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË TË NXËNË** | **EDUMEN-K** | **62** |
| 28 | **IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË FËMIJËVE NË KOPSHT DHE NË SHKOLLË** | **KONICA** | **65** |
| 29 | **KËSHILLIMI DHE ORIENTIMI NË KARRIERË** | **KEC** | **67** |
| 30 | **KLASA E ORIENTUAR KAH NXËNËSI** | **KEC** | **69** |
| 31 | **KLUBI I TEKNIKËVE** | **KEC** | **71** |
| 32 | **KNF DHE PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE PËR VLERËSIMIN PEDAGOGJIK TË NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANT** | **Save the Children** | **73** |
| 33 | **KOORDINIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL ME BAZË NË SHKOLLË** | **KEC** | **75** |
| 34 | **KRIJIMI DHE MENAXHIMI I BANKËS SË PYETJEVE** | **Smart Bits LuxDev ProjectKSV/029** | **77** |
| 35 | **KRIJIMI DHE PUBLIKIMI I TESTEVE** | **Smart Bits LuxDev ProjectKSV/020** | **79** |
| 36 | **MBËSHTETJA PSIKOSOCIALE ,TË MËSUARIT SOCIO-EMOCIONAL DHE MIRËQENIA E MËSIMDHËNËSVE** | **Save the Children** | **81** |
| 37 | **MENAXHIMI I STRESIT TEK NXËNËSIT PAS PANDEMISË COVID-19, VEPRIMET PARANDALUESE TË ATAKIMIT TË JETËS SË NJERËZVE NË TË ARDHMEN** | **EDUMEN-K** | **83** |
| 38 | **MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH)** | **KEC** | **86** |
| 39 | **MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH) PROGRAMI PËR TRAJNERË** | **KEC** | **89** |
| 40 | **MËSIMDHËNIA ONLINE NË NIVELIN E DUHUR** | **KCDE** | **91** |
| 41 | **MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE** | **KEC** | **94** |
| 42 | **METODA E KORNIZËS LOGJIKE** | **KEC** | **96** |
| 43 | **METODOLOGJI INTERAKTIVE E MËSIMDHËNIES** | **KONICA** | **97** |
| 44 | **METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES NË SEKSION MUZIKORË INSTRUMENTAL** | **EDUMEN-K** | **99** |
| 45 | **METODOLOGJITË BASHKOHORE NË MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE NË LËNDËN E HITORISË** | **EDUMEN-K** | **102** |
| 46 | **MODULI 2 MUNDËSIMI I TË MËSUARIT PËR TË GJITHË** | **Këshilli i Evropës** | **106** |
| 47 | **NDËRLIDHJA E SHKOLLAVE ME TREGUN E PUNËS** | **Smart Bits LuxDev ProjectKSV/025** | **109** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 48 | NDËRMARRËSIA DHE EDUKIMI FINANCIAR | KEC | 111 |
| 49 | ORIENTIMI NË KARRIERË -NJOHURI TË PËRGJITHSHME | Smart Bits LuxDev ProjectKSV/024 | 112 |
| 50 | PEDAGOGJIA E EDUKIMIT PSIKO-FIZIK DHE SHËNDETËSOR | EDUMEN-K | 114 |
| 51 | PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE | QAPA | 117 |
| 52 | PËRGATITJA E EKIPIT VLERËSUES NË NIVEL SHKOLLE DHE KOMUNE PËR PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË VLERËSIMIT PEDAGOGJIK TË NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FUNKSIONIMIT, AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE SHËNDETIT (KNF-FR) | MEM | 120 |
| 53 | PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES PRODUKTIVE | KONICA | 122 |
| 54 | PLANIFIKIMI I PROJEKTEVE SHKOLLORE | KEC | 124 |
| 55 | PLANIFIKIMI SIPAS NEVOJAVE TE NXËNËSIT (NXËNËS ME NEVOJA TE VEÇANTA). HARTIMI I PLANIT INDIVIDUAL I ARSIMIT PIA | EDUMEN-K | 126 |
| 56 | PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR TË RINJTË | YIHR-K. | 128 |
| 57 | QASJA DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA | EDUMEN-K | 130 |
| 58 | ROLI I AKTIVITETEVE KREATIVE NE MESIMDHENIE DHE ZBATIMI I TYRE NE SHKOLLA FILLORE | SBASHK | 133 |
| 59 | ROLI I BUSULLA .COM NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE PËR ORIENTIMIN NË KARRIERË TË PARAPARA NË KORNIZËN KURRIKULARE DHE KURRIKULAT BËRTHAMË | Smart Bits LuxDev ProjectKSV/028 | 136 |
| 60 | ROLI I MËSIMDHËNËSVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA FORMAT E RREZIKSHME TË PUNËS | SBASHK | 138 |
| 61 | SHKATHTËSITË E BUTA NË KURRIKULIN SHKOLLOR | KEC | 143 |
| 62 | SHKATHTËSITË PËR ZHVILLIM PERSONAL | KEC | 145 |
| 63 | SHKOLLA GJITHPËRFSHIRËSE QË MBËSHTETË ARSIMIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN DHE FËMIJËT E KTHYER | INSTITUTI PEDAGOGJIK | 174 |
| 64 | SHPREHITË PËR ADOLESHENCËN | LONS CLUB | 150 |
| 65 | SISTEMIMI I MONITORIMIT DHE EVALUIMIT -SIGURIMI I CILËSISË NË SHKOLLA | Smart Bits LuxDev ProjectKSV/027 | 153 |
| 66 | STANDARDET E FASILITIMIT PËR KRYEFASILITUESIT E TË NXËNIT | KEC | 155 |
| 67 | STANDARDET E FASILITIMIT TË TË NXËNIT | KEC | 156 |
| 68 | Të Gjithë Lojëtarë Të Gjithë Miq | | 157 |
| 69 | TË MËSUARIT E KOMBINUAR (BLENDED LEARNING ) | QAPA | 160 |
| 70 | TË MËSUARIT PËRMES TEKNOLOGJISË – PËRDORIMI I PROGRAMEVE APLIKATIVE | KONICA | 162 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 71 | **TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR ORIENTIM, KËSHILLIM NË KARRIERË** | **ABSM** | **164** |
| 72 | **TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR PARANDALIM, IDENTIFIKIM TRAJTIM APO REFERIM TË LLOJEVE TË DHUNËS NË SHKOLLË** | **SYRI VIZION** | **166** |
| 73 | **TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR PUNË ME TË RRITUR.** | **IPK** | **168** |
| 74 | **TRAJNIMI I TRAJNERËVE PËR PUNË ME TË RRITUR** | **KEC** | **172** |
| 75 | **TRAJNIMI PËR KOMPETENCAT E EDUKATORËVE QË PUNOJNË ME FËMIJË TË MOSHAVE 3-6 VJEÇ** | **KEC** | **174** |
| 76 | **UDHËHEQJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË KOSOVË** | **KCIC** | **176** |
| 77 | **VLERËSIMI I NXËNËSVE SIPAS KURRIKULËS SË BAZUAR NË KOMPETENCA** | **KONICA** | **179** |
| 78 | **VLERËSIMI I POTENCIALIT DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË TESTEVE TË VETË-NJOHJES** | **Smart Bits LuxDev ProjectKSV/023** | **182** |
| 79 | **VLERËSIMI PËR TË NXËNË** | **KEC** | **184** |
| 80 | **ZHVILLIM PROFESIONAL PËR MËSIMDHËNËS TË GJUHËS ANGLEZE** | **Korpusi i Paqes** | **186** |
| 81 | **ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË LEXIMIT NË KLASAT E HERSHME** | **KEC** | **189** |
| 82 | **ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË SHEKULLIT 21 NË LËNDËN E MATEMATIKËS** | **KEC** | **190** |
| 83 | **ZHVILLIMI I TË MENDUARIT KRITIK DHE KREATIV TEK NXËNËSIT NË ARSIMIN FILLOR** | **EDUMEN-K** | **193** |

*HYRJE*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në përputhje me UA 06/2017,* për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimor, ka aprovuar ofertuesit dhe programet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Bazuar në të dhënat në dispozicion të MASHTI, përkatësisht Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve (KSHLM), është përgatitur botimi i i katalogut të programeve trajnuese.

Në këtë katalog janë përfshirë ofertuesit e aprovuar dhe programet e aprovuara në vitin 2022.

Katalogu ofron një përshkrim të përgjithshëm të ofertuesve të programeve trajnuese duke përfshirë kontaktin dhe adresën e tyre. Ndërsa, programet trajnuese të secilit ofertues janë përshkruar në mënyrë më specifike, sipas formularit të caktuar nga MASHTI dhe të plotësuar nga ofertuesit e programit. *Përshkrimi i programeve përmban: tipin e programit, ofertuesin, kohëzgjatjen, përfituesit, rezultatet e pritura, përmbajtjen, metodologjinë dhe procesin e certifikimit, numrin e trajnerëve dhe datën e aplikimit***.** Të gjitha këto informacione janë të rëndësishme sepse me rastin e licencimit, rilicencimit apo avancimit në karrierë mësimdhënësit duhet të ofrojnë dëshmi për përfundimin me sukses të programeve themelore dhe atyre plotësuese për zhvillim profesional.

Kërkesat dhe kriteret për përfundimin me sukses të trajnimeve në programe bazike apo plotësuese janë përcaktuar me *UA- 05/2017* për sistemin e licencimit dhe zhvillimin në karrierë të mësimdhënësve. Përmbajtja e programeve të trajnimit do të ndihmojë mësimdhënësit të identifikojnë programet, vijueshmëria e të cilave do të ndihmojë ata/o të avancohen gjatë karrieres dhe të arrijnë standardet e mësimdhënies të përcaktuara me *Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, 2017.*

Përfundimi me suksese i programeve themelore dhe plotësuese do të ndikojë në rritjen e nivelit të performancës së mësimdhënësve.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **Aktivitetet e parapara në shkollë në përmbushjen e objektivave të ndërlidhura me orientimin në karrierë** |
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044/168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **58/58, 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 8 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Të kuptoj rëndësinë e orientimit në karrierë<br>• T'i identifikoj aktivitetet kyçe për orientim në karrierë<br>• Të dijë t'i planifikoj aktivitetet përgjatë klasave VI – XII<br>• Të përgatisë leksione për Orientim në Karrierë drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga planet dhe programet mësimore<br>• Të jetë i aftë për të iniciuar projekte që ndërlidhen me orientimin e nxënësve dhe edukimin e tyre në karrierë<br>• Të jetë i aftë për të përpiluar planin vjetor të aktiviteteve për orientim në karrierë të koordinuar me mësimdhënës tjerë.<br>• Të njeh rolin dhe rëndësinë e platformës online per këshillim dhe edukim ne karriere Busulla.COM, |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br><br>• Njohja me aktivitetet jashtë-kurrikulare shkollore<br>• Ndërlidhja e aktiviteteve me Kornizën Kurrikulare<br>• Njohja me mundësitë e shkollimit dhe aftësimit profesional pas përfundimit të shkollës së mesme<br>• Organizimi i Ditës së Dyerve të Hapura për ofruesit e arsimit të lartë dhe qendrat trajnuese<br>• Njohja me konceptin e Javës së Karrierës |

| | |
|---|---|
| | • Njohja me rëndësinë dhe përfitimet e Panairit të Punës<br>• Zhvillimi i projekteve të Klubeve të Karrierës<br>• Përgatitja e punëtorive për orientim në karrierë dhe ndërmarrësi<br>• Zhvillimi i projekteve të Klubeve të Karrierës në gjimnaze<br>Njohja dhe zhvillimi i sesioneve informuese ma maturantë |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor**<br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë mëtej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, metoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **Busulla.COM - 5 hapat e orientimit në karrierë** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor - plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **57/57, 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 8 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Përdorimin e platformës për Orientim në Karrierë, Busulla.COM<br>• Ndërlidhjen e platformës Busulla.COM në procesin mësimor<br>• Realizimin e objektivave që dalin nga Korniza Kurrikulare dhe Kurrikula Bërthamë te Arsimit të Mesëm te Ulët dhe Mesëm të Lartë, te ndërlidhura me Orientim në Karrierë<br>• Krijimin e ndërlidhjeve me fushat tjera kurrikulare |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Shpjegoj 5 hapat e orientimit në karrierë<br>• Shpjegoj funksionet kyçe të platformës zyrtare të MASHT-it për orientim në karrierë, Busulla.COM<br>• Monitoroj progresin e nxënësve përmes veglave të platformës Busulla.COM<br>• Shtjelloj testet e karrierës, siç janë testi Interesave, testi i vlerave dhe testi i aftësive<br>• Eksploroj profesionet, shkollat dhe universitet, si dhe identifikoj pozita të lira të punës dhe praktikës<br>• Shfrytëzoj modulin e Këshilltarit për t'u ofruar nxënësve mbështetje në procesin e orientimit në karrierë |

| | |
|---|---|
| | |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor** Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër** Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte** Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor** Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

<table>
<tr><td>Titulli i Programit</td><td>Certifikimi për Drejtues të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitare</td></tr>
<tr><td>Titulli i organizatës</td><td>BEINT - International Business Education</td></tr>
<tr><td>Tipi i programit:</td><td>Program trajnues themelor</td></tr>
<tr><td>Ofertuesi i programit:</td><td>BEINT</td></tr>
<tr><td>Adresa:</td><td>Rr. “Nazim Gafurri”, nr.15, Prishtinë</td></tr>
<tr><td>E-mail:</td><td>info@beint.org</td></tr>
<tr><td>Telefoni:</td><td>+383 44 500 388</td></tr>
<tr><td>Numrat dhe data e aprovimit:</td><td>Nr. 81/81, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite</td></tr>
<tr><td>Kohëzgjatja e programit (orë)</td><td>Programi shtrihet në 9 muaj. Programi shumicen e rasteve zhvillohet fundjavë (e premte dhe e shtunë) duke mos penguar kështu procesin mësimor të kandidatëve. Gjithsej orë teorike janë 270 orë.
<table>
<tr><td>Përmbajtja</td><td>Orët Teorike</td></tr>
<tr><td>Moduli 1. Zhvillimi i vizionit dhe strategjisë për përmirësimin e shkollës dhe menaxhimin e ndryshimit</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Moduli 2. Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Moduli 3. Diagnostikimi pedagogjik i shkollës</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Moduli 4. Vëzhgimi, dhënia e sugjerimeve/’feedback’, e mjete të tjera për përmirësimin e punës së mësimdhënësve</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Moduli 5. Drejtuesit pedagogjikë që mbështeten në të dhëna</td><td>18</td></tr>
<tr><td>Moduli 6. Menaxhimi efektiv i njerëzve, burimeve dhe financave</td><td>18</td></tr>
<tr><td>Moduli 7. Drejtimi i ndryshimeve transformuese në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit parauniversitar në Kosovë</td><td>18</td></tr>
<tr><td>Moduli 8. Drejtimi i partneriteteve me prindërit dhe komunitetin e gjerë</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Moduli 9. Modelimi i zhvillimit profesional për veten dhe të tjerët</td><td>36</td></tr>
<tr><td>Praktikë: Hulumtimi i situatave të të nxënit, bazuar në përvoja praktike</td><td></td></tr>
<tr><td>Praktikë Orientimi individual</td><td></td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>270</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>Përfituesit:</td><td>Trajnimi preferohet për:
<ul>
<li>Drejtuesit e shkollave fillore dhe të mesme, sepse ata janë të lidhur drejtpërdrejtë dhe të interesuar për këtë tematikë;</li>
<li>Zyrtarë dhe Drejtues Institucional Arsimor, si p.sh.. Zyrtar nga Ministria e Arsimit, DKA-të, etj. sepse ata janë të lidhur drejtpërdrejte dhe të interesuar për këtë tematikë;</li>
<li>Mësimdhënës të shkollave fillore dhe te mesme që kanë synime në drejtimin e institucioneve arsimore siç janë shkollat, sepse ky program do ti mundësoj zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për këtë tematikë;</li>
</ul>
Programi i Trajnimit dhe Certifikimit për Drejtorët, Zëvendësdrejtorët dhe Aspirantët për Drejtues të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar (IAAP) është një risi për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe drejtuesve në arsimin parauniversitar në Kosovë. Ky program vjen dhe si një bashkëpunim me “Shkollën e</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Drejtorëve" të Shqipërisë, me të cilin organizata jonë "BEINT" ka marrëveshje bashkëpunimi, por theksojmë se përmbajtja dhe konteksti i programit i referohet tërësisht konteksit ligjor dhe profesional të arsimit parauniversitar në Kosovë, ku bazë janë standardet e praktikës profesionale për drejtuesit e shkollës së Kosovës, dokumentet zyrtare të kurrikulës së arsimit parauniversitar, praktikat e menaxhimit dhe drejtimit të shkollës, proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit në Kosovë. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | **Qëllimi i Programit të Trajnimit dhe Certifikimit për Drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe aspirantët për drejtues të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar (IAAP) në Republikën e Kosovës, është:**<br>• Të zhvillojë një trajnim praktik, efektiv të drejtorëve/ zëvendësdrejtorëve në detyrë, si dhe mësimdhënësve të avancuar, të mësimdhënësve mentor, të mësimdhënësve të merituar që aspirojnë për drejtorë shkollash;<br>• Të krijojë kompetenca profesionale te të interesuarit e cituar më lart, për të përmirësuar rolin që do të kenë në shkollë, duke patur në qendër të vëmendjes drejtimin që mbështetet tek përmirësimi i mësimdhënies dhe të nxënit;<br>• Të respektohen nga drejtuesit e shkollës standardet e kërkuara, zyrtare, gjatë praktikës së drejtimit të shkollës dhe gjatë proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënit, si dhe për të përmirësuar klimën emocionale dhe psikologjike të shkollës;<br>• Të krijojë aftësitë e duhura menxheriale tek të trajnuarit në mënyrë të atillë që ata të jenë të përqëndruar tek një mënyrë e efektshme, drejtimi, ku përparësi është përmirësimi i mësimdhënies e të nxënit.<br><br>**Rezultatet:**<br>• Krijojnë lidhjet midis standardeve të drejtorit të shkollës dhe temës së modulit;<br>• Analizojnë dokumentet arsimore dhe pedagogjike si: vizioni i shkollës, planet e punës, përmirësimin e mësimdhënies e të nxënit që lidhen me kurrikulën dhe raportet e vlerësimit të jashtëm;<br>• Përshtatin proceset e mësimdhënies dhe të nxënit sipas nevojave të nxënësve;<br>• Analizojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi bashkëpunues në klasë midis mësuesve dhe nxënësve;<br>• Arrijnë në përfundime konkrete rreth rëndësisë së strategjive të mësimdhënies që ndihmojnë në përmirësimin e të nxënit;<br>• Përshkruajnë elementet e duhur për zhvillimin e një platforme të thjeshtë në internet për mësimdhënien dhe të nxënit;<br>• Analizojnë rëndësinë e përdorimit të llojeve të ndryshme të vlerësimit në klasë.<br>• Zhvillojnë një plan orientimi për hulumtim dhe vlerësim në shkollë<br>• Analizojnë se të dhënat e mbledhura duhet q ëtë jenë nga një shumëllojshmëri burimesh.<br>• Përdorin një sërë instrumentesh dhe procesesh për mbledhjen e të dhënave.<br>• Vlerësojnë proceset dhe instrumentet e zhvillimit dhe menaxhimit që lidhet me përdorimin e dhënave dhe sistemet e gjurmimit të trye në shkollë. |

| | |
|---|---|
| | • Përdorin të dhënat e grumbulluara gjatë orës mësimore për të mbështetur procesin e mësimdhënies nëpërmjet vëzhgimit dhe bashkëbisedimit pedagogjik<br>• Analizojnë parimet e ndarjes së burimeve të informacionit me të tjerët lidhur me nxitjen e atyre proceseve që mbështeten në përmirësimin e mësimdhënies e të nxënit në shkollë.<br>• Identifikojnë reformat në nivel kombëtar për transformimin e arsimit, ligjin për arsimin parauniversitar dhe zbatimin e tij në shkolla;<br>• Përmirësojnë në vijimësi teknikat e drejtimit të shkollës për të rritur përfshirjen e prindërve dhe faktorëve të tjerë të komunitetit në mbështetje të nevojave të shkollës dhe për të nxënët e fëmijëve.<br>• Vlerësojnë mësimdhënësit duke u bazuar në standarde dhe kritere që çmojnë zhvillimin e vazhduar profesional |
| **Përmbajtja:** | Programi, për të cilin që aplikojmë, mbështet përmbushjen e standardeve zyrtare për drejtorët e shkollës në Kosovë nga drejtorët dhe zëvendësdrejtorët në detyrë, nga mësimdhënësit e avancuar, nga mësimdhënësit mentor, nga mësimdhënësit e merituar që aspirojnë për drejtues të IAAP.<br><br>Përmbajtja e moduleve dhe rezultatet e programi të trajtuara në pikën 3.2. lidhen ngushtësisht me standardet zyrtare të drejtorëve të shkollës në Kosovë.<br><br>**Moduli 1 dhe 2** i programit lidhet me **Standardin**<br>**1. Udhëheqja dhe Motivimi.**<br><br>**Moduli 2,3,4,5,9** i programit lidhet ngushtësisht me **Standardin**<br>2. **Mësimdhënia dhe nxënia cilësore**.<br><br>**Moduli 1,2,6** i programit lidhet **Standardi**<br>**3. Planifikimi dhe Menaxhimi.**<br><br>**Moduli 8** i programit lidhet ngushtësisht me **Standardin**<br>**4. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi.**<br><br>**Moduli 7** i programit lidhet ngushtësisht me **Standardin**<br>5. **Legjislacioni dhe Shoqëria**.<br><br>**Moduli 9** i programit lidhet Standardi<br>**6. Etika profesionale.** |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e trajnimit mbështetet në parimet dhe kërkesat që lidhen direkt me drejtimin e shkollës. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet, ligjërata, punë grupore, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, prezantime, diskutime, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për realizim e drejtimit të shkollës.<br><br>Nga ligjëruesit u kërkohet të zgjedhin ose zhvillojnë materiale mësimore përkatëse dhe të azhurnuara që lejojnë kandidatët të përdorin mësimin e tyre në aktivitete realiste në jetën e përditshme.<br><br>Kandidatët mësojnë më mirë kur janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e të mësuarit. BEINT inkurajon një program të fuqishëm dhe domethënës për shpërndarjen gjatë gjithë kualifikimeve të tij. BEINT gjithashtu inkurajon një varg metodash mësimore dhe aktivitete të bazuara në klasë për të ndihmuar kandidatët të |

| | |
|---|---|
| | mësojnë, ruajnë dhe demonstrojnë njohuritë dhe mirëkuptimin e tyre. Kandidatët duhet të inkurajohen të marrin përgjegjësi për mësimin e tyre dhe duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë një shkallë të lartë të pavarësisë në aplikimin e aftësive të kërkimit dhe vlerësimit. Qendrat mund ta lehtësojnë këtë duke përdorur metoda angazhimi të shpërndarjes që përfshijnë mësimin aktiv dhe jo duke u mbështetur në metodat tradicionale të ofrimit të ligjëratave për të dhënë njohuri. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit duhet dëshmuar:<br>- Pjesëmarrje aktive në trajnimet e programit;<br>- Rezultat të kalimit të testeve modulare me së paku 50% të pikëve;<br><br>Certifikata mund të jetë:<br>o Certifikim Trajnimit të Plotë;<br>o Certifikatë e Modulit. |
| **Trajner** | Trajnerët janë ekspert me gradën Doktor të Shkencave të Edukimit, me mbi 20 vite përvojë pune në fushat specifike që i mbulon programi trajnues, dhe Master Trajner të Licencuar.<br><br>**Lista e trajnerëve të angazhuar gjatë ofrimit të programit:**<br>1. Robert Gjedia; 2. Majlinda Lika; 3. Mimoza Milo; 4. Mirela Karabina; 5. Antoneta Rama; 6. Alfons Harizaj; 7. Semiha Loca;<br>8. Adriana Qafa; 9. Zamira Çavo; 10. Osman Buleshkaj; 11. Selim Mehmeti; 12. Imer Preteni; 13. Drita Haxhaj; 14. Skender Susuri; 15.Samir Shahini; 16. Selim Kryeziu; 17. Mehdi Behrami; 18.Valbona Hadri; 19. Valbona Thaçi; 20. Bedri Beqiri. |
| **Data** | Nëntor 2022 |

| Titulli i Programit | Certifikimi për Vlerësues të Përformancës të IAAP dhe Mësimdhënësve |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | **BEINT** - **Int**ernational **B**usiness **E**ducation |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | BEINT |
| **Adresa:** | Rr. "Nazim Gafurri", nr.15, Prishtinë |
| **E-mail:** | info@beint.org |
| **Telefoni:** | +383 44 500 388 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr. 80/80, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | Programi i Trajnimit dhe Certifikimi për Inspektorët e Arsimit, Drejtorët, Zëvendësdrejtorët dhe mësimdhënësit lidhur me Vlerësimin e Jashtëm të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar (IAAP) përbëhet nga 4 module që përfshijnë orë teorike- praktike, si dhe studim individual. Tabela më poshtë paraqet numrin e orëve teoriko-praktike dhe ato për studim individuale, në mënyrë të detajuar dhe në total.<br>**Struktura e trajnimit:** |

| **Përmbajtja** | **Shpërndarja e orëve** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Orët teorike praktik në trajnim** | **Studim individual** | **Total** | **Kreditë** |
| 1. Korniza për sigurim të cilësisë së përformancës së institucionit arsimor. | 2 | 2 | 4 | 4 |
| 2. Pse duhet dhe si realizohet "Vlerësimi i jashtëm i përformancës Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar" | 2 | 2 | 4 | 4 |
| 3. Fushat, treguesit, kriteret e vlerësimit të cilësisë dhe metodologjia që përdoret në procesin e Vlerësimit të Jashtëm | 4 | 2 | 6 | 6 |
| 4. Hartimi dhe struktura e raportit të Vlerësimit të Jashtëm të të përformancës Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar | 4 | 2 | 6 | 6 |
| **Total** | **12** | **8** | **20** | **20** |

| | |
|---|---|
| **Përfituesit:** | Programi për Trajnimin dhe Certifikimin e Vlerësuesve të jashtëm të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar (IAAP) i adresohet gjithë inspektorëve të arsimit në nivel qendror dhe lokal, por dhe DKA-ve, drejtues shkollave dhe mësimdhënësve - kordinatorëve, sepse ata duhet të jenë të mirë-informuar lidhur me procedurat e vlerësimit të jashtëm të përformancës së institucionit arsimor, pasi është ky staf që realizon vlerësimin e brendshëm dhe ky proces dhe produkt i institucionit do të përballet me vlerësimin e jashtëm. Nga ana |

| | |
|---|---|
| | tjetër programi synon krijimin e kompetencave të duhura, profesionale tek inspektorët e arsimit lidhur me vlerësimin e jashtëm të IPEAPAP si detyrë dhe përgjegjësi që ata kanë ligjërisht. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | **Qëllimi** i Programit të Trajnimit dhe Certifikimit për Inspektorët e Arsimit, Drejtorët, Zëvendësdrejtorët dhe Mësimdhënësit lidhur me Vlerësimin e Jashtëm të Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar (IAAP) është:<br>• Krijimi i kompetencave të duhura, profesionale për planifikimin dhe realizimin e Vlerësimit të Jashtëm bazuar në fusha, tregues dhe kritere zyrtare të vlerësimit të cilësisë së IAAP<br>• Përmirësimi i shërbimit arsimor që ofron institucioni arsimor, parauniversitar<br><br>***Rezultatet:***<br>• Analizojnë qasjen dhe konceptimin për rolin e ri të shkollës në kontekstin evropian<br>• Shqyrtojnë modelet evropiane rreth vlerësimit të shërbimit arsimor që ofron institucioni arsimor, parauniversitar<br>• Shpjegojnë parimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë<br>• Identifikojnë fushat, treguesit, kriteret, shkallët e vlerësimit të cilësisë së institucionit arsimor<br>• Analizojnë nivelet e vlerësimit të përformancës së shkollës<br>• shqyrtojnë parimet e vlerësimit të përformancës së shkollës<br>• shpjegojnë karakteristikat e vlerësimit të jashtëm të shkollës<br>• identifikojnë mënyrën e krijimit të ekipit i vlerësimit të jashtëm<br>• dallojnë vlerësimin e përformancës së shkollës kur kryhet për kritere, për fusha dhe për gjithë performancën e shkollës<br>• shpjegojnë se si analizohen të dhënat e mbledhura<br>• demonstrojnë format e paraqitjes së të dhënave të mbledhura<br>• finalizojnë gjetjet përfundimtare të procesit të vlerësimit të jashtëm<br>• identifikojnë dokumentet themelore që lehtësojnë procesin vlerësimit të jashtëm, si: “Korniza e Cilësisë së Shkollës”, “Udhëzuesi i vlerësimit të jashtëm”,<br>• shpengojnë se çfarë janë treguesit, përshkruesit praktikë dhe shkallët e vlerësimit<br>• identifikojnë fushat e vlerësimit sipas udhëzuesit zyrtar<br>• shqyrtojnë se çfarë është trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë<br>• thonë se sa fusha dhe tregues vlerësohen në vit në një institucion arsimor parauniversitar<br>• identifikojnë metodat dhe teknikat më të efektshme për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm<br>• identifikojnë pikat e dobëta, të forta, mundësitë dhe rreziqet që ka institucioni<br>• përcaktojnë vlerësimin e institucionit, bazuar te vlerësimet e treguesve të fushës dhe në tërësi për institucionin<br>• shkruajnë konform strukturës raportin e vlerësimit të brendshëm<br>• paraqesin raportin e vlerësimit të jashtëm te institucioni arsimor<br>respektojnë kriterin zyrtar, që për një periudhë 3/4-vjeçare, institucioni duhet të kryejë vlerësimin e tij për të gjithë fushat dhe treguesit zyrtarë. |
| **Përmbajtja:** | Programi mbështet fort dokumentet e MASHT, si:<br>Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2017 “Për vlerësimin e përformancës së institucioneve arsimore në arsimin-parauniversitar”<br>-Korniza për sigurim të cilësisë së përformancës së shkollës në Kosovë, 2016<br>-Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të shkollës, 2016<br>-Udhëzues për vlerësimin e jashtëm të përformancës së shkollës, 2017 |

| | |
|---|---|
| | Përmbajtja e moduleve dhe rezultatet e programi të trajtuara lidhen ngushtësisht me nevojën për të krijuar profesionistë në fushën e vlerësimit të institucionit arsimor.<br><br>**Moduli** 1. **Korniza për sigurim të cilësisë së përformancës së institucionit arsimor** u jep mundësi grupeve të interesit që do të përfshihen në trajnim që të artikulojnë terma të vlerësimit, si: Kornizë cilësie, fusha, tregues, kritere, përshkrues, shkallë vlerësimi, duke i futur ata lirisht në dimensionin e vlerësimit të institucionit, ndërsa nga ana tjetër krijohet te ata mendësia që cilësia në arsim rritet kur institucioni arsimor vlerësohet si nga vetvetja, por dhe nga vlerësimi i jashtëm.<br>**Moduli 2. Pse duhet dhe si realizohet "Vlerësimi i jashtëm i IAAP"** u jep mundësi grupeve të interesit se si planifikohet, si realizohet Vlerësimi i Jashtëm, teknikat dhe metodat që përdoren, si mblidhen dhe përpunohen të dhënat, por dhe si përzgjidhen instrumentet e efektshme për të kryer vlerësimin e jashtëm.<br>**Moduli 3. Fushat, treguesit, kriteret e vlerësimit të cilësisë dhe metodologjia që përdoret në procesin e Vlerësimit**<br>Ky modul paraqet 5 fushat e cilësisë së IAAP përkatësisht: Menaxhimi dhe qeverisja; Kultura dhe mjedisi shkollor; Mësimdhënia dhe nxënia; Zhvillimi profesional i mësimdhënësve; Përformanca e nxënësve;, përmbajtjen e tyre, si dhe detajimin në tregues, në përshkrues praktikë dhe kritere e shkallë vlerësimi. Nga ana tjetër modul krijon aftësitë e domosdoshme për të vlerësuar një tregues, një fushë dhe në tërësi gjithë institucionin arsimor.<br>**Moduli 4. Hartimi dhe struktura e raportit të Vlerësimit të IAAP** u jep mundësi grupeve të interesit që të diskutojnë, të punojnë dhe të krijojnë aftësitë lidhur me përpilimin e i draftit të parë të raportit të vlerësimit të jashtëm, diskutimin e tij me institucionin arsimor, finalizimin dhe dorëzimi i raportit, por dhe diskutime rreth parashikimeve dhe kohëzgjatjes së një vlerësimi .<br>Programi do të realizohet në trajnim të drejtpërdrejtë, por dhe online. Aktivitetet kryesore të programit janë seancat e paraqitjes së teorisë, e cila do të jetë e ndërthurur me prezantime, diskutime, kryesisht analiza situatash dhe zgjidhje problemesh nga përvoja individuale dhe ajo e shkollës, si dhe reflektime dhe të menduar kritik. Pjesa e dytë e trajnimit ajo praktike, do të zhvillohet në shkollë, aty ku punon drejtuesi apo mësimdhënësi sipas një planifikimi që merret në trajnim. Trajnimi do të zhvillohet në fundjavë, ditëve të premte dhe të shtunë, kurse praktika profesionale gjatë ditëve të punës së mësimdhënësit në shkollë, kohë në të cilën ai/ajo do të ketë mundësi të hartojë produktet sipas kërkesave të secilit modul. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Përmbajtja e metodologjisë së trajnimit gjatë zbatimit të programit është përcaktuar në mënyrë të tillë që të mundësojë në mënyrë të koordinuar trajnimin efektiv të pjesëmarrësve (inspektorë, drejtues dhe mësimdhënës) nëpërmjet proceseve të të nxënit të bazuar në përvoja dhe në vëzhgime që orientohen nga praktika. Trajnimi është i rëndësishëm për t'i pajisur pjesëmarrësit ( inspektorë, drejtues dhe mësimdhënës) me një sërë njohurish, aftësish dhe bindjesh , të nevojshme për të realizuar një Vlerësim të Jashtëm të efektshëm që nxit cilësinë e institucionit arsimor.<br>Modulet e përzgjedhura janë hartuar në përputhje me dokumentet zyrtare të MASHT lidhur me cilësinë e shkollës, si dhe me udhëzuesit e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të IAAP.<br>Trajnerët bazohen në metodat ndërvepruese për trajnimin, duke kombinuar në mënyrë organike shpjegimin me diskutimet, me punën në ekipe dhe prezantimet e pjesëmarrësve. Në rastin e trajnimit online përdoret platforma "google meet", ku krahas prezantimeve të trajnerit dhe të pjesëmarrësve në "share screen" apo të shkëmbimeve pyetje-përgjigje, do të punohet dhe me grupe online që i krijojnë trajnerët, sipas ndarjes online që mundëson platforma, por dhe nëpërmjet paraqitjes online të punimeve të grupeve/ekipeve ose të të gjithë grupit. |

| | |
|---|---|
| | Trajnerët kanë mundësi të ndërveprojnë me secilin grup, pa u dëgjuar te grupet e tjera, por dhe grupet punojnë në platformën online, të pavarur. Pjesëmarrësit do të pajisen me material teorik të modulit të fotokopjuar, prezantim në ppt version, program trajnimi, fisha pune, fletë pune me situata rasti, figura, markera, fletë të mëdha të bardha, fletë formati, blloqe, stilolapsa, ngjitës, laptop, platforma online. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit duhet dëshmuar:<br>- Pjesëmarrje aktive në trajnimet e programit;<br>- Rezultat të kalimit të testeve modulare me së paku 50% të pikëve;<br><br>Certifikata mund të jetë:<br>o Certifikim Trajnimit të Plotë;<br>o Certifikatë e Modulit. |
| **Trajner** | Trajnerët janë ekspert me gradën Doktor të Shkencave të Edukimit, me mbi 20 vite përvojë pune në fushat specifike që i mbulon programi trajnues, dhe Master Trajner të Licencuar.<br><br>**Lista e trajnerëve të angazhuar gjatë ofrimit të programit:**<br>1. Robert Gjedia; 2. Alfons Harizaj; 3. Osman Buleshkaj; 4. Selim Mehmeti; 5. Besim Lutfiu. |
| **Data** | Nëntor 2022 |

| Titulli i Programit: | E DREJTA PËR PËRFAQËSIM PUBLIK - AVOKIMI |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. “Qëndresa”, nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 20/20 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet të gjithë qytetarëve aktiv të cilët kanë për qëllim të bëjnë ndryshime pozitive në shoqëri. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme të avokimit;<br>• Njohuri për të drejtën për avokim, për zgjidhjen dhe eliminimin e problemeve të ndryshme;<br>• Informata për drejtësinë shoqërore;<br>• Njohuri për fuqizimin e qytetarëve për të qenë aktiv dhe zë i fuqishëm i shoqërisë;<br>• Informohen se cilat çështje duhet identifikuar për të adresuar përmes avokimit;<br>• Njohuri si të analizojnë shkaqet të cilat adresojnë;<br>• Informata se kush janë palët primare dhe sekundare interesit dhe kur duhet të i përfshijmë;<br>• Shkathtësi për të hartuar një plan të veprimit. |
| **Përmbajtja**: | Si qytetar të Kosovës mësimdhënësit dhe punonjësit tjerë të arsimit duhet të kenë njohuri për adresimin e çështjeve me të cilat ata preokupohen. Programi i trajnimit për avokim është hartuar ashtu që mund të i ofrohet edhe nxënësve dhe prindërve të tyre. Avokimi u ofron të të gjithëve mundësinë për të shprehur këndvështrimet e tyre me qëllim ndryshimin e politikave dhe krijimin e ndryshimeve sistematike, në arsim dhe përtej. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Për tre ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për të drejtat e ndryshimeve që ata mund të bëjnë në shoqëri. Në grupe përcaktojnë prioritetet të cilat duhet adresuar. Po ashtu në grupe kuptojnë kush mund të jenë aleatët në këtë proces. Po ashtu analizojnë cilat mund të jenë barrierat dhe si ti adresojnë ato. Të gjithë pjesëmarrësit në grup apo individualisht hartojnë planin e veprimit si dhe analizojnë buxhetin e nevojshëm nëse duhet. Çdo pjesëmarrës ka mundësi të paraqet planin e veprimit para grupit të madh. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e kursit mbi 90%. |
| **Trajnerë:** | 4 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | Edukimi dhe Zhvillimi i Integruar në Fëmijëri të Hershme |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE ZHVILLIM TË ARSIMIT (IHZHA) – FAKULTETI I EDUKIMIT - UP |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues **themelor** |
| **Ofertuesi i programit:** | INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE ZHVILLIM TË ARSIMIT (IHZHA) – FAKULTETI I EDUKIMIT - UP |
| **Adresa:** | Fakulteti i Edukimit<br>Universiteti i Prishtinës"Hasan Prishtina"<br>Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | edukimi@uni-pr.edu |
| **Telefoni:** | +383(0)38 229 201 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.96/96 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | **70 orë trajnimi** (Programi ka gjithsej **54 orë** trajnim plus **16 orë** angazhim i pavarur që lidhet me përmbajten e moduleve të trajnimit) |
| **Përfituesit:** | • Edukatorët në shërbim (që punojnë me fëmijët lindje deri në 6 vjeç).<br>• Studentët e programeve të edukimit në fëmijëri të hershme<br>• Profesionistët e tjerë të kujdesit dhe mirëqenies së fëmijëve<br>• Prindërit |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 25 – 30 pjesëmarrës. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të këtij programi edukatorët do të jenë në gjendje të:<br>• Demonstrojnë një kuptim sistematik të aspekteve kyçe të zhvillimit të fëmijës dhe të reflektojnë në mënyrë kritike mbi teoritë e zhvillimit të fëmijëve dhe zbatimin e tyre në praktikën e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme.<br>• Organizojnë vëzhgime të detajuara në mbështetje të planifikimit të programit për individë dhe grupe fëmijësh duke përdorur një sërë mjetesh.<br>• Identifikojnë zhvillimin atipik dhe aftësohen të administrojnë teknika të punës me fëmijë dhe intervenime me bazë në kopsht, të individualizuara sipas nevojave zhvillimore të fëmijëve.<br>• Kuptojnë rëndësinë e metodave të ndryshme të të nxënit tek fëmijët dhe të zbatojnë teknika inovative të mësimdhënies që mundësojnë zhvillimin dhe të nxënit përmes lojës në fëmijëri të hershme.<br>• Përdorin një varg mjetesh dhe materialesh për të konstruktuar lojëra për fëmijë që mundësojnë zhvillimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e Kornizës Kurrikulare.<br>• Dallojnë vlerat më të rëndësishme demokratike dhe integrojnë edukimin për vlera në aktivitete edukative përmes metodave të ndryshme gjatë punës me grupmosha të caktuara, në edukimin e hershëm.<br>• Njohin dhe kuptojnë koncepte bashkëkohore të barazisë gjinore dhe zbatojnë ato në praktikë përmes aktiviteteve edukative që promovojnë barazinë gjinore në procesin e edukimit dhe zhvillimit tërësor.<br>• Zbatojnë strategji të ndryshme të komunikimit dhe ndërveprimit me fëmijë, familje, dhe komunitete të cilat nxisin bashkëpunimin efektiv me fëmijë, familje, dhe komunitete dhe zgjidhjen e konflikteve. |

| | |
|---|---|
| | • Përforcojnë empatinë dhe të dëgjuarit aktiv përmes reflektimit mbi mënyrat e komunikimit dhe ndërlidhjes së tyre me personalitetin e individit.<br>• Kuptojnë rëndësinë e punës me projekte në edukimin e hershëm dhe identifikojnë tema e projekte në pajtueshmëri me interest e fëmijëve dhe integrimin e tyre në arritjen e rezultateve të parapara në Kornizën Kurrikulare.<br>• Përdorin strategji gjithëpërfshirëse gjatë punës me projekte duke përfshirë të gjithë fëmijët, prindërit, dhe komunitetet dhe duke i respektuar interesat dhe nevojat individuale të fëmijëve.<br>• Integrojnë teknologjinë didaktike në aktivitete të ndryshme edukative për grupmosha të ndryshme që stimulojnë fëmijët për të përdorur teknologjinë digjitale për të mësuar. |
| **Përmbajtja:** | Me anë të programit të trajnimit "Edukimi dhe Zhvillimi i Integruar në Fëmijëri të Hershme" synohet të zhvillohen kompetencat e edukatorëve në shërbim duke synuar zhvillimin e aftësive për realizimin e aktiviteteve me në qendër fëmijën, aftësive të komunikimit me fëmijë, prindër dhe komunitet, trajtimin e fëmijëve në mënyrë të barabartë pavarësisht dallimet që mund të kenë, përdorimin e mjeteve dhe paisjeve të ndryshme teknologjike dhe të tjera natyrore për zhvillimin tërësor të fëmijëve, të mësuarit përmes lojes, etj. Përmes këtij programi do të ngriten kapacitetet e edukatorëve para-shërbimit dhe gjatë-shërbimit të arsimit parashkollor për të ofruar shërbime cilësore dhe të integruara në fëmijëri të hershme me qëllim të zhvillimit të aftësive, vlerave, dhe kompetencave në nivelin e edukimit parashkollor në përputhje me politikat arsimore të MASHTI- që ndërlidhen me këtë moshë spefike. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | • Mësimdhënie interaktive<br>• Punë grupore<br>• Punë praktike e bazuar në kontekst<br>• Qasja e punës e bazuar në nxitjen e diskutimeve, shkëmbime mendimesh, dhe reflektim kritik |
| **Certifikimi:** | Pakoja e moduleve të trajnimit për edukimin dhe zhvillimin e integruar në fëmijëri të hershme përmbanë gjithsej 6 module të cilat janë: zhvillimi i fëmijës, të nxënit përmes lojës, edukimi për vlera dhe barazia gjinore në fëmijërinë e hershme, komunikimi dhe ndërveprimi me fëmijë, familje dhe komunitete, puna me projekte edukative, dhe integrimi i teknologjisë në fëmijërinë e hershme.<br><br>Pjesëmarrësit mund të ndjekin të gjitha modulet, ose vetëm modulet të cilat janë në interes të tyre dhe që lidhen me nevojat e tyre për zhvillim profesional. Pjesëmarrësit do të trajnohen vetëm në ato module të cilat i kanë ndjekur. Modulet janë një ditore ose dy ditore. Për modulet dy ditore, pjesëmarrësit duhe të ndjekin dy ditë trajnimi për t'u kualifikuar për certifikim. Varësisht nga numri i orëve të ndjekura të trajnimit do të certifikohen me numer të kredive (ECTS) përkatëse. Me ndjekjen e të gjitha moduleve të këtij programi, pjesëmarrësit ndjekin në total **70 orë trajnimi ose 3 ECTS.** |
| **Trajner, sa trajner:** | Trajnerët e certifikuar për të ofruar këtë trajnim janë stafi akademik i Fakultetit të Edukimit të programit parashkollor. Gjithësej janë 10 trajner të cefitikuar për module të caktuara të programit të cilat ndërlidhen me kualifikimin e |

| | |
|---|---|
| | ekspertizën e tyre.<br><br>Për modulin "Zhvillimi i fëmijës" janë të certifikuar 3 trajner.<br>Për modulin "Të nxënit përmes lojës" janë të certifikuar 4 trajner.<br>Për modulin "Edukimi për vlera dhe barazia gjinore në fëmijërinë e hermshme" janë të certifikuar 3 trajner.<br>Për modulin "Komunikimi dhe ndërveprimi me fëmijë, familje dhe komunitete" janë të certifikuar 6 trajner.<br>Për modulin "Puna me projekte edukative" janë të certifikuar 3 trajner.<br>Për modulin "Integrimi i teknologjisë në fëmijërinë e hershme" janë certifikuar 2 trajner. |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | **Edukimi muzikor dhe aspekte të rëndësishme në procesin e mësimdhënies së integruar/diferencuar** |
|---|---|
| Titulli i organizatës | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| Tipi i programit: | Themelor |
| Ofertuesi i programit: | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| Adresa: | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| E-mail: | edumen.rks@gmail.com |
| Telefoni: | 048-751-752 |
| Numrat dhe data e aprovimit: | **Numër: 04/4 Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| Kohëzgjatja e programit (orë) | Në total janë të planifikuara 16 orë:<br>- 10 orë në auditor dhe 6 orë praktikë, me mentorim (nëse zhvillohet mësim fizik)<br>- 16 orë mësim teorik (nëse mësimi zhvillohet online) |
| Përfituesit: | Mësimdhënësit e karrierës si dhe edukatorët janë ata mësimdhënës/edukatorë të cilët synojnë këtë trajnim. Trajnimi synon të rrisë performancën e tyre në rrafshin teorik dhe praktik, me qëllim të avansimit të shkathtësive mbi aspekte të rëndësishme të edukimit muzikor dhe rolit të tij në punën me nxënës respektivisht fëmijë. Kjo kategori mësimdhënësish që bëjnë përpjekje të rriten në karrierën e tyre, kanë mundësinë që të njohin, përvetësojnë dhe të thellohen në fushën e muzikës dhe aspekte metotodologjike të saj, si dhe të aftësohen për njohuri dhe metoda të reja, të panjohura ose pak të dëgjuara prej tyre. |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosvës |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | 1. Njohja me parimet themelore dhe rëndësinë edukimit muzikor;<br>2. Njohja e metodave të mësimdhënies në fushën e muzikës;<br>3. Implementimi i shkathtësive të fituara të bazuara në një proces efektiv mësimor |

| | |
|---|---|
| Përmbajtja: | Programi i trajnimit do të synojë që mësimdhënësit/edukatorët t'i përmbushë me njohuritë bazike që dalin nga Kurrikula Bërthamë për klasët përgatitore dhe arsimin fillor të Republikës së Kosovës e cila thotë: artet edukojnë në mënyrë të suksesshme për arritjen e kompetencave të parapara në kurrikulën e Kosovës, vetëm nëse gjatë mësimdhënies zbatohen në mënyrë të duhur parimet didaktike dhe metodike përkatëse në secilën prej lëndëve mësimore në fushën-Artet. Metodologjia e mësimdhënies në lëndët artistike përfshin teknika dhe metoda mësimore specifke për zhvillimin e kompetencave artistike. Në këtë nivel duhet të përdoret kryesisht loja kreative, intuita, mësimdhënia e integruar, e diferencuar (në bazë të prirjeve dhe interesimeve individuale të nxënësit) si dhe qasja konstruktive e të nxënit me nxënësin në qendër. Përjetimi artistik, nxitja e kërshërisë, e imagjinatës dhe liria e të shprehurit e inkurajimi i kreativitetit janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Qasja integruese tematike e ndërlëndore e ndihmojnë nxënësin që të njohë dhe zbatojë më lehtë konceptet e ndryshme artistike. |
| Metodat e realizimit të programit | Në këtë trajnim si metodologji kryesore do të përdoret ndërveprimi mes trajnuesit dhe nxënësit, puna konkrete përmes detyrave të shkurtra për të dëgjuar mendimin e mësimdhënësve, qasjen e tyre mbi trajnimin por edhe për të parë në kohë reale rezultatet: Sa dhe si ka ndryshuar koncepti mbi rëndësinë dhe aspektet e fushës së muzikës në procesin mësimor, duke u bazuar nga informata e fituar gjatë trajnimit. |
| Certifikimi | Cilësia e programit të trajnimit varet në një shkallë të gjerë nga pjesëmarrja e mësimdhënësve në trajnim, ndërlidhja e ambicies së tyre për të përthithur dijet e fituara, si dhe ndërveprimi me trajnuesin. Çdo njëri prej tyre varësisht këtyre treguesve, do të ketë vlersimin e trajnuesit për ta.<br>Do të merren shembuj nga praktika të krijuara dhe përvoja të ndryshme.<br>Vleresimi final i mësimdhënësve do të realizohet me testim. |
| Trajner | PhD (c) Elizabetë Qarri |
| Data | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | EDUKIMI PËR DEMOKRACINË DHE TË DREJTAT E NJERIUT |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 168/16 Data: 14.10.2016<br>Nr. 28/2018 Data: 29.06.2018<br>**Nr. 47/47 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi organizohet në dy faza.<br>Faza 1: Seminari trajnues 5-ditor<br>Faza 2: Faza përcjellëse pas seminarit trajnues<br>Programi ka gjithsej 60 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve të niveleve të ndryshme, përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, prindërve dhe përfaqësuesve të tjerë të komunitetit shkollor. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësimdhënësit e ardhshëm dhe për udhëheqësit e institucioneve arsimore. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje të:<br>• Të ndërtojnë një kulturë demokratike në udhëheqjen dhe qeverisjen e shkollave,<br>• Të përfshijnë parimet e EDDNj në njësi mësimore për të zhvilluar kompetencat e nxënësve të parapara me kurrikulën e Kosovës dhe në veçanti të kompetencës së qytetarisë aktive,<br>• Të forcojnë bashkëpunimin e shkollave me institucione, organizata dhe përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që ndihmojnë në ngritjen e cilësisë së procesit mësimor, |

| | |
|---|---|
| | • Të prezantojnë përvojat dhe praktikat e mira në fushën e EDDNj,<br>• Të mbështesin krijimin e një rrjeti të profesionistëve që promovojnë EDDNj,<br>• Të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte shkollore që promovojnë EDDNj,<br>Të zbatojnë parimet e Kartës së Këshillit të Evropës për EDDNj dhe përdorimin e materialeve të Këshillit të Evropës në institucionet e tyre. |
| **Përmbajtja:** | Korniza dhe parimet themelore të EDDNj. Qasja tërë-shkollore ndaj EDDNj. Analiza e gjendjes në Shkolla. Karta e Këshillit të Evropës dhe parimet e saj. Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe lidhja e saj me parimet e Kartës së Këshillit të Evropës. Udhëheqja demokratike e shkollave. Përfshirja e parimeve të EDDNj në fusha lëndore të ndryshme. Analiza procedurale dhe përmbajtësore e mësimeve model të orëve të ndryshme mësimore. Kutia e veglave për të nxënit aktiv në kuadër të EDDNj. Njohuri për organizimin e aktiviteteve jashtë-mësimore që promovojnë zbatimin e parimeve të EDDNj. Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme. Komunikimi efektiv. Strategjitë për zgjidhjen e konflikteve dhe të çështjeve kundërthënëse. Shfrytëzimi i materialeve për EDDNj nga ueb faqja e Këshillit të Evropës. Hartimi i projekteve shkollore për zbatim të EDDNj. Prezantimi i përvojave gjatë takimit njëditor. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e ofrimit të programit trajnues bazohet në modelin e Akademive regjionale të programit EDC/HRE të organizuara nga Këshilli i Evropës. Programi organizohet në dy faza:<br><br>Faza 1: Seminari trajnues 5-ditor<br><br>Seminari është bërthama e Akademisë. Trajnerët dhe pjesëmarrësit punojnë së bashku dhe ndajnë përvojat e tyre me EDDNj. Pjesëmarrësit analizojnë situatën aktuale në shkollën dhe komunitetin e tyre dhe reflektojnë për praktikën e tyre në dritën e parimeve të EDDNj. Bazuar në këto analiza dhe të mbështetur nga trajnerët, secili ekip shkollor zhvillon një projekt shkollor të drejtuar kah nxitja e kulturës demokratike në shkollë.<br><br>Faza 2: Faza përcjellëse pas seminarit trajnues<br><br>Në këtë fazë trajnerët mbështesin pjesëmarrësit në zbatimin e projekteve të tyre shkollore. Gjatë zbatimit të projekteve shkollore, organizohet takimi një ditor për të shkëmbyer përvojat në zbatimin e projekteve |

| | |
|---|---|
| | shkollore, si dhe vazhdimësinë e zbatimit të aktiviteteve që promovojnë EDDNj në shkollat përfituese të programit të trajnimit. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminarit (mbi 90 %), përgatitja dhe zbatimi i projektit shkollor, si dhe pjesëmarrja në takimin për prezantimin e aktiviteteve të zbatuara në shkollë. |
| **Trajner sa trajner:** | 7 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 45/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 39/39 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi Edukimi për Drejtësi Shoqërore - trajnim për të rritur, përbëhet prej dy moduleve. Programi prezantohet në formë të punëtorive dhe ka gjithsej 48 orë. Koha në mes të mbajtjes së dy seminareve duhet të jetë së paku 5 muaj. Çdo seminar ka 24 orë trajnimi. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet punëtorëve të arsimit, juristeve, gazetareve, përfaqësuesve të OJQ-ve, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me relacionet njerëzore. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Programi i trajnimit karakterizohet me aktivitete të shumta individuale, në qifte dhe punë grupore. Numri optimal i pjesëmarrësve është 15 persona. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Rezultatet për Modulin e parë – Ndërtimi i vetëdijes kritike<br>Pjesëmarrësit do të:<br>• zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike për të kuptuar realitetin ne formë të drejte dhe angazhimin që duhet bërë për luftimin e padrejtësive.<br>• njohin nivelet e ndryshme të përgjegjësisë në përjetimin e dominimit sistematik,<br>• njohin strategjitë që u ndihmojnë në transformimin e ambientit të tyre personal dhe institucional.<br>Rezultatet për modulin e dytë – Reflektim ndaj veprimit<br>Pjesëmarrësit do të: |

| | |
|---|---|
| | • zhvillojnë dhe thellojnë të kuptuarit për stereotipet dhe do të zhvillojnë shkathtësi për t'i zbërthyer stereotipet,<br>• thellojnë të kuptuarit për format e shtypjes,<br>• mësojnë se si t'i zbatojnë strategjitë të cilat do tu ndihmojnë në transformimin e ambientit të tyre personal dhe institucional |
| **Përmbajtja:** | Programi Edukimi për të drejtën shoqërore, është një program trajnimi i cili ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të njohur diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, si vlerë njerëzore. Pranimi i të tjerëve pa paragjykime, të qenit tolerant dhe i hapur, janë sjellje thelbësore të çdo qytetari, si dhe kusht për krijimin e një shoqërie demokratike. Një qasje e tillë i mundëson çdo qytetari të drejtën për të qenë i pranuar dhe i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në aspektin individual, shoqëror dhe institucional. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi prezantohet në formë të punëtorive. Punëtoritë janë kombinim i prezantimit të njohurive teorike dhe punës praktike. Aktivitetet zhvillohen në grup të madh, grupe te vogla si dhe punë individuale. Të gjitha aktivitet janë prezantim i jetës reale të cilat i bëjnë pjesëmarrësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe i bënë ata personalisht të angazhohen për reflektim personal në lidhje me padrejtësitë, shtypjen dhe sistemin e dominimit në ambientet të ndryshme private dhe institucionale. |
| **Certifikimi** | 48 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 8 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE - AKTIVITETE PËR KLASË |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 59/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 38/38 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi prezantohet në formë të trajnimit treditor me gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet të gjithë mësimdhënësve dhe profesionistëve tjerë që punojnë me fëmijët 7-18 vjeç. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Programi i trajnimit karakterizohet me aktivitete të shumta individuale, në qifte dhe punë grupore. Numri optimal i pjesëmarrësve është 25 persona. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit do të:<br>• Përforcojnë vetë-konceptin e fëmijëve dhe identitetet grupore duke pranuar, respektuar dhe afirmuar të gjitha kulturat dhe përvojat e fëmijëve<br>• Përforcojnë marrëdhëniet e shkollës me familjet dhe komunitetet duke i inkuadruar në materialin mësimor, si bazë për mësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, që vijnë drejtpërdrejtë nga familjet dhe komunitetet<br>• Nxisin fëmijët të hulumtojnë dhe kërkojnë zgjidhje për padrejtësitë shoqërore të cilat ata mund t'i hasin.<br>• Mësojnë si të nxisin të menduarit kritik te fëmijët, rreth keqinterpretimeve, stereotipeve dhe paragjykimeve.<br>• Jenë më të hapur për të përfshirë grupet e ndryshme etnike gjejnë forma dhe sugjerime se si të lehtësohet ky proces. |
| **Përmbajtja:** | Shkathtësitë e mësuara në trajnim ndërtohen mbi Standardet Pedagogjike të ISSA për: individualizimin për të vlerësuar diversitetin në mesin e nxënësve dhe familjeve; pjesëmarrjen e familjes; krijimin e ambienteve mësimore gjithëpërfshirëse; hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme mësimore që |

| | |
|---|---|
| | promovojnë bashkëpunimin: hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe planifikimin dhe vlerësimin e mësimnxënies. |
| **Metodat e realizimit të programit** | **Edukimi për Drejtësi shoqërore – aktivitete për klasë** do të zgjerojë dhe thellojë njohuritë në këto fusha duke i prezantuar strategjitë për:<br>➢ zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet që tradicionalisht janë të margjinalizuara në sistemin shkollor<br>➢ përfshirjen e zërit të fëmijëve dhe familjeve në hartimin e programeve<br>➢ promovimin e kapacitetit të nxënësve për bashkëpunim, negociata dhe mendim kritik duke u siguruar nxënësve mundësi për të përfituar përvojë përmes një llojllojshmërie perspektivash dhe duke modeluar respekt për këndvështrime të ndryshme<br>➢ zhvillimin e njësive dhe aktiviteteve të integruara që i adresojnë apo inkorporojnë çështjet e drejtësisë shoqërore duke përdorur tema që janë pjesë e kurrikuleve kombëtare, tregime të zakonshme të fëmijëve dhe tema të cilat i iniciojnë fëmijët nga interesat dhe përvojat e tyre (për shembull, drejtësia, përfshirja, bashkëpunimi, si të zgjidhet konflikti dhe ndërprerja e stereotipeve negative); nxënësit gjithashtu mësojnë shkathtësi akademike të përshtatshme për moshën e tyre. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 7 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | EDUKIMI PËR DREJTËSI SHOQËRORE - AKTIVITETE PËR TË RRITUR DHE FËMIJË |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr.85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 60/2018 Data: 12.11.2018<br>Nr. 37/37 Data: 10.06.2022, **Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi prezantohet në formë të trajnimit treditor me gjithsej 32 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet punëtorëve të arsimit dhe të gjithë atyre që kanë dëshirë t'i thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për relacionet njerëzore si dhe t'i njoftojnë fëmijët me dallimet shoqërore. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Programi i trajnimit karakterizohet me aktivitete të shumta individuale, në çifte dhe punë grupore. Numri optimal i pjesëmarrësve është 25 persona. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit do të:<br>• Thellojnë njohuritë, të kuptuarit dhe ndjeshmërinë për mekanizmat që përjetësojnë dhe mbajnë sistemet e dominimit<br>• Ndërtojnë përkushtimin ndaj procesit të ndërtimit të kapacitetit për transformim personal, profesional dhe institucional<br>• Përforcojnë vetë-konceptin e fëmijëve dhe identitetet grupore duke pranuar, respektuar dhe afirmuar të gjitha kulturat dhe përvojat e fëmijëve<br>• Përforcojnë marrëdhëniet e shkollës me familjet dhe komunitetet duke i inkuadruar në materialin mësimor, si bazë për mësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, që vijnë drejtpërdrejtë nga familjet dhe komunitetet<br>• Nxisin fëmijët të hulumtojnë dhe kërkojnë zgjidhje për padrejtësitë shoqërore të cilat ata mund t'i hasin.<br>• Mësojnë si të nxisin të menduarit kritik te fëmijët, rreth keqinterpretimeve, stereotipeve dhe paragjykimeve.<br>Jenë me të hapur për të përfshirë grupet e ndryshme etnike gjejnë forma dhe sugjerime se si të lehtësohet ky proces. |

| | |
|---|---|
| **Përmbajtja:** | Shkathtësitë e mësuara në trajnim ndërtohen mbi Standardet Pedagogjike të ISSA për: individualizimin për të vlerësuar diversitetin në mesin e nxënësve dhe familjeve; pjesëmarrjen e familjes; krijimin e ambienteve mësimore gjithëpërfshirëse; hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme mësimore që promovojnë bashkëpunimin: hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe planifikimin dhe vlerësimin e mësimnxënies. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi **Edukimi për Drejtësi shoqërore – Aktivitete për të rriur dhe fëmijë** do të zgjerojë dhe thellojë njohuritë në këto fusha duke i prezantuar strategjitë për:<br>• zhvillimin e aftësive për të menduar në mënyrë kritike për ta kuptuar realitetin në formë të drejtë dhe angazhimin që duhet bërë për luftimin e padrejtësive<br>• njohur nivelet e ndryshme të përgjegjësisë në përjetimin e dominimit sistematik<br>• ndihmë në transformimin e ambientit të tyre personal, profesional dhe institucional<br>• zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet që tradicionalisht janë të margjinalizuara në sistemin shkollor<br>• përfshirjen e zërit të fëmijëve dhe familjeve në hartimin e programeve<br>• promovimin e kapacitetit të nxënësve për bashkëpunim, negociata dhe mendim kritik duke u siguruar nxënësve mundësi për të përfituar përvojë përmes një llojllojshmërie perspektivash dhe duke modeluar respekt për këndvështrime të ndryshme<br>• zhvillimin e njësive dhe aktiviteteve të integruara që i adresojnë apo inkorporojnë çështjet e drejtësisë shoqërore duke përdorur tema që janë pjesë e kurrikuleve kombëtare, tregime të zakonshme të fëmijëve dhe tema të cilat i iniciojnë fëmijët nga interesat dhe përvojat e tyre (për shembull, drejtësia, përfshirja, bashkëpunimi, si të zgjidhet konflikti dhe ndërprerja e stereotipeve negative); nxënësit gjithashtu mësojnë shkathtësi akademike të përshtatshme për moshën e tyre. |
| **Certifikimi** | Kusht për certifikim është vijueshmëria e plotë e 90% të trajnimit. |
| **Trajner sa trajner:** | 8 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | Edukimi për Ndërmarrësi |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | OJQ " ABSM" |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | OJQ " ABSM" |
| **Adresa:** | Rr. "Nëna Tereze" , pn. Gjakovë |
| **E-mail:** | info@abs-k.org, krenare.rizvanolli@abs-k.org |
| **Telefoni:** | +383 44 123 256, +383 44 759 342 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 91/91, Datë: 10.06.2022,Programi aprovohet për një(1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 20 orë |
| **Përfituesit:** | Ky trajnim i dedikohet mësimdhënësve të të gjitha niveleve dhe drejtimeve në sistemin arsimor. Imagjinata e fëmijëve nuk njeh moshë:<br>• Mësimdhënës fillestar<br>• Mësimdhënës i karrierës<br>• Mësimdhënës i avancuar |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 deri në 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas perfundimit të këtij trajnimi pjesëmarresit do të përfitojnë:<br>• Njohuri për qëllimin e edukimit për ndërmarrësi<br>• Njohuri për edukimin për ndërmarrësi sipas niveleve ne sistem arsimor, sipas klasave, sipas sektoreve.<br>• Njohuri për përkrahje të fëmijëve<br>• Teknikat e motivimit të nxënësve për të menduar drejt zbatimit të idesë |
| **Përmbajtja:** | Modulet:<br>Moduli 1: Korniza e Kompetencës për ndërmarrësi<br>Moduli 2: Procesi i Ndermarrësisë, nga ideja deri të themelimi i biznesit<br>Moduli 3: Nga vijnë idetë e biznesit; analizimi dhe vlerësimi i ideve potencialisht të suksesshme dhe ndërlidhja e tyre me karakteristikat e nxënësit |

| | |
|---|---|
| | Moduli 4: Sfidat dhe përfitimet nga Edukimi për ndërmarrësinë për individin, organizatën dhe shoqërinë |
| **Metodat e realizimit të programit** | Trajnimi realizohet në formë të 4 moduleve me kohëzgjatje 3 ditore, ku gjithsej përmban 20 orë dhe mbahet përgjatë fundjavave. Cdo ditë e trajnimit përfshin një modul së bashku me aktivitetet relevante dhe ofrohet nga ekspertë trajnerë, me kualifikime superiore akademike dhe përvojë relevante në fushën e këshillimit dhe orientimit në karrierë<br>Dita e parë (1) e trajnimit përfshin testin preliminar ndërsa dita e fundit (3) përfshin testin përfundimtar, vlerësimin e trajnimit si dhe shpërndarjen e çertifikatave. Kriteret për përfundimin e trajnimit përfshijnë pjesëmarrjen aktive gjatë trajnimit, 70% përqind ndjekjen e trajnimit si dhe përfundimin me sukses – 70% të testit përfundimtar.<br><br>Gjithashtu, metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat tjera të kurrikulës duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, punë individuale dhe grupore, diskutime, analiza të materialeve/situatave të dhëna gjatë trajnimit, si dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë në mes të kolegëve. |
| **Certifikimi** | CERTQUA Gjermani<br>Euroguidance, Irlande |
| **Trajner sa trajner** | Për këtë program trajnimi janë të paraparë 4 trajnerë:<br>1. Prof.ass.dr. Besim Mustafa<br>2. Prof.ass.dr.Samir Lleshi<br>3. Dr.sc. Elmedina Nikoceviq- Kurti<br>4. Malush Tullumi, PhD cand |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi avancues për edukatorë që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeçare** |
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 65/2018 Data: 12.11.2018<br>Nr. 54/54 Data: 10.06.2022, **Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 5-ditor dhe ka gjithsej 40 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve, si dhe trajnerëve të programit |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit |
| **Përmbajtja:** | Individualizimi, planifikimi global, planifikimi mujor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, përfshirja e familjes, |

| | |
|---|---|
| | prezantimi i librit (matematika, blloqet, shkenca, lexim-shkrimi prezantimi i librit, arti figurativ, familja-dramatizimi, rëra dhe uji). |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për pesë ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur dhoma e punës është e ndarë në qendra mësimore të dedikuara për grup moshat 3-6. Përforcojnë njohuritë për metodologjinë Hap pash hapi, për këtë moshë. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Edukatorët pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 40 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 11 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | HAP PAS HAPI<br>Trajnimi avancues për klasën e parë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 67/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 26/26 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve, studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit |
| **Përmbajtja:** | Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me në qendër fëmijën, individualizimi, rregullimi i klasës me në qendër fëmijën, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, integrimi, roli i mësuesit në klasë me fëmijën në |

| | |
|---|---|
| | qendër, planifikimi, takimi i mëngjesit, mësimi tematik I, mësimi tematik II, vëzhgimi, dokumentimi, lexim – shkrim I, lexim – shkrim II, matematikë, shkencë, vlerësimi, arti, loja dramatike, përfshirja e familjes. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për tri ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur klasa e parë është e ndarë në qendra mësimore. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 12 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi avancues për motra edukatore/edukatoret që punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr.85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 63/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 46/46 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 5-ditor dhe ka gjithsej 40 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet motrave edukatore/edukatoreve të cilat punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Njohje mbi zhvillimin e trurit te fëmijët e moshës 0-3 vjeçare<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për planifikimin e rutinave ditore<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit. |
| **Përmbajtja:** | Kush jemi ne në relacion me fëmijët, qasja gjithëpërfshirëse në zhvillimin e foshnjave dhe fëmijëve, principet e punës, praktikat e përshtatshme zhvillimore, zhvillimi i fëmijës si individ – temperamenti, dallimet individuale, roli jonë në zhvillimin e fëmijëve, vendosja e besimit, zhvillimi i trurit te foshnjat, loja sensorike, si mësojnë foshnjat, të mësuarit përmes lojës, vëzhgimi, ambienti stimulues, të mësuarit përmes rutinës, mbarimi i librave dhe lodrave, familja dhe komuniteti. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për pesë ditë trajnimi avancues, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur dhoma është e ndarë në qendra mësimore të dedikuara |

| | |
|---|---|
| | për grup moshat 0-3. Përforcojnë njohuritë për metodologjinë Hap pash hapi, për këtë moshë. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Motrat-edukatore pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar për këtë nivel kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 40 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 8 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi fillestar për edukatore që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. “Qëndresa”, nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 64/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 27/27 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 5-ditor dhe ka gjithsej 40 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulus për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit. |
| **Përmbajtja:** | Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me në qendër fëmijën, individualizimi, rregullimi i klasës me në qendër fëmijën, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, roli i edukatorit në klasë me fëmijën në qendër, planifikimi global, planifikimi mujor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, takimi i mëngjesit, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, puna |

| | |
|---|---|
| | ekipore, përfshirja e familjes, përdorimi i materialeve reciklluese, qendrat e aktiviteteve (matematika, blloqet, shkenca, lexim- shkrimi, arti figurativ, familja-dramatizimi, rëra dhe uji). |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për pesë ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur dhoma e punës është e ndarë në qendra mësimore të dedikuara për grup moshat 3-6. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Edukatorët pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 40 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 11 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi fillestar për klasën e parë** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 66/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 34/34 Data: 10.06. 2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 5-ditor dhe ka gjithsej 40 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve, studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit |
| **Përmbajtja:** | Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me në qendër fëmijën, individualizimi, rregullimi i klasës me në qendër fëmijën, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, integrimi, roli i mësuesit në klasë me fëmijën në qendër, planifikimi, takimi i mëngjesit, mësimi tematik I, mësimi tematik II, |

| | |
|---|---|
| | vëzhgimi, dokumentimi, lexim – shkrim I, lexim – shkrim II, matematikë, shkencë, vlerësimi, arti, loja dramatike, përfshirja e familjes. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për pesë ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur klasa e parë është e ndarë në qendra mësimore. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 40 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 12 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | HAP PAS HAPI<br>Trajnimi për klasën e katërt |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 75/2018 Data: 12.11.2018<br>Nr. 23/23 Data: 10.06.2022, **Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve, studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit |
| **Përmbajtja:** | Metodologjia Hap pas Hapi në klasën e katërt, përshtatja ndaj stileve të ndryshme të mësimnxënies në klasë, mësimi me tema që përfshijnë grup lëndësh, menaxhimi i klasës, komunikimi I, komunikimi II, strategji mësimdhënieje që nxisin motivimin për të lexuar, teknika dhe strategji që nxisin aftësitë e të shkruarit tek nxënësit, matematikë, shkencë, edukimi |

| | |
|---|---|
| | shoqëror, teknika për të qenë mësues i suksesshëm. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për tre ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur klasa e katërt është e ndarë në qendra mësimore. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 11 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | HAP PAS HAPI<br>Trajnimi për mentor për ngritje të cilësisë së mësimdhënies |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| Tipi i programit: | Program trajnues plotësues |
| Ofertuesi i programit: | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| Adresa: | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| E-mail: | office@kec-ks.org |
| Telefoni: | 038/244-257, lok. 109 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | Nr.12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr.85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr.62/2018 Data: 12.11.2018<br>Nr. 40/40 Data: 10.06.2022, **Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | Programi organizohet në formë të një seminari 4-ditor dhe ka gjithsej 30 orë |
| Përfituesit: | Ky program trajnimi u dedikohet mësimdhënësve, zyrtarëve të lartë të arsimit, pedagogëve, psikologëve, punonjësve social, me më shumë përvojë në programin "Hap pas Hapi" të cilët mund t'iu ndihmojnë mësimdhënësve fillestarë. |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 30 pjesëmarrës |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohuri për rolet dhe përgjegjësitë e mentorit.<br>• Aftësi dhe shkathtësi për përkrahjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.<br>• Njohuri për ciklin e mentorimit<br>• Aftësi për përdorimin e mjeteve dhe të teknikave të reja për mentorim të mësuesve në shërbim, duke përfshirë planifikimin, vëzhgimin, reflektimin dhe zbatimin.<br>Njohuri rreth zbatimit të standardeve pedagogjike/kompetencat të ISSA (Asociacionit ndërkombëtar të programit "Hap pas Hapi") |
| Përmbajtja: | Çka është profesionalizmi dhe cilat janë komponentët e profesionalizmit në mësimdhënie. Karakteristikat dhe rolet e mentorit. Standardet pedagogjike/kompetencat ndërkombëtare të ISSA (Asociacionit ndërkombëtar të programit "Hap pas Hapi").<br>Të njohim dhe përdorim standardet në praktikë. Vëzhgimi praktik në klasë duke përdorur instrumentet e vlerësimit. T'i njohim faktet kundruall mendimeve të cilat dalin nga vëzhgimet në praktikë. Si punojnë mentorët me mësuesit të cilët zbatojnë programin "Hap pas hapi" në nivele të ndryshme. Rolet primare të mentorit. Cikli i mentorimit. Puna me mjete specifike të mentorimit si parafrazimi, pushimi dhe pyetjet nxitëse. Të kuptuarit dhe praktikimi i bisedave të mentorimit për planifikim dhe reflektim. |
| Metodat e realizimit të programit | Ky trajnim ka pjesën teorike dhe atë praktike. Gjatë pjesës teorike, pjesëmarrësit marrin informata se si vlerësohet cilësia sipas kompetencave të edukatoreve, respektivisht mësimdhënësve. Po ashtu informohen për shtatë kompetencat dhe treguesit e tyre. Gjatë pjesës praktike në grupe |

| | |
|---|---|
| | demonstrojnë vëzhgimin e një edukatoreje apo mësimdhënësi dhe pastaj vlerësojnë sipas testit të besueshmërisë. Në këtë fazë për të kaluar pragun secili pjesëmarrës duhet te ketë nivelin e besueshmërisë mbi 85%. |
| **Certifikimi** | 30 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 9 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi fillestar për motra edukatore/edukatoret që punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare** |
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 44/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 53/53 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 5-ditor dhe ka gjithsej 40 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet motrave edukatore/edukatoreve të cilat punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Njohje mbi zhvillimin e trurit te fëmijët e moshës 0-3 vjeçare<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për planifikimin e rutinave ditore<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit. |
| **Përmbajtja:** | Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me qendër fëmijën, çka dimë për foshnjat, zhvillimi i fëmijës si individ – temperamenti, zhvillimi i trurit te foshnjat, zhvillimi emocional, zhvillimi social, zhvillimi i të folurit, zhvillimi fizik, loja sensorike, si mësojnë foshnjat, të mësuarit përmes lojës, vëzhgimi ambienti stimulues, të mësuarit përmes rutinës, mbarimi i librave dhe lodrave, familja dhe komuniteti, puna ekipore, materialet recikluese. |
| **Metodat e realizimit të** | Për pesë ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e |

| | |
|---|---|
| **programit** | organizimit të punës kur dhoma është e ndarë në qendra mësimore të dedikuara për grup moshat 0-3. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Motrat edukatore/edukatoret pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 40 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 8 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **HAP PAS HAPI**<br>**Trajnimi për klasën e dytë** |
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 69/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 25/25 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve, studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive. |
| **Përmbajtja:** | Individualizimi I, individualizimi II, stilet e mësimnxënies, inteligjencat e shumëfishta, integrimi, mësimi tematik, të mësuarit përmes lojës, puna në ekip, mjedisi fizik dhe emocional i klasës, lexim – shkrimi, matematikë – shkenca, edukatë shoqërore. |
| **Metodat e realizimit të** | Për tre ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të |

| | |
|---|---|
| **programit** | punës kur klasa e dytë është e ndarë në qendra mësimore. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 11 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | HAP PAS HAPI<br>Trajnimi për klasën e tretë |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| Tipi i programit: | Program trajnues themelor |
| Ofertuesi i programit: | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| Adresa: | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| E-mail: | office@kec-ks.org |
| Telefoni: | 038/244-257, lok. 109 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | Nr. 12/2011 Data:19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data:13.11.2013<br>Nr. 68/2018 Data:12.11.2018<br>**Nr. 24/24 Data:10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë |
| Përfituesit: | Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve, studentëve, si dhe trajnerëve të programit. |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 30 pjesëmarrës |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:<br>• Njohjen e koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën<br>• Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit kooperativ që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Aftësi për planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies<br>• Shkathtësi për vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë<br>• Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore<br>• Ide për krijimin e një ambienti stimulues për mësimnxënie aktive<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit<br>• Njohuri për përfshirjen e familjes në realizimin e programit |
| Përmbajtja: | Individualizimi I, individualizimi II, stilet e mësimnxënies, inteligjencat e shumëfishta, integrimi, mësimi tematik, të mësuarit përmes lojës, puna në ekip, mjedisi fizik dhe emocional i klasës, lexim – shkrimi, matematikë – shkenca, |

| | |
|---|---|
| | edukatë shoqërore. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Për tre ditë trajnimi, pjesëmarrësit marrin informata për format e organizimit të punës kur klasa e tretë është e ndarë në qendra mësimore. Pjesëmarrësit kanë rastin të punojnë punë individuale si dhe grupore, duke demonstruar aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrësit pos pjesëmarrjes së rregullt kusht për certifikuar kanë edhe përgatitjen dhe realizojnë e një plan javor sipas metodologjisë Hap pas hapi për këtë nivel i cili vlerësohet. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 11 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Hartimi dhe Menaxhimi i projekteve në fushën e Arsimit |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues **plotësues** |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.02/2 Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një(1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Kohëzgjatja : 3 ditë<br>Numri i orëve në total: 24<br>Numri i orëve për modul : 8 |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënës i karrierës<br>Mësimdhënës i avancuar<br>Mësimdhënës mentor |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25 kandidatë |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të trajnimit, duhet të jenë në gjendje:<br>Te zhvillojne aftesite per vleresimin e nevojave per hartimin e projekteve<br>të zhvillojnë njohuritë rreth qëllimit projekteve<br>të identifikojnë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e menaxhimit te projektit<br>të zhvillojnë shkathtësitë rreth zbatimit te projekteve<br>të përcaktojnë qartë planin per hartimin e projekevte<br>te zhvillojne njohurite rreth monitorimit dhe vleresimit gjate implementimit te projekteve<br>të realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja e projektit do të jetë fillimisht duke trajtuar aspektet kryesore të koncepteve të ndryshme të projektit në përgjithësi dhe efektivitetit të hartimit të projekteve në përgjithësi. Duke vazhduar më tutje me përmbajtjen konceptuale kryesore të programit me gjithsej katër module duke përfshirë.<br><br>I - **Hartimi i projekteve**;<br>Forma të ndryshme të hartimië të projekteve<br>Instruksionet dhe udhëzues për hartim të projekteve<br>Planifikimi i projekteve<br>Pani i Zbatimit të projekteve<br>Zbatimi i planit të projektit dhe planifikimi i bartësve të aktiviteteve<br><br>**II Menaxhimi i Projekteve**<br>Menaxhimi i burimeve njerëzore<br>Sigurimi i buxhetit nga rrethanat e jashtme |

| | |
|---|---|
| | Menaxhimi i buxhetit<br><br>**III- Monitorimi dhe vlerësimi**<br>Rëndësia e procesit të monitorimit dhe Vlerësimit<br>Teknikat e ndryshme për format e monitorimit dhe Vlerësimit<br><br>**IV Raporti Përfundimtar**<br>Përmbajtja e raportit përfundimtar<br>Rekomandimet |
| **Metodat e realizimit të programit** | Edumen-K me anë të trajnuesve me eksperiencë të gjatë si në edukim dhe në fushën e Menaxhimit te Projekteve ofron disa metoda duke u përshtatur me kërkesat sipas trajnimit, teknologjitë më të fundit, kërkesat e trajnuesve, kërkesat e kandidateve. Çdo program ka focus të veçantë në realizimin e detyrave dhe projekteve praktike për t'u përgatitur sa më mire profesionalisht dhe me cilësi.<br><br>Metodologjia e zbatimit të këtij programi, përmban metodat që do të përdoren për secilën seancë të trajnimit, mjetet mësimore për konkretizim dhe detyrat për pjesëmarrësit që do të kryhen pas zhvillimit të modulit. |
| **Certifikimi** | Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 5% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit.<br>Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajnerët zbatojnë me përpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë se aplikuar gjatë trajnimit.<br><br>*Perfshirja aktive 10%*<br>*Pjesa praktike 50%*<br>*Testi vlerësues 40%* |
| **Trajner sa trajner** | Bujar Thaqi, Valmirë Shatri, Valentina Qarri |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |
| | |
| | |

| Titulli i Programit: | HULUMTIMI NË VEPRIM |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. “Qëndresa”, nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 76/13 Data: 12.06.2013<br>Nr. 138/2015 Data: 21.12.2015<br>Nr. 48/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 31/31 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor, si dhe bëhet zbatimi praktik në shkollë nga mësimdhënësit. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Me këtë program trajnues synohen mësimdhënësit e të gjitha fushave në mënyrë që të identifikojnë situatat problemore në mësimdhënie/mësimnxënie dhe t'i përmirësojnë praktikat arsimore përmes hulumtimit në veprim. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:<br>• identifikojnë situata/probleme të lidhura me mësimdhënien, të nxënit dhe arsimin në përgjithësi;<br>• shqyrtojnë literaturë profesionale dhe shkencore në lidhje me çështjet arsimore;<br>• reflektojnë rreth praktikës së tyre profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm dhe në interes të përmirësimit të rezultateve të nxënësve në klasë/shkollë.<br>• analizojnë lidhjet në mes të teorisë dhe praktikës në fushën e arsimit duke vendosur hulumtimin në klasë/shkollë në një kontekst të ndërvarur;<br>• zhvillojnë projekte të hulumtimit në klasë apo shkollën ku punojnë dhe të shkruajnë raportin e atij hulumtimi;<br>• bashkëpunojnë me 'miqtë kritik' për të reflektuar për vlefshmërinë e hulumtimeve në klasat e tyre. |
| **Përmbajtja**: | Hulumtimi në veprim; Hulumtimi në veprim dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve; Hartimi i planit të hulumtimit në veprim; Mbledhja e të dhënave (cilësore dhe sasiore); Analiza e të dhënave; Interpretimi i rezultateve dhe diskutimi i tyre; Shkrimi i raportit – Procedurat e shkrimit dhe prezantimi i një projekti. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet mbajtjes së një trajnimi 3-ditor si dhe bëhet realizimi i hulumtimit në veprim në shkollë. |
| **Certifikimi:** | Pjesëmarrja mbi 90% në trajnim dhe realizimi me sukses i hulumtimit në veprim në shkollë. |
| **Trajnerë:** | 6 trajnerë |
| **Data e aplikimit:** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **Identifikimi i nevojave për trajnime dhe azhurnimi i standardeve të profesionit përmes TNA/SKNA** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.62/62,Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 16 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Krijoj pyetësor për të identifikuar nevojat e tregut për profesione<br>• Krijoj pyetësor për të identifikuar dhe azhurnuar kompetenca sipas standardeve të profesionit<br>• Identifikoj palët me interes për fushën e institucionit shkollor<br>• Integroj dhe analizoj rezultatet e përmbledhura nga pyetësorët |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Njohja me modulet elektronike Kërkesa e bizneseve për profile dhe Analiza e Kompetencave<br>• Shpjegimi i funksionaliteteve të moduleve elektronike<br>• Krijimi i pyetësorëve të ndryshëm<br>• Përmbledhja e rezultateve të dalura nga pyetësorët e mbledhur<br>• Prezantimi i rezultateve pranë AKK dhe autoriteteve tjera |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor** Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër** |

| | |
|---|---|
| | Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% me sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit | Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të nxënë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Numër: 08/8 Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 6 ditë<br>Numri i orëve 48 |
| **Përfituesit:** | Nga ky program do të përfitojnë:<br>• Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02);<br>• mësimdhënësit e licencuar me gradat e mësimdhënësit të karrierës,<br>• mësimdhënësit të avancuar,<br>• mësimdhënësit mentor dhe të mësimdhënësit të merituar;<br>kordinatorët e cilësisë |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosvës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas trajnimin të përfunduar pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të jenë në gjendje:<br><br>-Shpjegojnë konceptet themelore që kanë të bëjnë me çështjet e përgjithshme të gjithëpréfshirjes;<br>- Analizojnë dëmtimet dhe nivelet e kategorive të personave - fëmijëve me nevoja të vecanta;<br>- Përvetësimi i njohurive elementare dhe i shkathësive të nevojshme për të inkuadruar personat me nevoja të veçanta në aktivitete.<br>- Prezantojnë këndvështrimet reja shkencore ne hapesiren e vlerësimit dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta;<br>- Argumentojnë përdorimin e strategjive të mësimdhënies për fëmijët me nevoja të vecanta,veçanërisht fëmijëve me vështirësi në të nxënë, duke ua përshtatur mësimin shkallës së dëmtimeve të personave, duke zbatuar planin individual të edukimit (PIE);<br>- Interpretojnë përparësitë e strategjive të mësimdhënes<br>- Të vizitojnë Qendra Burimore, Klasa të Bashkangjitura, Klasa inkluzive me qëllim të njohjes nga afër të vështirësive të fëmijëve<br><br>- Të argumentojnë mundësinë e sendërtimit të edukimit inkluziv në institucionet shkollore në Kosovë |
| **Përmbajtja:** | Arsimi gjithëpërfshirës dhe arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta janë koncepte të përdoruara me disa dallime ne diskutimet arsimore ndërkombëtare e po ashtu edhe në diskutimet arsimore në Kosove ku |

| | |
|---|---|
| | ende mund të ndeshen profesorë universitar dhe ekspert të arsimit special që thonë se arsimi gjithëpërfshirës është thjesht fjal e re për arsimin special. Gjithëperfshirja shikohet si proces i paraqitjes dhe përgjigje e diversitetit të nevojave të të gjithë nxënësve me ane të rritjes se pjesëmarrjes në të nxënit, kulturat dhe komunitetet dhe zvogëlimit të përjashtimit brenda dhe nga arsimi. Ai përfshin ndryshime dhe përshtatje në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji, me një vizion të përbashkët që përfshin të gjithë fëmijët e një grupmoshe të përshtatshme dhe me bindjen se është përgjegjësi e sistemit të rregullt që ti arsimoje të gjithë fëmijët.<br>Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në të cilën kombinohen shumë natyrshëm procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre.<br>Programi i trajnimit (moduli) është projektuar për të pajisur mësimdhënësit me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që ato kanë nevojë në mënyrë që të zbatojnë programin mësimor (në këtë rast në Kosovë) në klasat e tyre. Ai përbëhet nga kurset e njohurive profesionale në mësimdhënie, njohuri në terren, identifkimin si dhe qasjen ndaj fëmijëv me vështirë në të. Trajnimi është përqendruar në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, dhe njohurit do të ofrohen gjatë një periudhe nje javore të trajnimit intensiv.<br>Kjo është një fushë në të cilën OJQ "Edumen- K" do të kontribuojë pa çështjen sfiduese te qëndrueshmërisë.<br><br>Me program janë paraparë IV module.Fondi orientues i orëve sipas moduleve paraqitet në vazhdim:<br>1. **Identifikimi i fëmijëve me vështirësi në të lexuar / disleksia-**<br>2. **Identifikimi i fëmijëve me vështirësi në të shkruar/disgrafia**<br>3. **Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në shkathtësitë motorike/dispraksia**<br>4. **Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në matematikë/ diskalkulia** |
| **Metodat e realizimit të programit** | Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me moton e psikologut të shquar *Kurt Levinit: "Se teoria më e mirë është praktika e mirë , se praktika më e mirë është teoria e mirë"*. Gjatë trajnimit 40% e kohës do të jetë punë teorike dhe 60 % e kohës pjesëmarrësi do të bëjnë punë praktike. Në trajnim do të përdoren metodologjitë e më poshtme:<br><br>• Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve<br>• Mësimdhënia algoritmike<br>• Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t<br>Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit, dhe<br>• Mësimdhënia autentike<br>• Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese |
| **Certifikimi** | **Për certifikim vlerësohen: Portofoli i përgatitur (5 pikë); Vijimi i** |

| | |
|---|---|
| | **rregullt i trajnimit** (5 pikë); Vizita në institucione e parapara (5) pikë; Përgjigjet e sakta në test – (30 pikë); punë praktike nga një temë nga praktika.<br>Pjesëmarrësit u nënshtrohen tre testeve që lidhen:<br>Test mbi njohuritë e nocioneve themelore (10 pikë):<br>Rast studimor i identifikimit 25 pikë<br>Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të krijojnë portofolin (25 pikë). |
| **Trajner** | Prof. dr. Saranda Shatri – Dokrore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare<br>Prof. Armen Mustafa –<br>Ma. Trendelina Krasniqi, |
| **Data** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË FËMIJËVE NË KOPSHT DHE NË SHKOLLË |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Adresa:** | rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë |
| **E-mail:** | qeht.konica@gmail.com |
| **Telefoni:** | 049 328 528 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr.72/72, dt. 10.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 32 orë |
| **Përfituesit:** | 1. Edukatoret e institucioneve parashkollore;<br>2. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3; |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të:<br>1. Të familjarizohen me sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve / nxënësve;<br>2. Të identifikojnë problemet shëndetësore të fëmijëve / nxënësve;<br>3. Ta japin ndihmën e parë në klasë për fëmijët / nxënësit që manifestojnë probleme shëndetësore;<br>4. Ta referojnë sëmundjen e fëmijës / nxënësit te prindërit në fazë të hershme të saj, në mënyrë që të parandalohet / shërohet sëmundja me kohë. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit të mësimdhënësve *Identifikimi i problemeve shëndetësore të fëmijëve në kopsht dhe klasë*, përbëhet nga 3 module të cilat realizohen në 3 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike. Moduli i katërt përfshin pjesën e monitorimit.<br>Dita e parë e trajnimit:<br>Moduli 1: Problemet shëndetësore akute të fëmijëve<br>Dita e dytë e trajnimit:<br>Moduli 2: Problemet shëndetësore kronike<br>Dita e tretë e trajnimit:<br>Moduli 3: Problemet shëndetësore mentale<br>Moduli 4:<br>Monitorimi i edukatoreve / mësimdhënësve për identifikimin e |

| | |
|---|---|
| | problemeve shëndetësore. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike lidhur me tri modulet e trajnimit dhe temat e përfshira në këto module, ndërlidhjen e tyre me kërkesat dhe nevojat e edukatoreve e mësimdhënësve si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel klase. Programi trajnues ofrohet gjatë vikendeve, meqë secili modul ka një ditë të trajnimit dhe pas përfundimit të çdo dite të trajnimit do të ketë detyra praktike për pjesëmarrësit, të cilat realzohen gjatë punës në shkollë.<br>Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit.<br>Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës.<br><br>Qasja e përzgjedhur për këtë program të trajnimit ofron mundësi që mësimdhënësit të jenë të përfshirë në aktivitete të përbashkëta, nën udhëheqjen e një trajneri, i cili është mjek gjithashtu, për të diskutuar e provuar ide e forma të ndryshme të zbatimit të praktikave. |
| **Certifikimi** | Certifikimi, 32 orë |
| **Trajner** | Dr. Rita Qarkaxhija<br><br>Dr. Nita Ymeraga<br><br>Dr. Atdhe Haxhibeqiri |
| **Data** | 28.07.2022 |

| Titulli i Programit: | KËSHILLIMI DHE ORIENTIMI NË KARRIERË |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr.51/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr.48/48 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Gjithsej programi organizohet me gjithsej 24 orë angazhim kohor:<br>Trajnimi: 18 orë kontaktuese; 6 orë për implementimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në takimet reflektuese (përgatitje, konsultime online, observime në klasë, etj.) |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet të gjithë mësimdhënësve të fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:<br>• Identifikojnë aktivitet e OKK të dalura nga rezultatet e pritura mësimore të përshkruara në Kurikulin e Kosovës<br>• Përdorin platformën elektronike busulla.com për të demonstruar kërkimin për shkolla dhe IAL, për të diskutuar për profesione dhe për të bërë teste të ndryshme të karrierës si testi i karrierës dhe Basic Check, etj.<br>• Analizojnë dhe zhvillojnë një metodë të mësimdhënies duke përdorur qasjen e bazuar në rezultate<br>• Reflektojnë mbi mësimdhënien e tyre dhe të japin vlerësime konstruktive kolegiale. |
| **Përmbajtja**: | Përmes trajnimit të mësimdhënësve në këtë program do të zbërthehen konceptet e karrierës në aktivitete konkrete, duke i lidhur ato me rezultatet mësimore të fushës 'jeta dhe puna'. Në këtë aspekt do të punohet me plane konkrete mësimore të klasave ku mësimdhënësi mban mësimin. Gjatë implementimit të njohurive me nxënësit në klasë, mësimdhënësit do të mbajnë portfoliot e tyre, të cilat do t'i prezantojnë në ditën e fundit të trajnimit. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnim do të jenë në gjendje që të shfrytëzojnë platformën elektronike busulla.com, dhe të njëjtat do t'i përcjellin te nxënësit e tyre por edhe te prindërit e nxënësve. Tërë procesi i trajnimit do të jetë i mentoruar nga fasilituesit profesionalë. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin detyrat përgatitore duke pranuar materialin për lexim fillestar. Pastaj, pjesëmarrësit do të vijojnë tri ditë të plota, secila ditë me nga katër sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. |
| **Certifikimi:** | Kushtet për certifikim: 90% me pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor; Portfolio që dëshmon se janë zbatuar aktivitetet në klasë |

| | |
|---|---|
| | me nxënësit (më së paku 5 plane mësimore të lidhura me rezultatet mësimore / apo një projekt mësimor); [për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore (përveç ‘jeta dhe puna‘) janë të mjaftueshme 2 plane mësimore. |
| **Trajnerë:** | 3 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | KLASA E ORIENTUAR KAH NXËNËSI |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 70/13 Data: 03.04.2013<br>Nr. 139/2015 Data: 21.12.2015<br>Nr. 47/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 32/32 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor, si dhe bëhet zbatimi praktik në shkollë nga mësimdhënësit. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve klasorë (1-5) që të zhvillojnë shkathtësitë e rregullimit të ambientit mësimor me qëllim të bëhet më i përshtatshëm dhe më nxitës për nxënësit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:<br>• Kenë njohuri për mësimdhënien e orientuar kah nxënësit duke iu përshtatur nevojave, aftësive dhe interesave te tyre;<br>• Kuptojnë rëndësinë e lojës dhe argëtimit gjatë procesit të mësimit që ka për qëllim t'u mundësojë nxënësve pjesëmarrje aktive;<br>• Kenë njohuri për menaxhimin e klasës që përfshin: rregullimin e ambientit me qendra të aktiviteteve, planifikimin e punës duke u bazuar ne kurrikulë, klimën pozitive, etj.;<br>• Kenë njohuri për format e ndryshme të vlerësimit për nxënie që ndikojnë në zhvillimin e aftësive akademike dhe vetëbesimit të nxënësit me qëllim të ngritjes së performancës së tyre;<br>• Kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit të familjes me komunitetin si dhe të planifikojnë strategji për intensifikimin e këtij bashkëpunimi;<br>• Kenë ide se si t'i shfrytëzojnë materialet ricikluese si mjete pune në klasë. |
| **Përmbajtja**: | Klasa e orientuar kah nxënësi (Qendrat dhe materialet); Menaxhimi i klasës; Bashkëpunimi i shkollës me familjen dhe komunitetin; Mësimi i diferencuar; Si ndikon loja në të nxënit; Vlerësimi i të nxënit; Planifikimi i një dite pune duke integruar lëndët në një temë; Krijimi i mjeteve mësimore nga materialet ricikluese. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Kursi treditor do të zbatohet nga 2 kryefasilitatorë të aftësuar dhe certifikuar nga KEC. Dy ditët e para mbahen radhazi, ndërsa dita e tretë realizohet pas një muaji pasi që mësimdhënësit të kenë realizuar "Planin e veprimit të rregullimit të klasës". Ndryshimet e bëra në klasa përfshijnë: mjedisin e ndryshuar dhe të përmirësuar në klasë, pjesëmarrësit në këtë proces, krijimin e komunitetit të nxënësve të klasës, bashkëpunimin me familje dhe komunitet, menaxhimi i klasës, përdorimi e lojërave për mësim, planifikimin, etj. Një pjesë e ditës të tretë i dedikohet prezantimeve të këtyre planeve. |

| | |
|---|---|
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e kursit mbi 90%, realizimi i "Planit të veprimit" dhe prezantimi i këtij plani gjatë ditës së tretë të kursit dhe përgatitja e dosjes profesionale. |
| **Trajnerë:** | 4 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **KLUBI I TEKNIKËVE** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 71/13 Data 03.04.2013<br>Nr. 30/2015 Data 21.12.2015<br>Nr. 58/2018 Data 12.11.2018<br>**Nr. 45/45 Data 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Numri i orëve të programit trajnues është 24 orë. Orët e trajnimit janë 18. Orët e mentorimit dhe punës me nxënës janë 6. |
| **Përfituesit:** | Të gjithë mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të ulta dhe shkollave të mesme të larta, Gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave VI, VII, VIII, IX, X, XI, dhe XII. Ky program trajnimi do të duhej të ishte plotësues sa i përket licencimit të tyre. Ndërsa, ky program poashtu është i përshtatshëm edhe për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore të interesuar në teknologji arsimore të këtij niveli të shkollimit, si trajnim plotësues, numri i të cilëve nuk është i kufizuar. Përmes mësimdhënësve të trajnuar, do të punohet me nxënësit e shkollës, pjesëtar të klubit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:<br>• formojnë klubin e teknikëve për të përkrahur mësimdhënësit/et dhe nxënësit/et në shfrytëzimin e pajisjeve të teknologjisë informative;<br>• mirëmbajnë laboratorin e teknologjisë informative si nga ana harduerike ashtu edhe nga ana softuerike;<br>• bëjnë menaxhim bazik të rrjetave;<br>• njohin rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të pajisjeve arsimore;<br>• analizojnë përdorimin e drejtë dhe jo të drejtë të pajisjeve arsimore në shkollë;<br>• shfrytëzojnë udhëzime të ndryshme nga manuali për tu siguruar në përdorimin e drejtë të pajisjeve në shkollë;<br>• krijojnë njësi/ aktivitete praktike në fokus integrimin e lëndëve në mes veti. |
| **Përmbajtja**: | Ky program ju mundëson pjesëmarrësve të formojnë dhe menaxhojnë klubin e teknikëve (nxënësve) në shkollë. Funksionimi i këtij klubi do të ndikojë në integrimin e teknologjisë arsimore në procesin mësimor e me këtë edhe zbatimin e kurrikulës së re të Kosovës. Ky klub do të bëjë mirëmbajtjen e pajisjeve arsimore brenda shkollës, përkrahjen e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë, përkrahë mësimdhënësit në dokumentimin e punës së tyre me pajisje arsimore, kontribojë në zhvillimin e projekteve të |

| | |
|---|---|
| | ndryshme brenda shkollës etj. Pjesëtarë të këtij klubi do të jenë nxënësit e klasëve X, XI dhe XII. Kompetencat e arritura nga ky trajnim janë të bazuara në rezultatet mësimore nga Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë të Kosovës, Gjimnazet – klasa VI, VII, VIII, IX,X, XI, dhe XII. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Metodologjia e ofrimit të programit trajnues do të jetë kryesisht punë në grupe dhe me shumicën e aktiviteteve të kryera praktikisht gjatë programit.<br>Programi organizohet përmes sesioneve trajnuese që zgjasin 3 ditë trajnimi dhe 1 ditë praktikë. Gjatë tri ditëve të trajnimit ofrohet e gjithë përmbajtja e trajnimit, ndërsa pjesëmarrësit pastaj në shkollë duhet të përmbushin disa detyra specifike. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 90% në trajnim dhe formimi i klubeve teknike në shkollë. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | KNF dhe përdorimi i instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Save the Children |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Save the Children |
| **Adresa:** | Rr. Filip Shiroka, nr. 27, 10,000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | scik@savethechildren.org |
| **Telefoni:** | +383 38 551 691 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 78/78 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi i trajnimit është 2-ditor, trajnim i drejtpërdrejtë me gjithsej 16 orë trajnimi |
| **Përfituesit:** | Programi i trajnimit synon të rrisë kapacitetet e mësimdhënësve të nivelit fillor dhe të mesëm të ulet për përdorimin e instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 500 mësimdhënës në nivelit fillor dhe të mesëm të ulet (deri në 25 pjesëmarrës për grup) |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Trajnimi synon të arrijë këto rezultate:<br>• Njohjen e instrumentin ndërkombëtar KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit për fëmije dhe të rinjë).<br>• Ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e instrumentit/ formularëve për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta<br>• Njohjen e kërkesave që ka instrumenti /formulari e raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit;<br>• Rritjen e cilësisë së vlerësimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;<br>• Rritjen e numrit të fëmijëve/nxënësve të vlerësuar që marrin shërbime;<br>• Rritjen e shkathtësive për vëzhgim të fëmijës dhe përshkrimin e aftësive/ mundësive të funksionimit të fëmijës sipas kërkesave të formularit;<br>• Ngritjen e shkathtësive të planifikimit të mësimdhënies bazuar në mundësitë dhe potencialet që kanë fëmijët me nevoja të veçanta. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit dy ditor përmban informata dhe burime të cilat ju ofrohen mësimdhënësve rreth gjendjes aktuale të arsimit gjithëpërfshirës në vend, legjislacionit aktual në fushën e arsimit gjithëpërfshirës në të cilat mbështeten instrumentet dhe udhëzimet për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe për tërë procesin e vlerësimit, rolet dhe përgjegjësitë e shkollës, mësimdhënësve, si dhe prezantimin e KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit për fëmije dhe të rinjë) mbi të cilin janë zhvilluar instrumentet për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.<br>Programi i trajnimit e ka pjesën teorike të gërshetuar me punën në grupe duke përfshi sesione reflektimi ku mësimdhënësit kanë mundësi të |

| | |
|---|---|
| | reflektojnë për çështje që lidhen me KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit për fëmije dhe të rinjë) dhe ndërlidhja me punën e tyre në veçanti me pjesën që lidhet me aktivitetet dhe pjesëmarrjen e cila lidhet ngushtë me mënyrën se si duhet të shikohet përspektiva e fëmijës me nevoja të veçanta.<br>Po ashtu përdorimi instrumenteve gjatë trajnimit, ju mundëson pjesëmarrësve përfitimin e shkathtësive për identifikimin, përshkrimin e aftësive dhe shkathtësive të fëmijës përmes vëzhgimit që ata e aplikojnë për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në instrumente. Instrumentet ju mundësojnë mësimdhënësve të vlerësojnë perspektivat e kufizimeve të pjesëmarrjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në të nxënë duke përfshirë aspektin shëndetësor, të marrëdhënieve, kurrikulës dhe ajo zhvillimore. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e trajnimit është teorike dhe praktike, në pjesën teorike trajtohen aspektet që lidhen me kontekstin, politikat aktuale në fushën e arsimit gjithëpërfshirës si dhe (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit për fëmije dhe të rinjë) KNF-në. Pjesa teorike i paraprinë njohurive praktike që lidhen me përdorimin e instrumenteve ku pjesëmarrësit duhet të demonstrojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre për përdorim të instrumenteve bazuar në rastet e studimore.<br><br>Metodat dhe teknikat e punës që përdoren në trajnim: Prezantim- thyerje e akullit, stuhi mendimesh, prezantim teorik, punë në grupe, prezantime të detyrave, diskutim në grup, reflektim. |
| **Certifikimi** | Certifikimi behet nga Save the Children dhe MASHTI |
| **Trajner sa trajner** | Trajnimi do të ofrohet nga 5 trajnerë |
| **Data e aplikimi** | Prill 2022 |

| Titulli i Programit: | KOORDINIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL ME BAZË NË SHKOLLË |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 112/14 Data: 31.07.2014<br>Nr. 150/2016 Data: 07.06.2016<br>**Nr. 29/29 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor, si dhe bëhet hartimi i planit për zhvillim profesional të mësimdhënësve të shkollës nga pjesëmarrësit. Programi ka gjithsej 30 orë: 18 orë janë të parapara për trajnim, ndërsa 12 për hartim të planit. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve, koordinatorëve e anëtarëve të ekipeve shkollore për zhvillim profesional. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:<br>• Njihen me kornizën ligjore që lidhet me zhvillimin profesional të mësimdhënësve;<br>• Kuptojnë modelet e ndryshme të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;<br>• Përvetësojnë Kornizën e Zhvillimit Profesional me Bazë në Shkollë;<br>• Demonstrojnë shkathtësi në vlerësimin e nevojave të zhvillimit profesional në shkollë<br>• Bëjnë analizën e nevojave për zhvillim profesional të mësimdhënësve<br>• Shqyrtojnë në mënyrë kritike të gjeturat dhe përcaktojnë përparësitë në ZhPM<br>• Udhëheqin procesin e hartimit të planit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve<br>• Tregojnë zotësi të planifikimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional<br>• Kuptojnë rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. |
| **Përmbajtja:** | Koncepte të zhvillimit profesional të mësimdhënësve; Zhvillimi profesional më bazë në shkollë; Planifikimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle - Vlerësimi i nevojave për ZhPM; Planifikimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle – Prezantimi i gjetjeve dhe validimi i tyre; Planifikimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle – Caktimi i përparësive; Planifikimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle – Hartimi i planit; Prezantimi i planit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve; Zbatimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në shkollë; Dokumentimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në shkollë. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet në formë të kursit treditësh, i cili ofrohet sipas formulës 1 + 1 + 1. Kjo nënkupton që ofrohet në tri ditë të ndara, në mes të cilave pjesëmarrësit marrin detyra për t'i kryer në shkollat e tyre. Kështu në mes të |

| | |
|---|---|
| | ditës së parë dhe të dytë pjesëmarrësit kanë për detyrë të bëjnë vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional dhe të vijnë ditën e dytë me rezultatet nga ky vlerësim. Në mes të ditës së dytë dhe të tretë, pjesëmarrësit kanë për detyrë që në nivel shkolle të hartojnë planin për zhvillim profesional dhe ta prezantojnë në fillim të ditës së tretë. Pas përfundimit të kursit pjesëmarrësit koordinojnë (koordinatorët) apo ndihmojnë (anëtarët tjerë të ekipit shkollor) në koordinimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në shkollën e tyre. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e kursit mbi 90% dhe koordinimi i punës në hartimin e planit shkollor për zhvillim profesional të mësimdhënësve. |
| **Trajnerë:** | 3 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Krijimi dhe menaxhimi i bankës së pyetjeve |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| Tipi i programit: | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| Ofertuesi i programit: | Smart Bits |
| Adresa: | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| E-mail: | info@smart-bits.ch |
| Telefoni: | 044168688 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | 65/65, 10.06.2022 |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | 8 orë |
| Përfituesit: | • Mësimdhënësit<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 16 |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Të kuptoj rëndësinë e sistemit automatik për testim<br>• Regjistron me sukses llogarinë në platformë<br>• Përdor funksionet për abonim te autorët e testeve<br>• Gjej historinë e testeve të krijuara më parë<br>• Të kuptoj konceptin e bankës së pyetjeve dhe funksionet kyçe të kësaj komponentë<br>• Krijoj dhe menaxhoj bankën e pyetjeve |
| Përmbajtja: | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Njohja me platformën Evaluo.ORG<br>• Regjistrimi dhe kyçja në platformë<br>• Dërgimi i ftesave për testim<br>• Njohja me funksionet e bankës së pyetjeve<br>• Krijimi dhe menaxhimi i bankës së pyetjeve<br>• Krijimi dhe publikimi i testeve<br>• Ndryshimi i të dhënave të profilit |
| Metodat e realizimit të programit | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor** Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan |

| | |
|---|---|
| | <u>Personal të Zhvillimit</u> si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit: | Krijimi dhe publikimi i testeve |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| Tipi i programit: | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| Ofertuesi i programit: | Smart Bits |
| Adresa: | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| E-mail: | info@smart-bits.ch |
| Telefoni: | 044168688 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | 56/56, 10.06.2022 |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | 8 orë |
| Përfituesit: | • Mësimdhënësit<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 16 |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Të kuptoj rëndësisë së sistemit automatik për publikim dhe krijim të testeve<br>• Regjistrimi dhe kyçja me sukses në platformë<br>• Shtjellimi i funksionaliteteve të platformës dhe përdorimi i komponentëve<br>• Krijimi, publikimi, ndryshimi dhe fshirja e testeve të formateve të ndryshme<br>• Shpjegimi i formateve të ndryshme të pyetjeve për krijimin e testeve<br>• Dërgimi i ftesave për testim duke përdorur funksionet e platformës, siç janë: kohëzgjatja, data e testimit, mundësia për testim vetëm një herë ose disa herë etj. |
| Përmbajtja: | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Njohja me platformën Evaluo.org<br>• Regjistrimi dhe kyçja në platformë<br>• Navigimi në faqen hyrëse dhe shtjellimi i komponentëve përkatëse<br>• Përdorimi i funksioneve për abonim të autorëve të testeve të ndryshme |

| | |
|---|---|
| | • Dërgimi i ftesave për testim<br>• Njohja me funksionet e bankës së pyetjeve<br>• Krijimi dhe publikimi i testeve<br>• Përcaktimi i kostos së testeve |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor**<br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit: | Mbështetja psikosociale, të mësuarit socio-emocional dhe mirëqenia e mësimdhënësve |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Save the Children |
| ATipi i programit: | Program trajnues plotësues |
| Ofertuesi i programit: | Save the Children |
| Adresa: | Rr. Filip Shiroka, nr. 27, 10 000 Prishtinë, Kosovë |
| E-mail: | scik@savethechildren.org |
| Telefoni: | +383 38 55 16 91 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | **Nr. 77/77, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | Programi i trajnimit është një-ditor, me gjithsej 8 orë trajnimi. |
| Përfituesit: | Programi synon ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve të nivelit fillor dhe të mesëm të ulet për të përkrahur mësimin social dhe emocional të nxënësve të tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të sigurojne atyre ndihmën e parë psikologjike dhe zbatojnë masat e domosdoshme për rikthim të sigurte në shkolla |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 500 mësimdhënës në nivelit fillor dhe të mesëm të ulet (deri në 25 pjesëmarrës për grup) |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Pas përfundimit të programit, të trajnimit, pritet që mësimdhënësit të jenë në gjendje të:<br>- Njohin ndikimin e COVID-19 tek fëmijët, të rinjtë dhe mësimdhënësit, me theks të veçantë në shëndetin mendor;<br>- Njohin ndikimin e përjashtimit shoqëror dhe stigmatizimit si pasojë e COVID-19, përfshirë aspektet mbrojtëse dhe strategjitë për t'a adresuar stigmatizimin;<br>- Të identifikojnë dhe njohin nevojat psiko-sociale dhe mirëqenien socio-emocionale, në aspektin personal dhe tek nxënësit e tyre;<br>- Të identifikojnë shenjat e shqetësimeve dhe të jenë në gjendje të shpjegojnë efektet e stresit dhe nivelit të ulët të mirëqenies në procesin e të nxënit dhe të zhvillimit të nxënësve, si dhe të jenë në gjendje t'i adresojnë këto efekte në mënyrë adekuate;<br>- Të promovojnë përkrahjen psiko-sociale dhe të përdorin strategji të të nxënit socio-emocional për të përkrahur mirëqenien e nxënësve.<br>- Të kuptojnë rëndësinë e mirëqenies dhe të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të stresit gjatë mësimdhënies;<br>- T'i identifikojnë shenjat e stresit dhe metodat për të mbështetur mirëqenien e tyre si mësimdhënës<br>- Të menaxhojnë në mënyrë praktike stresin dhe të kuptojnë |

| | |
|---|---|
| | aftësitë vet-rregulluese. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit përmban informacione relevante për fushën / tematikën, tema diskutimi, si individuale po ashtu në grup, dhe ushtrime e aktivitete grupore në funksion të përkrahjes së qasjes interaktive përgjatë trajnimit dhe synimeve për gjithëpërfshirje të pjesëmarrësve/mësimdhënësve. Të gjitha këto dimensione, parashikohet që të ndihmojnë dhe përkrahin mësimdhënësit që njohuritë dhe praktikat që marrin në kuadër të trajnimet, të jenë në gjendje t'i kenë parasysh dhe t'i aplikojnë me nxënësit e tyre në klasë.<br><br>Përmbajtja e këtij trajnimi ndihmon mësimdhënësit që të jenë të lirë dhe fleksibil t'u referohen standardeve të të nxënit dhe ndërlidhjes me Kurrikulën dhe fushat përkatëse të Kurrikulës. Mësimdhënësit mund të vendosin vet për objektivat e të nxënit lidhur me përmbajtjen e këtij trajnimi. Në fillim të trajnimit, mësimdhënësit identifikojnë dhe reflektojnë lidhur me nivelin e kompetencës adekuate në mënyrë që të përcaktojnë qëllimet dhe nevojat që u ndihmojnë të arrijnë nivelin e dëshiruar të kompetencës. Rubrika e kompetencave që do përdoret si burim gjatë trajnimi do të ndihmojë mësimdhënësit lidhur me nivelin fillestar, nivelin e zhvilluar, nivelin e aftësisë / zotësisë apo atë të avancuar për kompetencën në fjalë. Kompetencat e parapara për tu arritur në kuadër të këtij programi të trajnimit, reflektojnë dhe ndërlidhen dhe janë në funksion të Standardeve dhe Kompetencave të performancës së mësimdhënësve |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi i trajnimit do të ketë qasje të kombinuar dhe përmes metodologjisë sasiore matë qëndrimet dhe perceptimet e mësimdhënësve lidhur me temën, para fillimit të trajnimit dhe pas përfundimit, ndërsa nga aspekti cilësor (brainstorming – stuhi mendimesh, punë ekipore, diskutimet nga përmbajtja e trajnimit; ushtrimet dhe rastet studimore e bashkëbisedimet në grupe të vogla lidhur me temën) do të mundësojnë adresimin e përmbajtjeve kryesore që janë pjesë integrale e qëllimit të trajnimit dhe objektivave specifike.<br><br>Para- dhe pas-testi është dizajnuar dhe përdoren për të matur perceptimet dhe kompetencat paraprake të mësimdhënësve, përfshirë dhe shqetësimet e tyre lidhur me temën e trajtuar, si dhe perceptimet e po të njëjtave aspekte pas trajnimit. |
| **Certifikimi** | Certifikimi behet nga Save the Children dhe MASHTI |
| **Trajner sa trajner** | Trajnimi do të ofrohet nga 2 trajnerë |
| **Data e aplikimi** | Prill 2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit** | **Menaxhimi i stresit tek nxënësit pas Pandemisë COVID-19, veprimet parandaluese të atakimit të jetës së njerëzve në të ardhmen** |
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr.06/6Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 24 orë |
| **Përfituesit:** | **Mësimdhënës fillestar dhe Mësimdhënës i karrierës, Mesimdhënësit e avancuar** |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosvës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas përdorimit të trajnimit, vijuesit do të jenë në gjendje:<br>-Të kuptojnë dhe të njohin rëndësinë e shendetit mendor ne aspektin e menaxhimit te stresit te shkaktuar nga Pandemia COVID-19<br>Vijuesit aftësohen që inovacionet e fituara t'i jetësojnë në procesin e mësimdhënies me qëllim të nxënit të suksesshëm nga nxënësit<br>Gjithashtu, përfituesit më të mëdhenjë do të jenë nxënësit të cilët do të kenë afër vetes mësimdhënës të cilët tanimë janë të trajnuar se si do të menaxhojnë stresin eventual të shkaktuar si pasojë e Pandemisë COVID – 19. |
| **Përmbajtja:** | Fëmijëria dhe adoleshenca janë konsideruar si një periudhë tranzicioni, një periudhë eksituese dhe tepër e zhurmshme. Përballja me sfidat e vazhdueshme si në jetën sociale, ashtu edhe në çështjet tjera bën që kjo peiurdhë të konsiderohet tepër delikate.<br><br>I konceptuar si një proces nëpërmjet të cilit një person percepton dhe |

regaon ndaj ngajrjeve që i gjykon të jenë sfiduese apo kërcnuese , stresi është kthyer në një fenomen shqetësues veçanërisht për nxënësit e të gjitha moshave, veçanërisht për adoleshentët. Studimet tregojne se nxenesit janë më të stresuar se sa të rriturit.Pandemia Covid -19, do të lë pas vetës çrregullime të shumta emocionale dhe stres tek nxënësit .

Mësimi në distancë është zhvilluar praktikisht me muaj dhe mësimdhënësit ndjehen në presion për të rritur ngarkesat e kursit të tyre për të kompenzuar mungesën e mësimit fiizk në klasë. Gjatë periudhës së Pandemisë COVID -19, shenjat tradicionale të përvojës në shkollazhdukur janë pothuaj të gjitha. Ndërsa të gjithë vendosen në rutina të reja brenda në shtëpi, nxënësit po ndjehen të zemëruar, të shqetësuar dhe të pambështetur. Identiteti i tyre është duke u thyer në izolim. Ata më shumë se asnjëher tjetër duan ta ndjejnë përkrahjen dhe afërsinë e njerëzve përreth që i duan ata, i mësojnë dhe i edukojne . Dhe kjo mund të arrihet parasegjithash me trajnime profesionale të cilat ju dedikohen nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. Prandaj, vazhdimi I projektit "Menaxhimin e stresit tek nxënësit pas Pandemisë COVID - 19 , veprimet parandaluese të atakimit të jetës së njerëzve në të ardhmen", si njëra nga nismat më serioze dhe mbase e vetme në Kosovë e rajon, ofron një mundësi të mirë që përmes trajnimeve profesionale në fushën e psikologjisë, pedagogjisë dhe kujdesit shëndetësor me higjienë, të arrihen rezultatet e pritshme në kuadër të nje teresie të perbashket.

- **Fusha e Psikologjisë**

| *Temat bazë* | |
|---|---|
| Definimi i nocionit te Stresit | |
| Identifikimi I stresit tek nxënësit e grup moshave të ndrsyhme | |
| Teknikat për intervenim të hershëm për menaxhim të stresit në fushën psiko-sociale | |
| Aktivitete praktike për menaxhimin e stresit tek nxënësit përmes lëndëve të ndrsyhme mësimore | |

- **Fusha e Pedagogjisë**

| *Temat bazë* | |
|---|---|
| Reformimi pedagogjik | |
| Transformimi i praktikës pedagogjike | |
| Përfshirja e aftësive socio-emocionale në procesin mësimor | |

| | |
|---|---|
| | Shfrytëzimi i potencialit të mjediseve të të nxënit online<br><br>**Edukimi shëndetësor**<br>Përmbajtje e modulit në fushën e Edukimit Shëndetësor<br><br>Temat bazë<br>Hyje në kujdesin shëndetsor<br>Masat mbrojtëse në ruajtjen e shëndetit<br>Higjena e duarve<br>Dezinfektuesit dhe protokolet e përdorimit të dezinfektuesve |
| **Metodat e realizimit të programit** | • Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve<br>• Mësimdhënia algoritmike<br>• Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t<br>• Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese |
| **Certifikimi** | Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 5% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit.<br>Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajnerët zbatojnë me përpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë se aplikuar gjatë trajnimit.<br><br>*Perfshirja aktive 5%*<br>*Pjesa praktike 25%*<br>*Testi vlerësues 70%* |
| **Trajner** | • Dr. Ndricim Mehmeti<br>• Dr. Gazmend Bojaj<br>• Dr. Saranda Shatri<br>• Dr. Armen Mustafa<br>• Msc. Aferdita Mustafa<br>• Dr. Nalan Kazas<br>• Dr. Rina Meha |
| **Data** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH)** |
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 43/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 41/41,Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi organizohet në formë të 7 seminareve 2-ditore. Çdo seminar ka 16 orë trajnim. Po ashtu në kuadër të programit organizohen dy monitorime në klasë të secilit pjesëmarrës dhe 2 takime gjysmë ditore që zgjasin nga 4 orë. Pra, 7 seminare x 16 orë = 112 orë trajnim dhe 2 takime x 4 orë = 8 orë.<br>Programi ka gjithsej **120 orë.** |
| **Përfituesit:** | Nga ky program mund të përfitojnë: mësimdhënësit e të gjitha niveleve të shkollimit dhe të lëndëve të ndryshme, administratorët e shkollave, studentët e degëve arsimore, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve shkollore, zyrtarët e arsimit, si dhe të gjithë ata të cilët tregojnë interesim për përdorimin e metodologjive të avancuara në mësimdhënies dhe të nxënit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:<br>• Të krijojnë klasa që nxisin bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm.<br>• Të përdorin një strukturë për mësimdhënien që nxit mendimin kritik dhe të nxënit e pavarur.<br>• Të përdorin teknika të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të njohurive dhe kontrollimit të tyre.<br>• Të bëhen burim përvoje dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.<br>Me zbatimin e këtij Programi nxënësit aftësohen:<br>• Të mendojnë në mënyrë kritike. Pra, nxënësit duhet përgatitur që të jenë kureshtarë dhe të përdorin strategjitë e kërkimit dhe shqyrtimit të pavarur, të bëjnë pyetje dhe në mënyrë sistematike të kërkojnë përgjigjet e tyre.<br>• Të marrin përgjegjësinë për të nxënit e tyre. Nxënësit nuk do t'i përvetësojnë njohuritë e dhëna nga mësimdhënësi në mënyrë pasive, por do të përdorin strategjitë e shqyrtimit përmes |

| | |
|---|---|
| | procesit të të lexuarit, shkruarit dhe diskutimit për të nxënë vetë. Nxënësit duhet të dinë të bëjnë sistemimin e informacionit dhe të vënë në përdorim shprehitë e studimit të pavarur.<br>• Të punojnë bashkë me të tjerët. Nxënësit duhet të aftësohen për të dëgjuar të tjerët me kujdes dhe respekt, të flasin me mirësjellje dhe të kenë besim te të tjerët, të përdorin strategjitë për identifikimin e problemeve, të kontribuojnë për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta duke vepruar si anëtarë të përgjegjshëm të grupit.<br>• Të bëhen qytetarë që mësojnë gjatë gjithë jetës. Nxënësit duhet të përvetësojnë strategjitë e kërkimit, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përdorin ato edhe për shumë vite pas përfundimit të shkollimit. |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja e programit është pjesë e 8 udhëzuesve të programit:<br>1. Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit.- Ç'është mendimi kritik? Krijimi i një mjedisi për mendimin kritik. Përgjegjësia e nxënësit për mendimin kritik.<br>2. Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijës.- Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijës. Arsyetimi i fëmijës. Shprehitë e të menduarit kritik dhe Taksonomia e Blumit. Pyetjet dhe vlera e tyre.<br>3. Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë.– Diskutim mbi bazën e reagimit të lexuesve. Prezantimi i teknikave për përdorim në klasa si në lëndët shoqërore ashtu edhe në lëndët e shkencave natyrore. Analiza e detajuar e teknikave.<br>4. Teknika tjera për zhvillimin e të menduarit kritik.– Prezantimi i teknikave të ndryshme. Analiza e teknikave të mësuara dhe shqyrtimi i rasteve për zbatimin e tyre në klasa në lëndë të ndryshme. Planifikimi individual i një mësimi model për zbatim në klasë dhe shqyrtimi i tij.<br>5. Të nxënit në bashkëpunim.– Arsyetime për të nxënit në bashkëpunim. Bashkëpunimi i nxënësve të një klase si një mjedis për të menduarit kritik. Karakteristikat e klasës që bashkëpunon. Planifikimi individual i një mësimi model dhe prezantimi i tij para grupit.<br>6. Planifikimi i mësimit dhe vlerësimi.– Klasifikimi i mjeshtërive themelore të mësimdhënies. Planifikimi i mësimit. Përzgjedhja e veprimtarive të të nxënit. Vlerësimi. Qëllimet e vlerësimit. Tipet e vlerësimit. Diskutim për çështjen e vlerësimit, Rubrikat për vlerësim etj. Përpilimi i një testi në baza lëndore. Prezantimi i testeve dhe komentimi i tyre.<br>7. Seminari për të shkruarit "Nga të vetë shprehurit tek argumentet e shkruara". – Prezantimi i teknikave për procesin e të shkruarit. Shqyrtimi i teknikave nga ana përmbajtësore dhe procedurale. Diskutimi për zbatimin e këtyre teknikave në klasë.<br>8. Krijimi i lexuesve mendimtarë.– Prezantimi i katër përbërësve të seminarit të lexuesve: Mini leksioni, Leximi, Bashkëbisedimi dhe Përgjigjet. Seminari i lexuesve dhe kuadri i të nxënit ndërveprues. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi organizohet në formë të 7 seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një viti akademik. Koha në mes të mbajtjes së dy seminareve duhet të jetë së paku një muaj. |

| | |
|---|---|
| | Gjatë kohës së trajnimit organizohen dy monitorime në klasë të secilit pjesëmarrës dhe 2 takime gjysmë ditore me qëllim të këmbimit të përvojave në mes të pjesëmarrësve. Pas monitorimit të pjesëmarrësve mbahet takimi gjysmë ditor në të cilin do të diskutohen orët e monitoruara me theks të veçantë në shqyrtimin e përparësive të vërejtura dhe gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e pengesave të paraqitura. Takimet gjysmë ditore zgjasin nga 4 orë.<br>Programi ka gjithsej **120 orë.** |
| **Certifikimi:** | Në kuadër të programit të MKLSh ekzistojnë standardet ndërkombëtare për certifikim. Programi ka 4 nivele të certifikimit:<br>1. Certifikimi për pjesëmarrje,<br>2. Certifikimi për mësimdhënës të MKLSH,<br>3. Certifikimi për trajner të MKLSH,<br>4. Certifikimi për certifikues i MKLSH.<br>Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 80 %, monitorimi i 2 orëve dhe pjesëmarrja në takimet gjysmë ditore |
| **Trajner sa trajner:** | 20 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH) Programi për trajnerë** |
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 70/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 42/42 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi organizohet në formë të 2 seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një muaji. Çdo seminar ka 16 orë trajnim.<br>Programi për përgatitjen e trajnerëve ka gjithsej **32 orë.** |
| **Përfituesit:** | Ky Program iu dedikohet të gjithë pjesëmarrësve të MKLSH-së, të cilët janë certifikuar më parë si mësimdhënës të MKLSH-së dhe janë zbatues të vazhdueshëm të këtij Programi në klasat e tyre. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:<br>• Të përzgjedhin dhe japin shembuj të përdorimit të metodave të përshtatshme të të nxënit aktiv dhe të strategjive të mendimit kritik brenda strukturës ERR, gjatë seminareve të MKLSH-së, në të cilat ata referojnë.<br>• Të japin shembullin e tyre duke përdorur në seminar paraqitjeje të gjallë dhe interesante, që merr parasysh interesat dhe nevojat e pjesëmarrësve, si dhe të drejtuesve të tjerë.<br>• Të lidhin parimet me praktikën, duke dhënë shembuj të vërtetë nga klasa.<br>• Të ndajnë me kolegët e tyre përgjegjësitë e drejtimit dhe paraqitjes në seminar.<br>• Të tregojnë aftësi në planifikimin e përmbajtjes së seminarit dhe logjistikës.<br>• Të parashikojnë, nxisin dhe të përgjigjen me efektivitet dhe saktësi pyetjeve për parimet dhe strategjitë e MKLSH-së.<br>• T'ua përshtatin parimet dhe praktikat e MKLSH-së kurrikulave vendore.<br>• Të përdorin me efektivitet dhe në mënyrën e duhur rubrikat për kontrollimin e dosjeve dhe monitorimin e pjesëmarrësve dhe mësimdhënësve të MKLSH-së.<br>Standardet që duhet t'i arrijnë trajnuesit e certifikuar të MKLSH-së janë:<br>• Veprimtaria e tyre pasqyron filozofinë, synimet dhe strategjitë e MKLSH-së. |

| | |
|---|---|
| | • Puna e tyre tregon se kanë kuptuar lidhjen midis parimeve të të nxënit dhe praktikave të mësimdhënies, që përbëjnë thelbin e të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik.<br>• Tregojnë aftësi shumë të mira organizuese.<br>• Demonstrojnë aftësi ndërpersonale shumë të suksesshme dhe të përshtatshme për të punuar me të rriturit.<br>• Vlerësojnë me efektivitet dhe këshillojnë në mënyrë profesionale pjesëmarrësit e MKLSH-së.<br>• Trajtojnë nevojat dhe zhvillimin e tyre profesional dhe ndajnë njohuritë dhe aftësitë e tyre me të tjerët.<br>• Mbajnë standarde dhe etikë të lartë profesionale. |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja e programit është pjesë e 2 udhëzuesve të programit:<br>**1. Puna me të rritur** . - Roli i trajnerit të MKLSH-së si ekspert i Programit dhe zotërues i aftësive dhe shkathtësive të prezantimit. Parimet dhe stilet e të nxënit tek të rriturit. Zhvillimi i një analize trajnimi. Qëllimi dhe objektivat trajnuese. Metodat e mësimit. Ndërtimi dhe përdorimi i mjeteve efektive gjatë trajnimit. Zhvillimi i një plani të trajnimit. Karakteristikat e një trajneri të suksesshëm. Listë kontrolli për një trajnim të suksesshëm.<br>**2. Standardet dhe manuali për certifikim të Programit të MKLSH-së.** - Standardet për certifikimin e trajnerëve të MKLSH-së. Njohuritë ndihmëse për trajnerët. Menaxhimi i mjediseve të trajnimit. Modelet e testimit dhe vlerësimit të trajnimit. Përgatitja në grupe të vogla të pjesëmarrësve të disa seancave të shkurta dhe prezantimi i tyre. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi organizohet në formë të 2 seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një muaji. Çdo seminar ka 16 orë trajnim. Para fillimit të trajnimit kontrollohet dosja e pjesëmarrësve, ndërsa pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit organizohen në grupe nga 3-4 veta dhe udhëheqin takime gjysmë ditore me kolegë të tyre. Gjatë kësaj kohe bëhet monitorimi i tyre dhe vlerësohet shkalla e përgatitjes së tyre si trajner.<br>Programi për përgatitjen e trajnerëve ka gjithsej **32 orë.** |
| **Certifikimi:** | Në kuadër të programit të MKLSh ekzistojnë standardet ndërkombëtare për certifikim. Programi ka 4 nivele të certifikimit:<br>5. Certifikimi për pjesëmarrje,<br>6. Certifikimi për mësimdhënës të MKLSH,<br>7. Certifikimi për trajner të MKLSH,<br>8. Certifikimi për certifikues i MKLSH.<br>Pas certifikimit për pjesëmarrje dhe si mësimdhënës i MKLSh sipas standardeve të Programit, mësimdhënësi mund të marrë pjesë në programin e trajnimit për trajnerë.<br>Kusht për certifikimin për trajner të MKLSH-së është pjesëmarrja e rregullt në seminare, monitorimi gjatë prezantimit të filozofisë dhe teknikave të Programit të MKLSH-së në një takim gjysmë ditor, intervista e strukturuar, si dhe kontrollimi i dosjes sipas standardeve. |
| **Trajner sa trajner:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit:** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **Mësimdhënia Online në Nivelin e Duhur** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra Kosovare për Arsim në Distancë (**KCDE**) - Mëso online |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | KCDE - Mëso online |
| **Adresa:** | Rr. Rexhep Mala, nr. 49 |
| **E-mail:** | info@kcde-ks.org; info@mesoonline-ks.org; antigona.xh.uka@gmail.com; milazim.kcde@gmail.com |
| **Telefoni:** | +383 49 410 003; +383 44 106 192 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.83/83, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi zgjatë 1 muaj dhe përmban 35 orë trajnimi. |
| **Përfituesit:** | **Mësimdhenia online në nivelin e duhur** i dedikohet mësimdhënësve të nivelit të mesëm-ulët dhe mesëm-lartë (përfshirë IAAP) të Republikës së Kosovës. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Një grup i të trajnuarve përmban gjithsej 30 mësimdhënës. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | ***Objektivat e trajnimit:***<br>Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të:<br>1. Njihen me platforma të ndryshme për mësim online.<br>2. Krahasojnë metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit ballë-për-ballë me metodat e mësimit online.<br>3. Krijojnë materiale audio-vizuale.<br>4. Zhvillojnë një kurs online në platformën Moodle (LMS sistemi për menaxhimin e mësimit).<br>**Rezultatet:**<br>Qëllimi kryesor i programit 'Mësimdhënia online në nivelin e duhur' është ngritja e njohurive mbi mësimin online dhe zhvillimi i kapaciteteve për krijimin e klasave virtuale. Prandaj, përmes këtij programi, pjesëmarrësit do të:<br>- Përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale për mësimdhënie online në një mjedis bashkëpunues.<br>- Përforcojnë lidhjet profesionale mes vete duke ndërtuar një komunitet për mësim online.<br>- Përfitojnë mundësi të zhvillimit profesional në mësimdhënie online.<br><br>Përmes trajnimit, pjesëmarrësit do të krijojnë së paku një njësi të plotë |

| | |
|---|---|
| | mësimore virtuale apo të realizueshme online. Njësi e plotë mësimore virtuale konsiderohet atëherë kur përmban të gjitha elementet pedagogjike, duke filluar nga planifikimi, metodat e mësimdhënies, materialet, e deri tek vlerësimi i nxënësve. Për të zhvilluar dhe dizajnuar një njësi mësimore virtuale, gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të:<br>● njihen me platforma të ndryshme për mësim online duke mësuar si të regjistrohen dhe si t'i përdorin ato (sic janë: sisteme të menaxhimit të mësimit, platformat për komunikim, krijimin e materialeve mësimore, angazhimin e pjesëmarrësve për punë individuale dhe grupore, etj.);<br>● krijojnë materiale audio-vizuale si dhe forma të vlerësimit online (duke përdorur H5P, PreziVideo, Kahoot, Socrative, Mentimeter, etj);<br>● praktikojnë realizimin e aktiviteteve e-didaktike duke përdorur veglat për mësim virtual (të listuara më sipër). |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit 'Mësimdhënia online në nivelin e duhur' përmban 5 Module mbi mësimin online. Modulet janë të ndara sipas tematikës dhe secili modul përmban 3 sesione.<br>Pra trajnimi përmban gjithsej 15 sesione trajnimi, dhe kohëzgjatja e secilit sesion është 120 minuta. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi "Mësimdhënia online në nivelin e duhur", i cili përmban 5 module të ndara në 15 sesione, ofrohet i gjithi online për të mundësuar casje sa më të lehtë të mësimdhënësve nga gjithë Kosova si dhe për të ilustruar me shembuj konkret metodat më bashkëkohore të mësimdhënies online.<br>Sesionet e trajnimit ndahen në sesione sinkronike (të drejtpërdrejta) të cilat realizohen përmes video-konferencave, si dhe në sesione asinkronike (jo të drejtpërdrejta) të cilat realizohen përmes platformave të manaxhimit të mësimit. Programi si tërësi përmban 8 sesione sinkronike dhe 7 sesione asinkronike. Përmes kombinimit të sesioneve sinkronike dhe asinkronike në module, synojmë që a) mësimdhënësit të marrin njohuritë e duhura nga trajnerët, b) të praktikojnë njohuritë e fituara dhe c) të reflektojnë dhe hulumtojnë mbi mësimin online në mënyrë të pavarur. Prandaj, të gjitha materialet e përdorura gjatë trajnimit (duke përfshirë këtu edhe materialet e përdorura në sesionet sinkronike) janë në dispozicion për pjesëmarrësit dhe të casshme edhe pas përfundimit të programit.<br><br>Modulet dhe sesionet janë të organizuara në mënyrë që mësimdhënësit të a) fitojnë njohuri të reja përmes instruksioneve, b) reflektojnë mbi njohuritë e fituara dhe planifikojnë aplikimin e tyre në praktikë, c) diskutojnë rreth sfidave të mundshme që mund të paraqiten gjatë implementimit të |

| | |
|---|---|
| | njohurive të reja dhe zgjidhjeve të mundshme të këtyre sfidave. Prandaj, realizimi i sesioneve përfshinë aktivitete të ndyshme, si: prezantime nga trajnerët, paraqitje të shembujve, demonstrime të përdorimit të platformave dhe veglave të ndryshme, dhe punë në grupe për zhvillim të modeleve të materialeve virtuale.<br><br>Të gjitha modulet dhe sesionet e programit 'Mësimdhënia online në nivelin e duhur' janë të organizuara në mënyrë kronologjike. Programi trajnues ka një qasje apo metodologji praktike, e cila u lejon pjesëmarrësve jo vetëm që të mësojnë teori apo të njoftohen me platforma, por edhe që të ekspolorojnë dhe eksperimentojnë me platformat e mësimit online. Metodologjia praktike e trajnimit mund të verifikohet në planin e trajnimit, ku ndër të tjera, theksohet se pjesëmarrësit do të: a) krijojnë plane mësimore për implementim online, b) krijojnë materiale interaktive për sesione sinkronike dhe asinkronike, c) krijojnë forma të vlerësimit të përshtatshme për klasa online, dhe d) krijojnë një njësi të plotë mësimore virtuale në platformën Moodle.<br>Përmbajtja e detajuar e programit sqarohet në pikën 3.3 Përmbajtja e programit dhe aktivitetet që sigurojnë arritjen e rezultateve të programit. |
| **Certifikimi** | Si tërësi programi trajnues kërkon 35 orë angazhimi për mësimdhënësit të cilët ndjekin trajnimin.<br>Programi organizohet online në formë të pesë moduleve. Secili modul përmban 3 sesione, pra gjithsej janë 15 sesione, nga të cilat 8 janë sinkronike dhe 7 asinkronike. Një sesion sinkronik zgjatë 120 minuta, pra në tërësi sesionet sinkronike zgjasin 16 orë, kurse një sesion asinkronik zgjatë rreth 90 minuta (me përjashtim të njërit sesion asinkrinik, më saktësisht sesionit 2 në modulin 5, i cili kërkon 120 minuta) dhe të gjitha sesionet asinkronike zgjasin 11 orë. Pra, gjithsej programi përmban 27 orë trajnimi. Programi përfshin edhe përpilimin e katër punimeve, përmbushja e të cilave kërkon angazhim rreth 8 orë, si dhe pjesëmarrjen opsionale në një fokus grup diskutimi 2-orësh pas përfundimit të trajnimit. **Pra, si tërësi programi kërkon 35 orë angazhimi për mësimdhënësit të cilët ndjekin trajnimin dhe duan të çertifikohen.** |
| **Trajner sa trajner** | Në realizimin e programit trajnues marrin pjesë 3 trajnerë dhe 2 asistentë mbështetës. |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 49/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 50/50 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Numri i orëve të programit trajnues është 24. Orët e trajnimit janë 18. Të tjerat janë orë të dedikuara për implementimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në takimet reflektuese (përgatitje, konsultime online, observime në klasë, etj.) |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet të gjithë mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:<br>• Të zhvillojnë të kuptuarit për MBP<br>• Të reflektojnë mbi praktikat e mësimdhënies dhe përshtatetjes së MPB me to<br>• Të zhvillojnë njohuri bazë tek nxënësit dhe të rrisin interesimin e tyre për te nxënit ndër-lëndor, në menyrë që të jenë në gjendje të përballen me ndryshimet dhe sfidat e botës moderne në jetë dhe punë në të ardhmen<br>• Të forcojnë aftësitë e nxënësve për t'i integruar dhe përdorur njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, të ushqejmë kreativitetin e tyre, aftësitë bashkëpunuese dhe aftësitë në zgjidhjen e problemeve, si dhe të shtyjmë përpara idetë e tyre inovative, ashtu siç kërkohet në shekullin e 21-të.<br>• Të forcojnë kapacitetin profesional dhe bashkëpunues në mesin e mësimdhënësve si dhe partneritetin me akterët në komunitet<br>• Të përkrahim nxënësit talent dhe të krijojmë ekspertë në fusha ndër-lëndore në mënyrë që të mund të kontribuojmë në zhvillimin e shoqërisë. |
| Përmbajtja: | Ky program është dizajnuar duke marrë parasysh mësimdhënien e bazuar në projekte si një strategji efikase që mundëson përmbushjen e rezultateve të të nxënit për kompetencat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Programi i adreson edhe parimet e kornizës kurrikulare si pjesë e punës praktike gjatë realizimit të projekteve. Përmes mësimdhënies së bazuar në projekte, nxënësit do të jenë në gjendje të planifikojnë dhe të realizojnë projekte për të rritur njohuritë akademike dhe shkathtësitë për të bashkëpunuar, menaxhuar, udhëhequr, analizuar, komunikuar dhe për të reflektuar. Pjese e realizimit të programit janë elementet bazë të mësimdhënies së bazuar në projekte, krijimi i mjedisit bashkëpunues, dizajnimi i projekteve efektive dhe menaxhimi i projekteve në shkollë. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin pjesë në punëtori 3 ditore, secila ditë me nga 4 sesione 90 minuta, të moderuara nga fasilituesit |

| | |
|---|---|
| | profesionalë. |
| **Certifikimi:** | Kushtet për certifikim: 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentorë; Prezantimi i produktit final të realizuar me nxënësit duke dokumentuar të gjithë hapat e realizimit të projektit përmes mësimdhënies së bazuar në projekte sipas udhëzimeve; Prezantimi para fasilituesve dhe pjesëmarrësve të trajnimit. |
| **Trajnerë:** | 4 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **METODA E KORNIZËS LOGJIKE** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. “Qëndresa”,nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr. 85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr. 42/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr. 43/43 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 2-2.5 ditor dhe ka gjithsej 16-20 orë. Gjithashtu, programi mund të jetë pjesë e një punëtorie të vërtetë planifikimi, e cila zgjatë 3-4 ditë. |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet personave që kanë dëshirë ta përvetësojnë metodën e kornizës logjike si mjet për planifikim në nivele të ndryshme. Kryesisht është fjala për individë nga institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare, por edhe punëtorë të arsimit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:<br>• ta kuptojnë rolin dhe rëndësinë e definimit dhe analizës së problemeve si pikënisje për çdo planifikim;<br>• të jenë në gjendje ta definojnë sistemin e objektivave të një intervenimi shoqëror (strategjia e përgjithshme, programet ose projektet) në bazë të transformimit të trungjeve problemore në trungje të objektivave;<br>• ta kuptojnë strukturën e kornizës logjike dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë së përgjithshme, programit ose projektit;<br>• të jenë në gjendje të drejtojnë procesin e planifikimit me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. |
| **Përmbajtja:** | Elemente të planifikimit strategjik. Tema simuluese. Diagnostika e problemeve. Grupëzimi i problemeve. Analiza e shkaqeve dhe pasojave. Ndërtimi i trungjeve të suksesit. Analiza e opsioneve të mundshme. Kuptimi i kornizës logjike. Logjika e intervenimit. Treguesit e suksesit. Analiza e rrezikut. Plani operativ i projektit. Buxheti i projektit. Parashtrimi i projektit. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet përmes simulimit të planifikimit të një projekti, ndërsa pjesëmarrësit përfshihen në të gjitha fazat e planifikimit. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 80% në seminar |
| **Trajner sa trajner:** | 3 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | METODOLOGJI INTERAKTIVE E MËSIMDHËNIES |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ''KONICA'' |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ''KONICA'' |
| **Adresa:** | rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë |
| **E-mail:** | qeht.konica@gmail.com |
| **Telefoni:** | 049 328 528 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr 74/74, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 32 orë |
| **Përfituesit:** | 1. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3; |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të:<br><br>1. Shpjegojnë arsyet e përdorimit të metodave interaktive të mësimdhënies<br>2. Përshkruajnë dhe kuptojnë si të përdorin shumicën e rreth 30 metodave të ndryshme interaktive të mësimdhënies të paraqitura në këtë material.<br>3. Të planifikojnë orën mësimore me efikasitet në aspektin kohor dhe metodik.<br>4. Të kenë paraqitje profesionale para nxënësve.<br>5. Të fitojnë njohuri të përgjithshme mbi organizimin e prezantimeve, strukturimin e tyre sipas standardeve moderne si dhe zbatimin e tyre në mënyrë efikase dhe të kuptueshme për nxënësit. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit të mësimdhënësve *Metodologji interaktive e mësimdhënies moderne*, përbëhet nga 4 module të cilat realizohen në 3 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të vlerësimit. Moduli i pestë përfshin pjesën e monitorimit.<br>Dita e parë dhe e dytë e trajnimit:<br>Moduli 1: Përdorimi i metodave interaktive të mësimdhënies;<br>Moduli 2: Komente dhe këshilla mbi përdorimin e metodave interaktive të mësimdhënies;<br>Dita e tretë e trajnimit:<br>Moduli 3: Zhvillimi i përmbajtjes së mësimit;<br>Moduli 4: Llojet e teknikave interaktive të mësimdhënies. |

| | |
|---|---|
| | Dita e katërt e trajnimit:<br>Moduli 5: Në këtë modul përfshihet pjesa e monitorimit. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat që lidhen me metodologjitë e mësimdhënies.. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. |
| **Certifikimi** | Certifikimi, 32 orë |
| **Trajner** | Diana Qarkaxhija<br><br>Arbër Morina |
| **Data** | 28.07.2022 |

| Titulli i Programit | Metodologjia e mësimdhënies në seksion muzikorë instrumental |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr: 05/5Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | Në total janë të planifikuara 24 orë:<br>- 16 orë teori dhe 8 orë praktike |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e karrierës si dhe edukatorët janë ata mësimdhënës/edukatorë të cilët synojnë këtë trajnim. Trajnimi synon të rrisë performancën e tyre në rrafshin teorik dhe praktik, me qëllim të avansimit të shkathtësive mbi aspekte të rëndësishme të edukimit muzikor dhe rolit të tij në punën me nxënës respektivisht fëmijë. Kjo kategori mësimdhënësish që bëjnë përpjekje të rriten në karrierën e tyre, kanë mundësinë që të njohin, përvetësojnë dhe të thellohen në fushën e muzikës dhe aspekte metotodologjike të saj, si dhe të aftësohen për njohuri dhe metoda të reja, të panjohura ose pak të dëgjuara prej tyre. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosvës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të kursit, kandidatet do të jenë në gjendje:<br>artikulojnë filozofinë e tyre drejt edukimit muzikor instrumental të studentëve dhe detajojnë një arsyetim për edukimin muzikor instrumental në shkollat<br>diskutojnë shumë çështje aktuale dhe tendencat në lidhje me mësimdhënien<br>muzikë instrumentale<br>demonstrojnë dhe përmirësojnë aftësitë themelore të mësimdhënies dhe prezantimit<br>demonstrojnë aftësi kërkimore dhe mbledhëse të burimeve per kurrikulën e dizajnit duke marrë parasysh procedurat e dizajnit udhëzues, muzikantin gjithëpërfshirës dhe standardet kombëtare të muzikës<br>detaje dhe plan për aftësitë zhvillimore të instrumentistëve në nivele |

| | |
|---|---|
| | të ndryshme (fillestar, i mesëm, i përparuar)<br>të analizojë dhe planifikojë praktikat administrative pasi ato lidhen me mësimin e kurseve instrumentale në shkolla<br>demonstrojnë mësime muzikore dhe strategji provash<br>demonstrojnë profesionalizmin e pritur të praktikuesve të muzikës instrumentale. |
| **Përmbajtja:** | Ky program përmbledh tërë procesin arsimor-edukativ në mësimin e edukatës muzikore. Metodika e edukatës muzikore bën pjesë në grupi e disiplinave shkencore-pedagogjike, duke shfrytëzuar zbatimi specifike të metodave të saj. Në fushën e veprimtarisë së saj, shpjegon detyrat dhe qëllimet të cilat objektivisht na paraqiten gjatë punës edukative-mësimore. Duke i parashtruar kërkesat dhe parimet didktike, si lëndë në veçanti, ndihmon që të dime si të përdorim format dhe metodat e ndryshme, qëndrimet, organizimin e faktorëve ndihmës,<br>Mësimdhënësit në fillim duhet të kenë orientim të qartë në tërë procesin mësimor-edukativ të muzikës. Pastaj, gjatë procesit të punës, duke pasë parasysh kushtet konkrete të shkollës , të klasës apo të individëve, mund të zgjedhë ato orientime didaktike, që përmbajnë ide të qarta dhe që do t'i ndihmojnë dhe t'ia plotësojnë punën teoriko-praktike muzikore. Gjithnjë e më shumë rritet kërkesa që të më mësojmë se si mësohen të tjerët në mënyrë më efikase, sepse vetëm kështu arrihet qëllimi i plotë në procesin mësimor. Qëllimi duhet të jetë që në forma sa më të frytshme dhe racionale të plotësohen kërkesat në ngritjen e nivelit edukativomësimor në muzikë. Gjithnjë duhet të gjejmë mundësi për përparim të procesit mësimor, por duke qenë sa më racionalë dhe efikasë.<br>Programi është krijuar për të siguruar një themel kurrikular për pedagogët e ardhshëm të muzikës për të<br>Përshkruan "qasjet administrative, teknikat e provave dhe<br>stile moderne gjithëpërfshirëse të mësimdhënies për mësuesin e mesëm të instrumenteve. "<br>Mësimi i Muzikës dhe Zhvillimi, Metodat e Përbërjes dhe Metodat e Përgjithshme të Muzikës me kërkesat e nevojshme praktikë e përgjithshme e muzikës.<br><br>Qëllimet e këtij trajnimi janë:<br>përgatitni edukatorët e ardhshëm të muzikës instrumentale për sukses (suksesi zhvillimi / mësimdhënia në një program të qëndrueshëm, muzikor, të madh instrumental ku studentët e shkollave publike janë të angazhuar dhe bëhen më të interesuar për muzikë, krijues dhe të pavarur në krijimin e muzikës së tyre).<br>të përgatisë të gjithë arsimtarët e ardhshëm të muzikës për metodologjinë e mësimdhënies në muzikë<br>ofrojnë mundësi që të përsosin muzikën e tyre instrumentale mësimdhënia, ngritja e vetëdijes për repertorin instrumental dhe njohja e një larmie strategjish provash<br>sigurojmë mundësi për të praktikuar dhe zhvilluar modelin udhëzues muzikor |

| | |
|---|---|
| **Metodat e realizimit të programit** | Në këtë trajnim si metodologji kryesore do të përdoret ndërveprimi mes trajnuesit dhe nxënësit, puna konkrete përmes detyrave të shkurtra për të dëgjuar mendimin e mësimdhënësve, qasjen e tyre mbi trajnimin por edhe për të parë në kohë reale rezultatet: Sa dhe si ka ndryshuar koncepti mbi rëndësinë dhe aspektet e fushës së muzikës në procesin mësimor, duke u bazuar nga informata e fituar gjatë trajnimit.<br>Diskutim në klasë, nxënie bashkëpunuese / projekte në grup, diskutime në grupe të vogla,<br>projekte të pavarura analitike, lexime, mbledhje burimesh, prezantime, mësimdhënie dhe leksione përbënin shumicën e aktiviteteve me detyra të lidhura.<br>Mësimi muzikor një për një është një lloj i veçantë i situatës së mësimdhënies dhe si të tilla përdorin strategji mësimore që janë unike për atë mjedis.<br>Kërkimet ekzistuese kanë hetuar aspekte të caktuara të mësimdhënies së muzikës (shpesh në vendosja në klasë) siç janë intensiteti i mësimdhenesit, vëmendja e kandidatit, modelimi, përforcimi, pyetja dhe praktikimi. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit u nënshtrohen testit që lidhet:<br>Test mbi njohuritë e perfituara gjatw trajnimit<br>Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të jene të rregullt dhe të ndjekin tri ditët e trajnimit |
| **Trajner** | Prof. Dr. Besa Luzha<br><br>Msc. Naser Dula<br><br>Prof.dr. Selami Kolonja |
| **Data** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **Metodologjitë bashkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie në lëndën e hitorisë** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.01/1,Datë:110.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Kohëzgjatja : 5 ditë<br>Numri i orëve në total: 40<br>Numri I orëve për modul : 10 ( 4 module nga 10 orë )<br>Ligjërata : 32 ( 4 module nga 8 orë )<br>Punë praktike e bazuar në modulet përkatëse ( hartimi i planit individual, prezentimi dhe mbrojtja e planit,): 8 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program trajnimi ofrohet për të gjithë mësimdhënësit e lëndëss në nivelin 2 dhe 3(shkolla e mesme e ulët dhe shkolla e mesme e lartë ).<br>Modulet e ofruara janë të ndërtuara në atë mënyrë që ndikojnë drejtpëdrejtë në ngritjen e performances së mësimdhënsve të historisë dhe siguriht edhe në rrritjen e përvetësimist të lëndës nga ana e nxënësve. Përmbajtja modulare, puna praktike, vlerësimi, etj, garantojnë ruajtjen e një kohezioni tek nxënësit , pavarësisht nivelit të arsimit që do të jenë. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve parashihet varesisht nga kerkesa, por mesatarisht mbahet në grupe prej më së shumti 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës.<br>EDUMEN – K ka bashkpunëtor edhe nga komunitetet të tjera të cilat programin mund ta ofrojnë edhe në gjuhët: angleze, serbe, turke dhe boshnjake |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | ***Programi është i ndarë në 4 module dhe secili modul i ofruar bazohet edhe në rezultatet e pritura:***<br><br>**3.2.1 Bazat metodologjike të mësimdhënies së historisë**<br>• Njoh forcat lëvizëse dhe modelet e procesit historik, vendin e njeriut në procesin historik<br>• Të jetë në gjendje të zbatojë një qasje sistemaktiviteti në mësimdhënien e historisë<br>• Të zotërojë teknika dhe teknologji moderne, duke përfshirë |

| | |
|---|---|
| | informacionin<br>• Të zotërojë metoda moderne të diagnostikimit të arritjeve të nxënësve<br>• në aktivitetet kërkimore<br>• Të jetë në gjendje të përdoret në hulumtim historik njohuri bazë në fushën e historisë së përgjithshme dhe kombëtare<br>• Të jetë i aftë të punojë në muze, biblioteka, të ketë aftësi për të gjetur informacionin e nevojshëm në burimet e rrjetit<br><br>**3.2.2 Metodat e hulumtimit**<br><br>• Nxitë nxënësit të aftësohet për të gjykuar pro dhe kundër<br>• Të bëjë nxënësit më të aftë, që të interpretojë fakte të jetës së përditshme.<br>• Nxit të menduarin hipotetik, kritik dhe krijues.<br>• Nxit të nxënit aktiv nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari.<br><br>**3.2.3 Mjeshtëria e të pyeturit dhe llojet e pyetjeve në lëndën mësimore të historisë**<br><br>• Përkufizojë pyetjen si aspekt i rëndësishëm në klasë;<br>• Klasifikojë pyetjen dhe sidomos pyetjen e zakonshme;<br>• Shpjegojë rolin e pyetjeve në interes të përvetësimit të lëndës së historisë, mendimit kritik në këtë fushë dhe nxitejn e mendimit analitik<br>• Përdorë disa nga teknikat më të suksesshme të të pyeturit<br><br>**3.2.4 Kriteret e pikëzimit të një testi**<br>• Lidhi objektivat e programit me hartimin e pyetjeve në test;<br>• Shpjegojë problemet që hasen në vendosjne e pikëzimeve;<br>• Pikëzojnë pyetjet e hartuara;<br>• Evidentojë disa nga hapat që ndiqen në hartimin e një testi;<br>• Diskutojë në grup për hartimin e një testi |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja e programit : “Metodologjitë bashkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie në lëndën e historisë” është I bazuar në 4 module specifike:<br>- **Bazat metodologjike të mësimdhënies së histories**<br>- **Metodat e hulumtimit**<br>- **Mjeshtëria e të pyeturit dhe llojet e pyetjeve në lëndën mësimore të historisë**<br>- **Kriteret e pikëzimit të një testit** |

| | |
|---|---|
| | **Qëllimi i programit**: Programi ka për qëllim të aftësojë si dhe rë rrisë kompetencat e mësimdhënsve në fushën e historisë përmes përvetësimit të metodologjive bashkohore të mësimdhënies, artit të të pyeturit, kritereve të ndërtimit të testit dhe vlerës së pikëzimit, nxitjen e mendimit kritik dhe kreativ tek nxënësit të mbështetur edhe në punën hulumtuese për nivelin e nxënësve, të mësuarit e krahasimit të ngjarjeve dhe proceseve historike, etj..<br>Ky program synon të rrënjosë tek mësuesit faktin se mësimdhënia e suksesshme varet nga aftësia që ka mësimdhënësi për të zbatuar metodat më bashkohore të mësimdhënies dhe të garantohet një mësimnxënie efikase. Gjithashtu , duhet theksuar rolin e madh që ka në mësimdhënien bashkëkohore procesi I pyetjes, sepse ky process tanimë po merr rëndësi të dorës së parë ndërveprimi intensiv mes mësuesit dhe nxënësit. Nisur nga ky këndvështrim, ky program ka si qëllim veç të tjerash që mësuesit të aftësohen në nivelin mjeshtëror të hartimit të pyetjeve, kjo për faktin se pyetjet e drejtuara nxënësit nxisin e organziojnë proceset e të menduarit kritik. Gjithashtu mjeshtëria e të pyeturit dhe llojet e pyetjeve ndihmojnë për të arrirur qëllimet dhe objektivat e përgjithshme dhe të veçanta, për tema, kapituj dhë lëndën në tërësi. Djui themelueis i filozofisë progresiste në edukim, për mjeshtërnë e pyetjeve shprehet: “Të dish të bësh pyetje do thotë të dish të japësh mësim. Më shumë se çdo tjetër arti i bukur i mësimdhënies varet nga mejshtëria e përdorimit të pyetjeve, pasi ajo shërben si drejtim për ide të gjalla dhe të qarta, të nxit me shpejtësi imagjinatën për mendimin, gjë që shtyn për veprim”. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Ky program trajnimi do të mbështetet në një varg metodash të cilat e kompletojnë procesin e mësimdhënsies dhe mësimnxënies:<br>Metoda e shpërndarjes së informacionit përmes ligjërimit<br>Metodat krahasimi<br>Metoda e demostrimit praktik<br>Metoda kooperuese dhe ndërvepruese mes trajnuesit dhe mësimdhënësit, e jetësuar në punën konkrete<br>Metodologjia ëq prëcakton hartimin, mënyrën dhe vlerësimin e pyetjeve, ndërthurjen me teknikën e ndërveprimit<br>Metodat e hulumtimit<br>Metodat e vlerësimit përmes testimit dhe pikëzimit |
| **Certifikimi** | Gjate trajnimit, trajnerët monitorojnë dhe vlerësojnë përfshirjen e pjesëmarrësve në diskutime gjatë pjesës së debatimit për rastet konkrete të paraqitura si pjesë e zbatimit praktik. Trajneri vlerëson analizën dhe qëndrimin kritik të pjesëmarrësve për rastet e paraqitura si pjesë e ushtrimeve duke vlerësuar qëndrimin kritik për rastet në fjalë. Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 10% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit. |

| | |
|---|---|
| | Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajnerët zbatojnë me perpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë së aplikuar gjatë trajnimit.<br>*Perfshirja aktive ne debat 5%*<br>*Pjesa praktike 15%*<br>*Testi vlerësues 80%* |
| **Trajner sa trajner** | Qerim Dalipi, Ndriçim Mehmeti, Besim Morina |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | Moduli 2 – Mundësimi i të të nxënit për të gjithë |
| **Titulli i organizatës:** | Këshilli i Evropës |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Këshilli i Evropës |
| **Adresa:** | Bedri Pejani 17,18 Prishtinë |
| **E-mail:** | Education.pristina@coe.int |
| **Telefoni:** | + 383 (0) 38 40 77 68 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.109/109, Datë: 13.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 24 orë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit në Qendrat Burimore, mësimdhënësit në shkollat e rregullta që punojnë me fëmije me nevoja të veçanta arsimore, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 150 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pjesëmarrësit në këtë modul pritet të mësojnë praktikitsh se si mundësohet mësimi për secilin fëmije, pavarësisht aftësisë, në bazë të një plani të idividualizuar dhe të adresojnë praktikat në lidhje me vlerësimin, planifikimin dhe realizmin e ndërhyrjeve në qendra burimore dhe shkolla të rregullta. Ky Modul i dytë shërben si një mundësi për të parashtruar të gjitha çështjet e rëndësishme në lidhje me të kuptuarit, vlerësimin dhe adresimin e çështjeve që lidhen me mundësimin e të nxënit për të gjithë fëmijet, duke marrë parasysh kufizimet funksionale, me një fokus në problemet e pjesëmarrjes. Aktivitetet në të tre njësitë çojnë në praktika që mund të realizohen në qendra burimore për të përmirësuar praktikat aktuale.<br><br>Moduli synon poashtu që t`a përafrojë punën në fusha të aktiviteteve me planin e individualizuar, domenet e jetës bazuar në Kornizen Ndërkombëtare të Funksionimit (KNF) si dhe me kornizën e Kurrikulës Kombëtare. Situata e arsimit është në qendër të këtij moduli. Qëllimi është që të kuptohet të nxënit si nocion, dhe pastaj të planifikohet dhe mundësohet për secilin fëmijë në mënyrë që të realizohet e drejta e tyre themelore për arsim.<br>Si përmbledhje, moduli do të ndërtojë njohuri, aftësi dhe kompetenca përkatëse për të zhvilluar mësimin e individualizuar për secilin fëmijë në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe në përputhshmëri me politikat vendore. |
| **Përmbajtja:** | Njësia 1 - ka të bëjë me krijimin e kuptimit dhe ndërtimin e vizionit, dhe për aplikimin e një perspektive afatgjatë që mund të lidhet me vizionin e shprehur në Nenin 24, 1 të KDPAK-së (shih kuotën më lart). Krijimi i sensit kuptohet si një proces i dhënies kuptim një situate komplekse për të qenë në gjendje të zhvillojë një plan dhe më pas të ndërmarrë |

veprime. Paragjykimet, pritjet e ulëta dhe qëndrimet negative janë rezultat i krijimit të sensit të përditshëm të mësimdhënësve, prindërve dhe fëmijëve që duhet të sfidohen para se të trajtojnë çështjet teknike të shkrimit të një plani individual arsimor (PIA). Njësia 1 inkurajon pjesëmarrësit të mendojnë për përcaktimin e qëllimeve nga perspektiva e tyre për të kuptuar më mirë rëndësinë e motivimit, të mbështetjes së ofruar nga të tjerët dhe kushtet e situatës që ndihmojnë ose pengojnë arritjen e qëllimeve. Një sërë fushash mundësuese do të prezantohen për të ndihmuar pjesëmarrësit në zhvillimin e një vizioni arsimor afatgjatë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Njësia 2 ka të bëjë me zhvillimin e një kuptimi të thelluar të lidhjeve midis Kornizës Kombëtare të Kurrikulës në Kosovë, fushave të aktiviteteve të përdorura aktualisht si kurrikulë për fëmijët me aftësi të kufizuara të shumëfishta dhe fushave të jetës të KNF-së. Meqenëse të dy qasjet kurrikulare përdoren në qendrat burimore, është e rëndësishme të krijohen lidhje dhe të plotësohen boshllëqet midis tyre. Përveç kësaj, arsimi gjithëpërfshirës nuk mund të arrihet nëse nuk ka të kuptuar të unifikuar të qëllimeve dhe përmbajtjes së arsimit. Qëllimet kryesore të Kornizës Kombëtare të Kurrikulës në Kosovë ofrojnë orientimin e nevojshëm të qëllimeve i cili aktualisht mungon në "Fushat e aktiviteteve". Pjesëmarrësve u jepet mundësia të reflektojnë mbi praktikat e tyre aktuale në lidhje me zhvillimin dhe përdorimin e Planeve Individuale Arsimore (PIA) dhe nëse planet po adresojnë vërtet situatën arsimore të fëmijës, ose nëse ata kryesisht janë duke u fokusuar në përmirësimin e situatës së pjesëmarrjes (p.sh. përmes "përmirësimit të sjelljes"). Një aktivitet i kushtohet gjithashtu harmonizimit midis Fushave të aktiviteteve dhe Fushave të jetës të KNF-së. Kjo do t'u mundësojë pjesëmarrësve të marrin parasysh situatën e aftësisë së kufizuar të një fëmije dhe të sigurojnë jo vetëm trajnimin e "aktiviteteve" ose "shkathtësive", por edhe përvetësimin e kompetencave që do të rrisin dhe pasurojnë pjesëmarrjen efektive në shoqëri.

**Njësia 3** fokusohet në miratimin e një plani të personalizuar të mësimnxënies duke theksuar se si aktivitetet (p.sh., të përcaktuara si qëllime në PIA) kanë kuptim vetëm kur kontekstualizohen (p.sh., "flet me edukatë"). Mundësitë e mësimnxënies lidhin "aktivitetet" me qëllimet (probleme reale që duhen zgjidhur), strategjitë e qarta të mësimdhënies dhe sigurojnë një kontekst të jetës reale që është kuptimplotë dhe motivues për nxënësit. Do të jepen konsiderata se si mund të përmirësohen mjediset për të mundësuar mësimnxënien, jo vetëm funksionimin. Mësimdhënia dhe mësimnxënia janë të lidhura ngushtë, prandaj ndërveprimi dhe komunikimi mes mësimdhënësit dhe

| | |
|---|---|
| | nxënësve është i një rëndësie kyçe. Prandaj, njësia përfshin një aktivitet të fokusuar në mënyrën se si mësimdhënësit mund të mbështesin mësimnxënien përmes dialogut dhe vlerësimit formues. Moduli përfundon me fokus në vlerësim, duke theksuar rëndësinë e vetëvlerësimit dhe atë në mes të kolegëve. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Secila njësi përbëhet nga katër aktivitete që adresojnë një fushë të kompetencave ose praktikat kryesore të nevojshme për t'u zhvilluar në mënyrë që të kuptojnë, vlerësojnë dhe adresojnë problemet e mësimnxënies që hasin fëmijët me aftësi të kufizuara. Çdo aktivitet ndjek të njëjtin format: Përgatitja (përqendrimi i vëmendjes në çështje specifike, përmes diskutimit të ideve për të aktivizuar njohuritë, shikimi i një video për të nxjerrë në pah një problem ose diskutimi i përvojave të pjesëmarrësve). Përgatitja pasohet nga një prezantim i cili mund të incizohet dhe t'u vihet në dispozicion kolegëve që nuk mund të merrnin pjesë (përfshirë kolegët që punojnë në shkolla të rregullta). Prezantimi ose kontributi pasohet nga një sekuencë ku pjesëmarrësit janë të angazhuar në mënyrë aktive në zgjidhjen bashkëpunuese të problemeve, ndarjen e përvojave dhe zhvillimin e praktikave të mira. Çdo aktivitet përfundon me mënyra të mundshme përpara drejt zbatimit, zhvillimit të mjeteve ose zhvillimit të materialeve që më pas mund të validohen dhe ndahen me të tjerët.<br><br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen të sjellin materialet e veta, mjetet dhe të bëjnë video të situatave që ata dëshirojnë të përmirësojnë. Për modulin 2, kjo përfshin dokumentet zyrtare të ministrisë (p.sh. Korniza Kombëtare e Kurrikulës në Kosovë, Mësimdhënia në Fushat e aktiviteteve, Udhëzimet për zhvillimin e PIA). Të drejtat e privatësisë (p.sh., marrja e pëlqimit të prindërve për të ndarë videot) do të merren në konsideratë. Pjesëmarrësve do t'u prezantohen modele (p.sh., modeli i teorisë së aktivitetit, cikli i zgjidhjes së problemeve, harta e ekosistemit) që përdoren gjithashtu në modulet e UNICEF-it për Arsimin gjithëpërfshirës. Ato shërbejnë si modele të të menduarit për të ndihmuar në organizimin e informacionit dhe për të biseduar me të tjerët për çështje specifike. Modelet janë gjithashtu pika fillestare për të zhvilluar protokolle që përshtaten me nevojat e secilës shkollë. Për më tepër, ato mund të përdoren për të lidhur punëtorinë tematike me njohuritë e marra në modulet hyrëse dhe për të zhvilluar materiale mësimore. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit që kanë ndjekur të tri ditët e këtij moduli mund të pajisen me certifikatë |
| **Trajner sa trajner** | 2 trajnere |
| **Data e aplikimi** | 08.08.2022 |

| Titulli i Programit: | Ndërlidhja e shkollave me tregun e punës |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor - plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.61/61,Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 16 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Njohjen me modelin e mësimit dual,<br>• Identifikimin e organizatave dhe aktereve të cilat janë relevante për krijimin e partneriteteve dhe ndërlidhjeve me një lloj të caktuar të shkollës (profili),<br>• Njohjen dhe gjetjen e formave ekzistuese të partneritet,<br>• Regjistrimin e formave të reja të partneritetit,<br>• Evidentimin e kompanive dhe organizatave për te filluar partneritete te reja,<br>• Inicimin e proceseve për përfshirjen e përfaqësuesve të industrive (sektorëve) specifikë në krijimin e:<br>o Materialeve trajnuese<br>o Analizave të nevojave për trajnime apo profile të reja<br>o Informatave kthyese për kurrikula, standarde profesionale, etj.<br>o Krijimin e raporteve me donatorë,<br>o Identifikimin e instruktorëve profesional,<br>o Identifikimin e vendeve të reja të punës, praktikës dhe punës vullnetare, etj. |
| **Përmbajtja:** | • Njohja me Modelin e Mesimit Dual<br>• Analiza e stakeholders<br>• Njohja e përgjegjësive të palëve të interesit<br>• Njohja e formave të bashkëpunimit shkollë - biznese<br>• Përgjegjësitë e shkollës, instruktorit në vendin e punës, nxënësit, ndërmarrjes |

| | |
|---|---|
| | • Nivelimi i shkathtësive<br>• Ristrukturimi i orarit te mësimit, praktikës<br>• Kontrata Nxënës – Shkollë – Ndërmarrje<br>• Krijimi i formave të reja të bashkëpunimit<br>• Menaxhimi i formave ekzistuese të bashkëpunimit<br>• Krijimi i ndërlidhjeve të reja në program<br>• Menaxhimi i ndërlidhjeve ekzistuese |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor**<br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një <u>Plan Personal të Zhvillimit</u> si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit: | NDËRMARRËSIA DHE EDUKIMI FINANCIAR |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 50/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr.49/49 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Numri i orëve të programit trajnues është 24. Orët e trajnimit janë 18. Të tjerat janë orë të dedikuara për implementimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në takimet reflektuese (përgatitje, konsultime online, observime në klasë, etj.) |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet të gjithë mësimdhënësve të fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit të:<br>• Njohin rolin e ndërmarrësisë në shoqërinë moderne;<br>• Demonstrojnë shkathtësive themelore të ndërmarrësisë, proaktivitetit, ndërgjegjësimit dhe të qenit inovativ;<br>• Shfrytëzojnë mjete interaktive që ndihmon provokimin e të menduarit si ndërmarrës tek të rinjtë (lojërat, puna në terren, diskutimet, prezantimet);<br>• Aplikojnë raste të studimit apo videove gjatë mësimit të ndërmarrësisë;<br>• Nxisin kreativitetin dhe zgjedhjen e problemeve përmes projekteve në ndërmarrësi;<br>• Përdorin metoda të thjeshta për të mësuar rreth pritjeve të klientëve për produktet apo shërbimet e ofruara në ndërmarrësi;<br>• Aplikojnë plane të thjeshta financiare. |
| **Përmbajtja:** | Shkathtësitë ndërmarrëse tek nxënësit; Planifikimi i biznesit, administrimi, marketingu, menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe menaxhimi i projekteve. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin detyrat përgatitore duke pranuar materialin për lexim fillestar. Pastaj, pjesëmarrësit do të vijojnë tri ditë të plota, secila ditë me nga katër sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. |
| **Certifikimi:** | Kushtet për certifikim: 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor; Portfolio që dëshmon se janë zbatuar aktivitetet në klasë me nxënësit (me së paku 5 plane mësimore të lidhura me rezultatet mësimore / apo një projekt mësimor); [për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore (përveç 'jeta dhe puna') janë të mjaftueshme 2 plane mësimore]; Themelimi i firmës virtuale ose reale të nxënësve të shkollës. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Orientimi në karrierë - Njohuri të përgjithshme |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.60/60, Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 24 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• T'i njeh nocionet kyçe të orientimit në karrierë<br>• Të njeh plan programin mësimor për orientim dhe edukim në karrierë<br>• Klasifikimin e profesioneve sipas ESCO, KK dhe ISCED<br>• Përgatitjen për organizimin e takimeve reale me ekspertë në shkollë dhe jashtë shkolle<br>• Vizita nëpër shkollat e mesme të larta, institucione, ndërmarrje, panaire etj. |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br><br>• Shpjegoj tranzicionin nga shkolla e mesme e ulët në shkollë të mesme të lartë<br>• Identifikimin e shkollimit të mëtejmë dhe nivelet e ndryshme të karrierës profesionale<br>• Klasifikimin e nxënësve nëpër grupe të interesit për vizita në shkolla të mesme të larta<br>Shpjegimin dhe njohjen e nocioneve për orientim në karrierë |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor** Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke |

| | |
|---|---|
| | ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, metoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit | Pedagogjia e Edukimit Psiko-Fizik dhe Shëndetësor |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr. 03/3Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | Numri i ditëve të trajnimit: 4<br>Numri i orëve të trajnimit: 30<br>Mjekësi Sportive –8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë struktrurë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 4 orë teori dhe 4 orë praktikë)<br>PsikologjI Sportive – 8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë struktrurë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 6 orë teori dhe 2orë praktikë)<br>Edukim Shendetesore – 8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë struktrurë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 6 orë teori dhe 2 orë praktikë)<br>Përmbledhje dhe vlerësim – 6 orë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit fillestar, të karrieres dhe ata të avancuar të lëndës së Edukatës Fizike, me mësim në gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera të komuniteteve (turke, boshnjake, serbe etj), të nivelit të mesëm të ulët (klasa 6-9) dhe nivelit të mesëm të lartë (klasa 10-12).<br>Mësimdhenesit e Edukatës Fizike e kanë të domosdoshme ndjekjen e trajnimeve të cilat ndërlidhen me edukimin psiko-fizik dhe shëndetësor të nxënësve.<br>Gjithashtu ky trajnim mund të ofrohet edhe për mësuesit e ciklit fillor (klasa 1-5) e reduktuar në një ditë trajnim në vlerë prej 8 orëve,( reduktimi bëhet në fondin e orëve nga totali i përgjithshëm në këtë shtrirje: Mjekesia sportive,2 orë, Psikologjia Sportive 2 orë, Edukimi shendetësorë 2 orë, dhe përmbledhje dhe vlerësim 2 orë). |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Në program synohet të përfshihen të gjithë mësimdhënësit e Edukatës Fizike në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe një pjesë të mësuesve të ciklit të ulët (klasa 1-5). |

| | |
|---|---|
| | Një grup mund të përmbajë 25 kandidatë, dhe planifikimi për përfundimin e programit të trajnimit realizohet për 4 dite punë |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Mësimdhënësit zotërojne njohuritë e domosdoshme në fushën e Mjekësisë Sportive per menagjimin e situatave që mund të paraqiten si rezultat i lëndimeve fizike.<br>Mësimdhënësit zotrojnë njohuritë e domosdoshme në fushën e Psikologjisë Sportive për menaxhimin e situatave të thyerjes psikologjike të nxënësve që mund të shfaqen si pasojë e lëndimeve (aksidenteve) fizike.<br>Mësimdhënësit zotrojnë njohuritë e domosdoshme në fushën e Edukimit Shëndetësor me qellim që nxënësit te orientohen drejtë mbi rëndësinë e edukimit shëndetësor (higjienës, aktivitetit fizik, ushqimit etj)<br>Mësimdhënësit vleresojnë drejt rëndësinë e pedagogjisë së edukimit psiko-fizik dhe shëndetësor, duke krijuar dhe infrastrukturën e nevojshme mjekësore. |
| **Përmbajtja:** | Metodat e mësimdhënies përmes së cilave kërkohet që nxënësit të jenë në qendër te zhvillimit edukativo-fizik përbëjnë në vetvete nje filozofi suksesi te mesimdhenies, ku ne rastin konkret nxenesi ndjehet i trajtuar dhe në qendër të vëmendjes edhe në raste të aksidenteve që mund të shfaqen si rezultat i aktivitetit fizik në orë të mësimit apo në hapësirat shkollore.<br>Përmbajtja:<br>Mjekësi Sportive:<br>- Parandalimi i lëndimeve sportive<br>- Ndihma e parë pas lëndimeve sportive<br>- Menaxhimi i lëndimeve sportive<br>Psikologji Sportive:<br>- Motivimi dhe emocionet në sport<br>- Dinamika e grupit dhe lidershipi<br>- Vëmendja dhe fokusi në sport<br>Edukim Shëndetësore:<br>- Hyrje ne Kujdesin Shendetesorë ( Rëndësia e kujdesit shëndetësorë, infektimet, manifestimi klinik dhe menaxhimi.<br>- Higjiena, Roli i higjienës së duarëve, higjiena e trupit, teknikat e higjienës<br>- Shendeti Sportiv (Ushqimi, Fjetja, Aktiviteti Fizik etj) |
| **Metodat e realizimit të programit** | Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me thënien e më sipërme të psikologut të shquar *KurtLevinit.* Gjatë trajnimit 50% e kohës do të jetë punë teorike dhe 50 % e kohës praktikë.<br><br>Ligjërim<br>Punë individuale dhe punë në grupe<br>Studime rasti<br>Demonstrim praktik<br>Diskutim |
| **Certifikimi** | Gjate trajnimit, trajnerët monitorojnë dhe vlerësojnë përfshirjen e pjesëmarrësve në diskutime gjatë pjesës së debatimit për rastet konkrete |

| | |
|---|---|
| | të paraqitura si pjesë e zbatimit praktik. Trajneri vlerëson analizën dhe qëndrimin kritik të pjesëmarrësve për rastet e paraqitura si pjesë e ushtrimeve duke vlerësuar qëndrimin kritik për rastet në fjalë. Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 10% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit.<br>Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajnerët zbatojnë me perpikmëri agjendën e parapare dhe përdorimin e metodologjisë së aplikuar gjatë trajnimit.<br>*Perfshirja aktive ne debat 5%*<br>*Pjesa praktike 15%*<br>*Testi vlerësues 80%* |
| **Trajner** | PhD. Cand Rilind Obertinca<br>PhD. Cand Rina Meha |
| **Data** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit** | **Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | QAPA-Qendra për Avancimin e Perfomancës së Arsimit |
| **Tipi i programit:** | Arsimor |
| **Ofertuesi i programit:** | QAPA-Qendra për Avancimin e Perfomancës së Arsimit |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | info@qapa-ks.org |
| **Telefoni:** | 048-750-751 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr .19/19 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi përmban 24 orë / 4 ditë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësit mentor, mësimdhënësit e merituar, Drejtorët e institucioneve arsimore |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 25 pjesëmarrës.<br><br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas përdorimit të trajnimit, vijuesit do të jenë në gjendje:<br>-Të kuptojnë dhe të njohin rëndësinë e perdorimittë TIK-ut në mësimdhënie.<br>-Të hulumtojnë dhe të gjejnë informatën e duhur në internet.<br>-Të përvetësojnë njohuritë e nevojshme për programet kompjuterike si: Word, Excel, PowerPoint, Windows Media Player etj.<br>Të përvetësojnë njohuri të nevojshme për pajisjet teknologjike si: kompjuterët, printerët, usb-të, projektor-ët, DVD-të etj.<br>-Të zbatojnë keto informata ne praktikë<br>-Të aplikojnë informatat e gjetura në internet si: videot, fotot, animacionet, lojëra etj, përmes programeve kompjuterike, gjatë orëve mësimore<br>- Vijuesit aftësohen që inovacionet e fituara t'i jetësojnë në procesin e mësimdhënies me qëllim të nxënit të suksesshëm nga nxënësit. |
| **Përmbajtja:** | Zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë në vitet e fundit padyshim që ka ndikuar në ndryshimin e mënyrës së funksionimit të çdo institucioni, përfshirë këtu edhe atyre edukative.<br>Aplikimi i teknologjisë tani më nuk është thjeshtë një inovacion por një domosdoshmëri.<br>TIK-u paraqet të gjitha llojet e pajisjeve teknologjike dhe programeve kompjuterike të cilat përdoren per gjetjen e informacioneve të nevojshme, manipulimin me këto informacione dhe aplikimin e tyre në procesin mësimore, duke ndryshuar kështu mënyrën tradicionale të mësimdhënies në atë moderne.<br>Shfrytëzimi i këtyre zhvillimeve teknologjike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies imponon edhe ndryshimin e metodologjisë së përdorur gjatë mësimdhenies duke krijuar kështu metoda bashkëkohore, |

atraktive dhe kreative, me fokus nxënësin, të cilat po ndikojnë dukshëm në mësimdhënie/mësimnxëni. Pajisjet teknologjike si: kompjuterët, projektorët, tabelat dixhitale, programet kompjuterike, internet, tabletët etj, janë përfshirë në sistemin e arsimit me ç'rast janë duke e ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme këtë proces.

Ky revulucion teknologjikë ka sjell me vete shumë avantazhe tjera si:

- Mësimdhënie/nxënie më të lehtë, më të shpejtë, më efikas
- Zhvillimin e kreativitetit tek nxënësit
- Përforcimin e njësive të shpjeguara
- Rritjen e aktivitetit në orën mësimore
- Mbajtjen e vëmendjes në mësim
- Ofrimin e shumë alternativave përgjetja e mënyrës së duhur që nxënësit të dëgjojnë dhe të përgjigjen.
- Bashkëveprim më të madhë nxënës me nxënës sikur edhe arsimtar me nxënës
- Forma të shumta të kombinimit të materialit teorik dhe praktik
- Transpofrmimin e klasës në një ambient pune dhe nxënieje etj

Ky program studimor ka për qëllim që të përgatisë mësimdhënësit në aspektin professional për shfrytëzimin e TIK nga mësimdhënësit dhe nxënësit për qëllime arsimore.

Dominimi i metodave tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo ato praktike, mungesa e metodave interaktive dhe inovacioneve bëjnë që Teknologjia Informatike e Komunikimit të shfrytëzohet si reformator në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim fillon qysh nga fakti i përgatitjes së të rinjve për këtë fushë meqë zhvillimi i shoqërisë informatike paraqet një nga detyrat prioritare të gjithë ne. Ky program do ti trajtojë ndryshimet dhe efektet e TIK-ut në arsimin duke vëndosur theksin në nevojën dhe aplikimin sa më efikas të TIK-ut, në ndryshimin e metodave mësimore nga ato tradicionale në interactive.

Modulet I

Ky modul ju jep mundësi vijuesëve te fitojnë njohuri bazike mbi format e shumta të cilat mund të përdoren gjatë procesit mësimor. Vijuesit do të jenë në gjendje të shohin dhe praktikojnë shembuj konkret të gjetjes, përpunimit dhe aplikimit të metodave dhe shembujve të ndryshëm të cilët mund të përdoren në njesitë mësimore të çdo lënde. Gjetja e informatës së nevojshme dhe të duhur në internet dhe përpunimi i tyre për të arritur zhvillimin më efikas të planprogrami është me rëndësi të veçantë për planifikimin e orës mësimore. Do të testohen njohuritë në mënyrë që të dihen saktë nevojat e pjesëmarrësve.

Modulet II

Gjatë këtij moduli vijuesit te fitojnë njohuri bazike mbi përdorimin e paketës së Microsoft Office si: Word, Excel, PowerPoint, Windows Media Player etj. Informatat e gjetura nga Modul I, do të përpunohen dhe do të integrohen në këto programe kompjuterike. Vijuesit do të planifikojnë një njësi dhe do të zhvillojnë planin se si të përdorin shembuj konkret për njësinë mësimore

| | |
|---|---|
| | duke përodur kështu njërin nga programet kompjuterike në të cilat do të integrohen shembuj si: video, foto, dokumentar, animacion, zë etj. Një shembull i përdorimit të teknologjisë është simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike.<br>Modulet III<br>Aplikimi i pajisjeve teknologjike gjatë punës në klasë si: kompjuterët, projektoret, USB-të, DVD-të me shembuj konkret. Vijuesit do të marrin njohuritë mbi përdorimin e postës elektronike për të komunikuar me nxënësit.<br>Modulet IV<br>Për t'u siguruar se programet dhe mjetet e teknologjisë janë kuptuar në mënyrë efektive, vijuesit do t'i përdorë ato nëpërmjet zbatimit me shembuj konkret. Detyra e mësimdhënësit është të ndajë informacionin e duhur duke përdorur një metodë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë shumë e rendësishm për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale.<br>Axhenda<br>Dita I-rë Si mund të përdoret TIK në mësimdhenie dhe mësimnxënie<br>• Si të përdorim internetin për të arritur deri tek informata e nevojshme<br>• Shembuj praktik i aplikimit të TIK në secilen lëndë<br>Dita II-të Përvetësimi i njohurive bazë për paketën Microsoft Office: - Word - Excel - Power Point - Windows Media Player<br>Dita III-të Përdorimi i postës elektronike (email) • Përdorimi i pajisjeve teknologjike - Kompjuterëve - Printerëve - Projektorit - USB-ve<br>Dita IV-të Aplikimi dhe praktikimi i gjitha moduleve duke përdorur programet kompjuterike dhe pajisjet teknologjike |
| **Metodat e realizimit të programit** | • Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve<br>• Mësimdhënia algoritmike<br>• Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t<br>• Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese |
| **Certifikimi** | Përfshirja aktive në debat dhe pjese praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 5% te pikeve gjate procesit të vleresimit.<br>Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajneret zbatojnë me përpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë se aplikuar gjatë trajnimit.<br>*Perfshirja aktive 5%*<br>*Pjesa praktike 25%*<br>*Testi vlerësues 70%* |
| **Trajner** | Valdete Daku Trajnere Inxhinieri Kompjuterike<br>Rinor Bytyçi Trajner Trajner „Internet Technology and Architecture" – Germany/Italy<br>Florinda Gashi Trajnere "Sistemeve të informacioneve" - UBT |
| **Data** | 21.04.2022 |
| | |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **Përgatitja e Ekipit Vlerësues në nivel shkolle dhe komune për përdorimin e instrumenteve të Vlerësimit Pedagogjik të Nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF-FR)** |
| **Titulli i organizatës:** | OJQ "Mësimdhënia e mirë" - MEM |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | OJQ "Mësimdhënia e mirë" - MEM |
| **Adresa:** | Rr. Isa Kastrati nr. 69, Prishtinë |
| **E-mail:** | mesimdheniaemire@gmail.com arbenzabeli@gmail.com |
| **Telefoni:** | 044-415-558 – 049-541-053 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.104/104 Datë: 13.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Të planifikuara janë 40 orë,<br>32 teori dhe 8 orë praktikë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit lëndorë, mësimdhënësit klasorë, mësimdhënësit mbështetës, pedagogë, drejtorë shkollash, mësimdhënës të klasëve të bashkangjitura, asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta, edukatorët, prindërit dhe zyrtarët komunalë. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 15 - 25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | • Të kuptojnë proceset e vlerësimit të nxënësve duke përdor instrumentet e Vlerësimit Pedagogjik sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së kufizuar dhe Shëndetit (KNF-FR);<br>• Të identifikojnë vështirësitë e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore si dhe vlerësimin e tyre;<br>• Të trajtojnë vështirësitë e identifikuara në mënyrë profesionale, duke përdorur metodologjinë e bazuar në qasjen individuale për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;<br>• Të zbatojnë instrumentet vlerësuese në funksion të vlerësimit sa më adekuat për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;<br>• Të plotësojnë instrumentet e vlerësimit në mënyrë praktike të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;<br>• Të raportojnë me anë të formularëve të vlerësimit tek organet kompetente, duke u bazuar në UA të nxjerrë nga MASHTI. |
| **Përmbajtja:** | • Koncepti i gjithëpërfshirjes;<br>• Gjithëpërfshirja dhe përhapja e arsimit gjithëpërfshirës;<br>• Dokumente ligjore vendore dhe ndërkombëtare që e mbështesin gjithëpërfshirjen;<br>• Infrastruktura ligjore që rregullon arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë;<br>• Indeksi i Gjithëpërfshirjes;<br>• Çfarë është KNF-FR?<br>• Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Kosovë;<br>• Ngritja e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese për përdorimin e instrumenteve për Klasifikimin Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe |

| | |
|---|---|
| | Shëndetit;<br>• Prezantimi i instrumenteve për Ekipin Vlerësues Pedagogjik;<br>• Aktivitete grupore (simulim i rasteve);<br>• Prezantim i instrumentit për Ekipin Vlerësues;<br>• Profili i funksionimit të fëmijëve dhe rekomandime vepruese për shkollën dhe familjen;<br>• Prezantim i raportit të Ekipit Vlerësues – detyra nga pjesëmarrësit;<br>• Programi i trajnimit përfshin 5 ditë trajnimi nga 8 orë, që do të thotë se, çdo pjesëmarrës ka nga 32 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike. Çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit merr 40 orë trajnim. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Diskutim, nxënie bashkëpunuese, punë në grupe, prezantime, diskutime në grupe të vogla, angazhime dhe detyra në punën e tyre etj. |
| **Certifikimi** | Mësimdhënësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë dhe kryerjes së detyrave të planifikuara në programin e trajnimit. |
| **Trajner sa trajner** | Arben Zabeli, Bujar Thaçi, Liridona Ukshini, Remzije Osmani, Vjollca Osmani Jashari, Shqipe Rexhepi, Suzana Gjergji, Mimoza Zharra, Burim Sylejmani, Safet Dushaku, Ardita Voca Hashani, Njomza Ibrahimi dhe Mergime Kajtazi |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES PRODUKTIVE |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Adresa:** | rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë |
| **E-mail:** | qeht.konica@gmail.com |
| **Telefoni:** | 049 328 528 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | ***Nr. 73/73, Datë. 10.06.2022,*** **Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 32 orë |
| **Përfituesit:** | 3. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3; |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t‘i kryej këto aktivitete/detyra:<br>o Të përcaktojë qëllimin e mësimit sipas nevojave të nxënësve;<br>o Të përzgjedhë dhe organizojë përmbajtjen mësimore;<br>o Të planifikojë orën mësimore bazuar në veprimtaritë dhe rezultatet e parashikuara;<br>o Të ketë vizion të plotë dhe afatgjatë të qëllimeve mësimore;<br>o Të përshtatë metodat mësimore krahas ritmit të materialit, mënyrës së paraqitjes, organizimit dhe menaxhimit të klasës;<br>o Ta përvetësojë njohuritë për krijimin e strukturës për përmbajtjen e orës mësimore;<br>o Të fitojë njohuri për paraqitjen e materialit në mënyrën më të përshtatshme që të përvetësohet nga nxënësit. |

| | |
|---|---|
| **Përmbajtja:** | ***Përmbajtja e programit:***<br><br>• Planifikimi i mësimdhënies produktive<br>- Mësimdhënësit e suksesshëm planifikojnë me sukses<br>- Planifikimi dhe përgatitja<br>- Njohuritë e mësimdhënësit si vendimmarrës;<br>- Qëllimet dhe funksionet e planifikimit.<br>• Përbërësit e planit ditor<br>- Tërheqja e vëmendjes;<br>- Komunikimi i objektivave;<br>- Paraqitja e materialit.<br>• Formimi i sjelljes së dëshirueshme<br>- Sigurimi i komenteve dhe informacionit të ndërsjellë;<br>- Vlerësimi i sjelljes. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi realizohet përmes trajnimit që zhvillohet në klasë. Metodologjia e përdorur është e bazuar në ligjërim dhe punë praktike gjatë gjithë trajnimit. Trajnimi zgjatë 2 ditë + 1 ditë monitorim. Në këtë trajnim do të përfshihen edhe shembujt praktikë për të gjitha pjesët e programit.<br><br>Trajnimi bazohet në:<br><br>○ Ligjërim<br>○ Prezantim me Powerpoint<br>○ Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit;<br>○ Ushtrime<br>○ Aktivitete atraktive<br>○ Kombinim i materialeve tekst dhe video. |
| **Certifikimi** | Certifikimi, 32 orë |
| **Trajner** | Diana Qarkaxhija<br><br>Arbër Morina |
| **Data** | 28.07.2022 |

| Titulli i Programit: | PLANIFIKIMI I PROJEKTEVE SHKOLLORE |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr. 48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr.12/2011 Data: 19.01.2011<br>Nr.85/2013 Data: 13.11.2013<br>Nr.41/2018 Data: 12.11.2018<br>**Nr.44/44 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri (3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë):** | Programi organizohet në formë të një seminari 2-ditor.<br>Programi ka gjithsej **16 orë.** |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet të punësuarve në administratën arsimore, mësimdhënësve dhe pjesëtarëve të komunitetit shkollor, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të zotëruar teknikat e planifikimit të projekteve shkollore. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:<br>• Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e definimit dhe të analizës së problemeve si pikënisje për planifikimin e një projekti;<br>• Të definojnë sistemin e objektivave të një projekti në bazë të transformimit të trungjeve problemore në trungje të objektivave;<br>• Të kuptojnë strukturën e kornizës logjike dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve;<br>• Të drejtojnë procesin e planifikimit të një projekti me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. |
| **Përmbajtja:** | Elemente të planifikimit strategjik. Tema simuluese. Diagnostika e problemeve. Grupëzimi i problemeve. Analiza e shkaqeve dhe pasojave. Ndërtimi i trungjeve të suksesit. Analiza e opsioneve të mundshme. Kuptimi i kornizës logjike. Logjika e intervenimit. Treguesit e suksesit. Analiza e rrezikut. Plani operativ i projektit. Buxheti i projektit. Parashtrimi i projektit. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Gjatë dy ditëve të trajnimit, pjesëmarrësit punojnë në një projekt simulues, e me qëllim të përvetësimit të të gjitha fazave të planifikimit të një projekti. Kjo qasje bën të mundur që ata të fitojnë shkathtësi praktike për planifikimin e një projekti shkollor, duke i |

| | |
|---|---|
| | njohur të gjitha hapat e procesit dhe duke u sprovuar me sfidat që sjell një proces i tillë.<br>Programi ka gjithsej **16 orë**. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 80% në seminar, si dhe kryerja e detyrave që jepen gjatë trajnimit. |
| **Trajner sa trajner:** | 3 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | Planifikimi sipas nevojave te nxënësit (nxënës me nevoja te veçanta). Hartimi i planit individual i arsimit PIA |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048-751-752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Numër: 09/9 Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 16 orë në total: 10 orë në auditor, 6 orë përgatitje individuale për hartimin e një plani Individual Arsimor dhe 2 orë praktikë në shkollë. Kjo e fundit është opsionale në varësi të kohës dhe mundësisë që kemi. Pra nëse kemi mësim fizik, do të kemi edhe mentorim, përndryshe na mbetet vetëm trajnim teorik. |
| **Përfituesit:** | Nga ky program do të përfitojnë:<br>• Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02);<br>• Mesimdhenesit fillestar<br>• mësimdhënësit të avancuar,<br>• mësimdhënësit mentor dhe të mësimdhënësit të merituar;<br>kordinatorët e cilësisë |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës.<br>Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosvës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Programi i këtij trajnimi synon, të aftësojë mësimdhënësin për:<br>1. Mënyrën e hartimit të PIA në përputhje me nevojat e nxënësve<br>2. Procesin e monitorimit dhe të rishikimit të tij.<br>3. Përshtatja e kurrikulës (përmbajtja e individualizuar) të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve<br>4. Format e vlerësimit të fëmijës |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimi synon të rrënjosë tek mësimdhënësit rëndësinë që ka |

| | |
|---|---|
| | trajtimi me një plan individual arsimor i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të demonstrojë se qëllimi kryesor i PIA-s është që fëmija maksimalisht të përftojë nga procesi mësimor, bazuar në nevojat, mundësitë dhe potencialin e tij/saj. Për të arritur rezultatet e synuara, mësimdhënësi duhet të përcaktojë, qëllime të qarta dhe të arritshme për fëmijën, bazuar në aftësitë e tij/saj. Mësimdhënësi aftësohet në këtë trajnim që qëllimet ti përcaktojë varësisht nga lënda apo fusha ku fëmija ka nevojë (lexim, shkrim, komunikim, përfshirje në lojëra që socializojnë fëmijët etj.). Trajnimi i demonstron mësuesit se rezultatet e të nxënit përkufizohen, si: “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një klase, shkalle apo niveli”. Mësimdhënësi në përfundim të trajnimit duhet të jetë i qartë se: Rezultatet e nxënies duhet të caktohen në bazë të aftësive dhe prirjeve të fëmijës, e jo sipas kërkesave të lëndës në nivel të klasës. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Në këtë trajnim do të përdoret si metodologji kryesore, metoda kooperuese dhe ndërvepruese mes trajnuesit dhe mësimdhënësit, e jetësuar në punën konkrete përmes hartimit të PIA (punë individuale dy orë). Në këtë trajnim do të ishte me interes edhe metoda demonstruese, në rast se do të kishim mundësinë të ndiqnim sesi zbaton PIA në klasë një mësimdhënës që është trajnuar për këtë qëllim. Gjithsesi me rëndësi do të ishte edhe të dëgjohej mendimi dhe të shikohej nga ana e trajnerit sesi është hartuar konkretisht një PIA, për nxënësit në nevojë. |
| **Certifikimi** | Gjate trajnimit, trajneret monitorojne dhe ne perfundim bejne dhe vleresimin me testim dhe gjithashtu vleresimin e dosjes ku shperndarja e perqindjes se vleresimit eshte kjo:<br><br>*Pjesa praktike 50%*<br>*Testi vlerwsues 50%* |
| **Trajner** | • Dr. Ndricim Mehmeti<br>• MA. Anila Beshaj<br>• Dr. Saranda Shatri<br>• Dr. Armen Mustafa |
| **Data** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Programi për të drejtat e njeriut për të rinjtë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Youth Initiative for Human Rights Kosova (YIHR KS) |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Youth Initiative for Human Rights Kosova (YIHR KS) |
| **Adresa:** | Rruga: "Adrian Krasniqi", nr.5, kati II, Prishtinë |
| **E-mail:** | ksoffice@yihr.org, marigona@yihr.org |
| **Telefoni:** | +383 38 748 018, +383 49 795 100 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.82/82, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Dyzet (40) orë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit/et e lëndës së edukatës qytetare në shkollat e mesme të ulëta (6-9) dhe të larta (10-12) |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:<br>• Të zbatojnë në klasat e tyre metoda, teknika dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit, të cilat lehtësojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve të parapara në Kornizën e Kurrikulit dhe rezultatet e të nxënit në lëndën e edukatës qytetare;<br>• Të pasurojnë njohuritë e tyre në aspektin përmbajtësor në lëndën e edukatës qytetare;<br>• Të përdorin aktivitete të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të koncepteve bazë në lëndën e edukatës qytetare;<br>• Të konkretizojnë nocionet ligjore me shembuj nga jeta praktike;<br>• Të aftësojnë nxënësit në hulumtimin e informacioneve të ndryshme në internet, të cilat ndihmojnë të nxënit e koncepteve ligjore dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në lëndën e edukatës qytetare;<br>• Të përdorin forma të ndryshme të vlerësimit të të nxënit, të cilat ndihmojnë në vlerësim sa më objektiv të njohurive dhe kompetencave të përfituara nga nxënësit. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit ndahet në tri kapituj të rëndësishëm me nën-temat si në vijim:<br>**1.** Sistemi Ligjor dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.<br>**a)** Kushtetuta e Republikës së Kosovës.<br>**b)** Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.<br>**c)** Të drejtat kushtetuese për diskutim të përgjithshëm.<br>**d)** Struktura e sistemit ligjor të Kosovës.<br>**e)** Policia e Kosovës. |

| | |
|---|---|
| | **2.** Gjykatat dhe Prokuroritë.<br>**a)** Prokuroria e shtetit.<br>**b)** Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).<br>**c)** Gjykata Themelore.<br>**d)** Juridiksioni i Gjykatës Themelore sipas lëndës.<br>**e)** Gjykata e Apelit.<br>**f)** Gjykata Supreme.<br>**g)** Gjykata Kushtetuese.<br>**3.** Profesionet e Lira.<br>**a)** Avokatët.<br>**b)** Ndihmë Juridike Falas.<br>**c)** Përmbaruesit privat.<br>**d)** Noterët. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi organizohet në formë të 3 moduleve:<br><br>Moduli i parë dhe i tretë mbahen në kohëzgjatje prej dy ditësh secili, ndërsa moduli i dytë do të zgjasë vetëm një ditë. Të gjitha modulet do të zhvillohen gjatë një periudhe 1 mujore. Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku një javë.<br><br>Gjithashtu, si pjesë e programit, gjatë ditëve të trajnimit do të përfshihen sesione të ndryshme për të shkëmbyer praktikat në implementimin e njohurive të marra nga trajnimi.<br>Gjatë sesioneve për shkëmbimin e praktikave të mira, pjesëmarrësit duhet të sjellin një orë mësimore (mësim model) bazuar në nën-temat e paraqitura në program e cila do të bëhet pjesë e portfolios/dosjes së secilit pjesëmarrës. Pas prezentimeve, i gjithë grupi do të identifikojë rastet e suksesit, si dhe do të ofrojë rekomandime për gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e pengesave të paraqitura. |
| **Certifikimi** | Kusht për çertifikimin për pjesëmarrje të suksesshme është:<br>- Me 60% vlerësohet:<br>o përcjellja me rregull e trajnimit (me pjesëmarrje minimumi 80%);<br>o vlerësimi pozitiv gjatë pjesëmarrjes në trajnim (të qenurit aktiv);<br>o përgatitja e dosjes.<br>- Me 40% vlerësohet performanca në testin final që mbahet ditën e fundit të trajnimit.<br>Çertifikimi i kandidatëve me pjesëmarrje të suksesshëm në trajnim do të bëhet për të gjithë pjesëmarrësit të cilët marrin të paktën 65% të rezultatit të përmbledhur final. |
| **Trajner sa trajner** | Numri i trajnerëve do të jetë tre (3):<br>o Liridon Shurdhani<br>o Flutura Kusari<br>Alban Krasniqi |
| **Data e aplikimi** | Data e aplikimit për akreditim në MASHTI: 19.04.2022. |

| Titulli i Programit | Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijët me nevoja të veçanta |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues **themelor** |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048751752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr: 07/7 Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 60 orë |
| **Përfituesit:** | Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02);<br><br>Mësimdhënësit e licencuar me gradat e mësimdhënësit të karrierës, mësimdhënësit të avancuar,<br>mësimdhënësit mentor dhe të mësimdhënësit të merituar;<br>Kordinatorët e cilësise |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | **Në kuadër të këtij programi synohet të arrihen këto objektiva:**<br>• Zhvillojnë qasje për të kuptuar më të thellë për parimet e mësimdhënies së diferencuar;<br>• Planifikojnë qasje të ndryshme në mësimdhënie të nevojshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara për nxënësit e ndryshëm;<br>• Demonstrojnë modifikimin e materialeve dhe detyrave mësimore si dhe përshtatjen e aktiviteteve mësimore nevojave grupore dhe individuale të nxënësve;<br>• Argumentojnë përdorimin e programeve të individualizuara për nxënësit me vështirësi specifike në të nxënë apo për nxënësit e talentuar dhe me dhunti.<br>Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm ndaj karaktersitikave të nxënësve dhe një qëndrim të shëndoshë ndaj punës së vet dhe ndaj nxënësve të cilëve ju shërbejnë, pavarësisht se sa sfidues ose të zgjuar mund të jenë ata. |
| **Përmbajtja:** | Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në të cilën kombinohen shumë natyrshëm procesi i |

| | |
|---|---|
| | edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre.<br><br>Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënit.<br>Qëllimi i këtij programi është t'i aftësojë pjesëmarrësit lidhur me atë që diferencimi mund të zbatohet përmes mënyrës së qasjes në mësimdhënie, përmbajtjes së kurrikulës, metodave të mësimdhënies, modifikimit të materialeve mësimore, organizimit të klasës, grupimit të nxënësve dhe ndërveprimit të mësimdhënësve me nxënësit individualë.<br><br>Ato do te bejne një zhvillim të vazhdueshëm profesional. Mësimdhënësit tashmë në sistem, kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm të cilesisë, njohurive dhe aftësive të tyre gjatë viteve të ardhshme, veçanërisht në lidhje me kërkesat e kurrikulit të ri dhe të didaktikës dhe metodikën aktuale. Kjo është një fushë në të cilën OJQ "EDUMEN" do të kontribuojë pa çështjen sfiduese te qëndrueshmërisë.<br><br>Me program janë paraparë IV module. Fondi orientues i orëve sipas moduleve paraqitet në vazhdim:<br>5. **Mësimdhënia e diferencuar: Kuptimi, diversiteti në klasë dhe nevoja për zbatimin e saj -** ( 7 orë teori dhe 8 orë praktikë)<br>6. **Mësimdhënia e diferencuar bazuar në profilet e nxënësve** ( 7 orë teori dhe 8 orë praktikë)<br>7. **Programi i individualizuar i edukimit/arsimit: Qëllimi dhe përmbajtja e dokumentit tëPIA-së** ( 5 orë teori dhe 10 orë praktikë)<br>8. **Zbatimi i Planit Individual të Arsimit në klasat me mësimdhënie të difrencuara** ( 5 orë teori dhe 10 orë praktikë) |
| **Metodat e realizimit të programit** | Trajnimi realizohet përmes ligjeratave me pjesëmarrje fizike dhe online. Trajnimi realizohet përmes detyrave të ndryshme nga trajneret ku kandidatet jane të obliguar që në fund të trajnimit të i përcjellin për vlerësim.<br><br>Për sigurimin e cilësisë së programit praktikohet kjo metodologji e punës:<br><br>• Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese |

| | |
|---|---|
| | • Skedat e daljes<br>• Fletëvlerësimet e pjesëmarrësve<br>• Testimet e vazhdushme në fund të çdo moduli<br>• Vlerësimi |
| **Certifikimi** | **Për certifikim vlerësohen: Portofoli i përgatitur (5 pikë); Vijimi i rregullt i trajnimit** (5 pikë); Vizita në institucione e parapara (5) pikë; Përgjigjet e sakta në test – (30 pikë); punë praktike nga një temë nga praktika e identifikimit të fëmijëve me vështirësi në të nxënë.<br>Pjesëmarrësit u nënshtrohen tre testeve që lidhen:<br>Test mbi njohuritë e nocioneve themelore për nxënës me vështirësi (5 pikë):<br>format e identifikimit 10 pike<br>rast studimor i identifikimit 20 pike .<br>Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të krijojnë portofolin (25 pikë) |
| **Trajner** | • Prof. dr. Saranda Shatri – Doktore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare.<br><br>• Prof. Armen Mustafa – Profesor |
| **Data** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit | Roli i aktiviteteve kreative ne mesimdhenie dhe zbatimi i tyre ne shkolla fillore |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Sindikata e Bashkuar e Arsimit,Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelorë |
| **Ofertuesi i programit:** | SBASHK |
| **Adresa:** | Rr.Agim Ramadani,p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë |
| **E-mail:** | Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org |
| **Telefoni:** | + 383(0) 38 226 940 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr.71/71 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | (orë): 32 |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet mësimdhënësve (mësuesve) që punojnë me Kornizën Kurikulare të Arsimit Parauniversitar.<br>Në këtë trajnim mund të jenë pjesëmarrës edhe përfaqësuesit e MASHTI-t me trajnerë- profesorë universitar ose trajnerë të këtij programi me përvojë mbi 3 vjeçare. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25 - 30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit (mësimdhënësit) arrijnë këto qëllime:<br>• Që aktivitetet kreative të mund t'i përdorin si mjete pedagogjike dhe si ato mund të adaptohen për zhvillimin e njësisë mësimore;<br>• Të mësohen (familjarizohen) me metodologjinë e kreativitetit në procesin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies;<br>• Të dijnë se si t'i përdorin aktivitetet kreative në punën e tyre;<br>• Të aftësohen në zbatimin e aktiviteteve kreative për zhvillimin e njësisë mësimore. |

| | |
|---|---|
| **Përmbajtja:** | Qëllimi i punëtorisë; Organizimi, Roli i Kornizës Kurrikulare ; Konceptet kryesore të të nxënit; Parimet e arsimit parauniverzitar; Përse i përdorim aktivitetet kreative; Kreativiteti; Aktivitetet për ngrohje trupore (aktiviteti kryesor dhe aktiviteti për relaksim);Kushtet gjatë punës; Struktura e aktiviteteve kreative;<br>Si të përfitojmë nxënësit dhe vëzhgimi; Qëllimet<br>Aktivitet për qëllimin e argëtimit dhe relaksimit;<br>Aktivitet për zhvillimin e koncentrimit;<br>Aktivitet për qëllimin e vetëdijesimit fizik dhe aftësitë motorike; Aktivitet për zhvillimin e vetëdijesimit dhe vetëbesimit; Aktivitet për zhvillimin e komunikimit dhe të shprehurit; Aktivitet për qëllimin e fantazisë dhe imagjinatës; |

| | |
|---|---|
| | Aktivitet për zhvillimin e aftësisë dhe të krijuarit. Aktivitete nga fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim; Aktivitete nga fusha kurrikulare: Matematikë; Aktivitete nga fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Aktivitete nga fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi; Aktivitete nga fusha kurrikulare: Artet. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditorë |
| **Certifikimi** | Certifikatë |
| **Trajnerë** | Blerina Haraqija, Lutfije Ibrahimi,Osman Rrustemi, Arberina Hajzeri, Zahide Hamiti Krasniqi, Hata Shala, Jehona Kastrati, Pranvera Haziri, Ahiret Mehmeti, Esengul Dinovci, Hanife Shorra, Blerim Mehmeti, Fadil Latifi, Albina Arifi, Edona Mjekiqi, Remzije Berisha , Nora Ajeti |
| **Data** | 14.07.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **Roli i Busulla.COM në përmbushjen e objektivave për orientimin në karrierë të parapara në Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulat Bërthamë** |
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.64/64, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 8 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna<br>• Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Njohjen me Kornizën Kurrikulare dhe çka parashihet për orientimin në karrierë<br>• Njohjen me rezultatet e parapara nëpër shkallë të ndryshme të KKK për orientim profesional dhe edukim në karrierë<br>• Njohjen me mundësitë e inkorporimit të veglave të Busulla.COM në realizimin e këtyre objektivave<br>• Gjenerimin e raporteve dhe monitorimin e progresit të nxënësve |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br><br>• Njohja me rolin e Busulla.COM në përmbushjen e objektivave të fushës Jeta dhe puna<br>• Shpjegimi i modelit për implementimin e orientimit në karrierë për klasat VI-XII<br>• Zhvillimi i aktiviteteve për edukim dhe orientim në karrierë<br>• Shtjellimi i planit për realizimin e objektivave të edukimit dhe |

| | |
|---|---|
| | orientimit në karrierë në gjimnaze, shkollat e mesme profesionale dhe shkollat e mesme të ulëta<br>• Shtjellimi i rezultateve të shkallës së V-të dhe VI-të të kurrikulës së Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor**<br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% me sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | **Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme tëpunës** |
| **Titulli i organizatës:** | Sindikata e Bashkuar e Arsimit,Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | SBASHK |
| **Adresa:** | Rr.Agim Ramadani,p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë |
| **E-mail:** | Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org |
| **Telefoni:** | + 383(0) 38 226 940 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.70/70, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | (orë): 24 |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet Mësimdhënësve te të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar;Koordinatorëve te cilësisë, pedagogëve dhe psikologëve të shkollës; Drejtorëve të shkollave; |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25 - 30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Qëllimi i përgjithshëm i programit të trajnimit është të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e mësuesve në punën me nxënës për parandalimin e punës së fëmijëve, identifikimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme dhe të ndaluar për fëmijë, tërheqjen dhe riintegrimin e tyre në procesin e të nxënit.<br><br>Programi ka për qëllim mbështetjen e mësimdhënësve për të:<br><br>▪ njohur dhe eksploruar kuadrin e politikave dhe masave për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë dhe eliminimin e punës së rrezikshme dhe të ndaluar për fëmijë;<br><br>▪ kuptuar ndërlidhjen e problemit të punës së fëmijëve me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit;<br><br>▪ zhvilluar idetë dhe orientimet për përmbushjen e rolit të mësimdhënësve në identifikimin dhe referimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme dhe punë të ndaluar;<br>udhëzuar dhe mbështetur mësimdhënësit në realizimin e praktikave të |

| | |
|---|---|
| | mbështetjes.<br>së nxënësve që kombinojnë punën dhe shkollën, apo që janë ri-kthyer në sistem arsimor pas një periudhe të gjatë të braktisjes;<br>▪ nxitur angazhimin të mësimdhënësve në proceset që zhvillohen në shkollë dhe në përmbushjen e rolit të tyre në mësimdhënie, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim.<br><br>Në mënyrë më specifike, pjesëmarrësit e përfshirë në këtë program të trajnimit, përmes diskutimeve dhe angazhimeve në detyra praktike lidhur me gjashtë temat e modulit, do të jenë në gjendje të:<br><br>▪ përshkruajnë problemin e punës së fëmijëve dhe ndërlidhjen e tij me cilësinë e arsimit, nga perspektiva e kuadrit politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe punës së shkollës;<br>▪ identifikojnë format më të këqija dhe të rrezikshme të punës së fëmijëve, barrierat e qasjes në arsim, mundësitë dhe veprimet që mund ti ndërmarrin për ti kontribuar sistemit të mbrojtjes së fëmijës, në bazë të rolit që kanë;<br>▪ përshkruajnë rolin e tyre në identifikimin dhe referimin e fëmijëve që punojnë punë të rrezikshme dhe të ndaluara, mënyrën e kontributit të tyre në referimin e rasteve;<br>▪ përcaktojnë strategji, masa të veprimit për mbështetje të nxënësve që kanë pasoja emocionale dhe psikologjike nga puna që bëjnë;<br>▪ identifikojnë shembuj të mundësive dhe kërkesave të kurrikulës së re që ndihmojnë në adresimin e punës së fëmijëve; |

| | |
|---|---|
| | ▪ zhvillojnë koncepte dhe ide për përfshirjen e problematikës së punës së fëmijëve në kuadër të kurrikulës me zgjedhje, çështjet ndërkurrikulare, veprimtaritë/ aktivitetet jashtëkurrikulare dhe aktivitetet ekstrakurrikulare;<br>▪ përzgjedhin dhe përdorin qasje në mësimdhënie, metoda dhe teknika e mësimdhënies të duhura për zhvillimin e mësimeve që lidhen me punën efëmijëve;<br>demonstrojnë zhvillimin e modeleve të mësimeve që lidhen me punën e fëmijëve; |
| **Përmbajtja:** | Moduli trajnimit: *Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës,* është strukturuar në formatin e një udhëzuesi për realizimin e trajnimeve me mësimdhënës dhe pjesëmarrës tjerë nga shkollat. E gjithë përmbajtja e modulit është strukturuar në gjashtë tema kryesore dhe nëntema, çështje të cilat janë të ndërlidhura në mes vete, referuar qëllimit të modulit dhe përdorimit të tij. Secila nga temat kryesore të këtij modulit të trajnimit, do të trajtohet se paku në një sesion gjatë trajnimit, përfshirë edhe shqyrtimin e detyrave dhe këshillave praktike të zbatimit.<br><br>Temat e modulit dhe çështjet kryesore që trajtohen gjatë trajnimit në kuadër të secilëstemë janë si në vijim:<br>**Temat e modulit**<br>Kuadri i politikave dhe masave për mbrojtjen efëmijëve në Kosovë<br>**Çështjet kryesore**<br>▪ Politikat dhe programet/planet strategjike që referojnë mbrojtjen e fëmijës<br>▪ Konceptet kryesore për mbrojtje të fëmijës<br>▪ Roli i edukimit dhe arsimimit për mbrojtjen e fëmijës;<br>▪ Kategoritë e fëmijëve që kërkojnë vëmendje të veçantë;<br>Faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollës<br>2. Problemi i punës së fëmijëve - kuadri i politikave dhe masave për adresimin e punës së fëmijës;<br>▪ Korniza ligjore mbi punën e fëmijëve<br>▪ Përkufizimi i punës së fëmijëve<br>▪ Format e rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë<br>Sektorët për ndalim të menjëhershëm të punës së fëmijëve në Kosovë |

| | |
|---|---|
| | 3. Problemi i punës së fëmijëve - shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve<br>▪ Problemi i punës së fëmijëve<br>▪ Barriera të qasjes në arsim<br>▪ Shkaqet e punës së fëmijëve<br>▪ Pasojat e punës së fëmijëve<br>Korniza për vlerësimin e mirëqenies psikologjikfëmijëve që punojnë<br>4. Roli i institucioneve arsimore në adresimin epunës së fëmijëve;<br>Qasjet në referimin e punës së fëmijëve në mbështetje të Ligjit për Mbrojtje të fëmijës dhe UA 05/2013<br><br>▪ Kapaciteti i institucioneve arsimore<br>▪ Detyrat dhe përgjegjësitë e komunitetit të shkollës në adresimin e punës së fëmijëve<br>Monitorimi i punës së fëmijëve nga ana e shkollës dhe mësimdhënësve<br>5. Mundësitë dhe kërkesat ekurrikulës që ndihmojnë adresimin e punës së Fëmijëve<br>Qasjet në referimin e punës së fëmijëve në mbështetje të Ligjit për Mbrojtje të fëmijës dhe UA 05/2013<br><br>▪ Kapaciteti i institucioneve arsimore<br>▪ Detyrat dhe përgjegjësitë e komunitetit të shkollës në adresimin e punës së fëmijëve<br>Monitorimi i punës së fëmijëve nga ana e shkollës dhe mësimdhënësve<br>. Mundësitë dhe kërkesat ekurrikulës që ndihmojnë adresimin e punës së Fëmijëve<br>• Kurrikula me zgjedhje<br>• Çështjet ndërkurrikulare<br>• Veprimtaritë/aktivitetet jashtëkurrikulare<br>Aktivitetet ekstrakurrikular<br>6. Adresimi i punës së fëmijëve përmes qasjeve metodologjike të mësimdhënies<br>▪ Paketa e mjeteve didaktike SCREAM<br>▪ Qasjet në mësimdhënie, metodat dhe teknikat e mësimdhënies<br>▪ Planifikimi i mësimeve që kanë në fokus adresimin e punës së fëmijëve<br>Modele të mësimeve që lidhen me punën e fëmijëve |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi i trajnimit zgjatë 3 ditë dhe zhvillohet në formën ku dita e parë dhe e dytë mbahen njëra pas tjetrës ndërsa dita e tretë zhvillohet pas dy ose tri javësh me qëllim që pjesëmarrësit të kenë kohë për kryerjen e detyrave dhe obligimeve për përfundim me sukses të trajnimit. Në mes të ditës 2 dhe 3 organizohet një takim mentorues – mentorim në grup i |

| | |
|---|---|
| | mësimdhënësve. Trajneri i programit takohet me pjesëmarrësit për të ofruar mbështetje në realizimin praktik të detyrave/obligimeve nga moduli i trajnimit |
| **Certifikimi** | Certifikatë |
| **Trajner sa trajner** | Selim Mehmeti, Lindita Boshtrakaj, Besjana Rexhepi, Blerim Mehmeti, Bukurije Krasniqi Zhitija, Dafina Deva, Eliza Dibrani, Fidan Shaqiri, Filloreta Gashi Shala, Flora Sejdiu Abdullahu, Hanife Salihu, Ilirjana Mehmeti, Labearta Selimi, Lumturije Hasanaj, Magbule Rexhepi, Marigonë Bytyçi, Nora(Sahiti) Ajeti |
| **Data e aplikimi** | 14.07.2022 |

| Titulli i Programit: | SHKATHTËSITË E BUTA NË KURRIKULIN SHKOLLOR |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. “Qëndresa”, nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 15/2021 Data: 17.03.2021<br>**Nr. 52/52 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 18 orë trajnimi (4 sesione x 90 min = 6 orë kontaktuese; plus 12 orë të kalkuluara për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të instrumenteve të vlerësimit me nxënës). |
| **Përfituesit:** | Të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Sipas kornizës së kurrikulit për arsim parauniversitar, të gjithë mësimdhënësit do të duhej të kenë njohuri për zhvillimin dhe vlerësimin e gjashtë kompetencave kryesore të kurrikulit, prandaj ky program synon të përfshijë të gjithë mësimdhënësit që janë në shërbim në arsimin parauniversitar e specifikisht atij të mesëm të lartë. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të pajisen me rezultatet si në vijim:<br>• Kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të buta tek nxënësit;<br>• Njohin përshkruesit e shkathtësive të buta dhe treguesit për secilën shkathtësi;<br>• Zbatojnë instrumentet për vlerësimin e shkathtësive të buta (mbajnë librin e shënimeve për vrojtimin e nxënësve gjatë procesit mësimor; përcaktojnë kriteret e suksesit të nxënësit për një detyrë; sigurohen se nxënësit bëjnë vetëvlerësim përmes instrumentit të vetëvlerësimit);<br>• Plotësojnë instrumentet përmbledhëse për vlerësim të shkathtësive të buta të secilit nxënës;<br>• Bashkëpunojnë me kolegët tjerë / vlerësojnë në ekip gjatë plotësimit të instrumeteve përmbledhëse të shkathtësive të buta. |
| **Përmbajtja**: | Programi i këtij trajnimi përmban një pako prej dhjetë ‘shkathtësive të buta’ / ‘shkathtësive për jetë dhe punë’ të cilat lidhen me jetën dhe punën e individit, përmes të cilave do të kontribuohet në zhvillimin e gjashtë kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën e Kosovës. Programi ASSET është i përqendruar në punën me gjimnazet në 16 komunat partnere, por ky material është i përshtatshëm të përdoret edhe për të gjitha shkollat e arsimit |

| | |
|---|---|
| | parauniversitar, sepse ndërlidhet shumë ngushtë me zhvillimin e kompetencave kryesore të kurrikulit gjatë arsimit parauniversitar.<br>Lista e shkathtësive të buta mund të jetë shumë e gjatë, dhe relevanca e tyre mund të jetë e ndryshme në kontekste të ndryshme kohore dhe vendore, por në kuadër të këtij dokumenti janë përzgjedhur për t'u elaboruar vetëm dhjetë prej shkathtësive të buta sepse ndërlidhen më afër me kërkesat e kohës, e ato janë:<br>• Shkathtësia e të menduarit kritik;<br>• Shkathtësia e komunikimit;<br>• Shkathtësia e zgjidhjes së problemeve;<br>• Kreativiteti;<br>• Inteligjenca emocionale;<br>• Ndërgjegjshmëria;<br>• Këmbëngulësia;<br>• Puna ekipore;<br>• Shkathtësia e mbledhjes së informatave (hulumtuese);<br>• Shkathtësia për ndërmarrësi. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Pjesëmarrësit e këtij kursi, do të marrin pjesë në katër sesione (6 orë të plota) të moderuara me fasilitues shkollor, dhe një kohë e shpenzojnë për zbatim të njohurive të kursit me nxënës në klasë, e cila në kuptim kohor është ekuivalente me tetë sesione tjera (12 orë të plota). Kursi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimi ose në mënyrë virtuale nga distanca përmes platformave elektronike. Kjo përfshinë ndërveprim, plane mësimore / projekte mësimore, realizim me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Tërë procesi i trajnimit shtrihet në afat kohor prej 4-6 javësh. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mentorohen dhe observohen në klasë nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim. |
| **Certifikimi:** | Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 18 orë trajnimi (4 sesione x 90 min = 6 orë të plota; plus 12 orë të kalkuluara për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të instrumenteve të vlerësimit me nxënës).<br>Kriteret për certifikim janë:<br>• Së paku 90% pjesëmarrje në sesionet kontaktuese dhe në takimet reflektuese me fasilitues;<br>• Realizimi i instrumenteve të vlerësimit me nxënës sipas udhëzimeve nga kursi;<br>• Prezantimi i raportit të vlerësimit me gojë para fasilituesve dhe pjesëmarrësve të trajnimit. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | SHKATHTËSITË PËR ZHVILLIM PERSONAL |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 22/22 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi i trajnimit organizohet në formën on-line. Pjesëmarrësi regjistrohet për vijimin e programit të trajnimit përmes platformës https://kec-elearning.org/peacock. Trajnimi mund të ndiqet nga pjesëmarrësi njëherësh (pa ndërprerje) ose në sesione të disahershme (me ndalesa), duke iu përshtatur kohës në dispozicion të pjesëmarrësit. Vlerësohet se kursi mund të përmbushet për 20 orë efektive.<br>Programi i trajnimit mund të modifikohet dhe të ofrohet për grupe nga 20-25 veta duke i përdorur të gjitha prezantimet dhe udhëzuesit, për kohëzgjatje të njëjtë gjatë 3 ditëve. |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet, mësimdhënësve, studentëve, pedagogëve, udhëheqësve të shkollave dhe profesorëve të fakultetit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:<br>➢ Të kuptojnë çfarë janë shkathtësitë për zhvillim personal<br>➢ Të kuptojnë shkathtësitë për zhvillim personal janë pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës<br>➢ Të përvetësojnë teknika dhe metoda për të prezantuar shkathtësitë personale sipas udhëzuesve përkatëse<br>➢ Të jenë të gatshëm të shfrytëzojnë materialet online<br>➢ Të jenë të gatshëm për të shpërndarë dijet dhe informacionet edhe tek palët e treta. |
| **Përmbajtja**: | Edukimi për zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë është i inkorporuar në të gjitha lëndët dhe gjithmonë është i ndërlidhur me përmbajtjen mësimore që është relevante për individin në gjendjen e tij momentale të zhvillimit. Përmbajtja dhe detyrat në këtë program të zhvillimit personal janë të dizajnuara dhe synojnë grup mosha dhe klasa të ndryshme nga klasa parafillore deri tek klasa e 9-të . Përgjatë kurrikulës së shkollimit të obligueshëm, mësimi i shkathtësive për jetë bëhet gjithnjë e më kompleks, duke përcjellë tema të ngjashme çdo vit e duke u fokusuar në të njëjtat shkathtësi gjatë gjithë kohës në shkollë.<br>Në këtë program për zhvillim personal, shkathtësitë për jetë mësohen në një |

| | |
|---|---|
| | sekuencë prej pesë modulesh të cilat i përfshijnë konceptet kryesore. Ato janë: Moduli 1 Arti i vetë-njohjes dhe njohjes së të tjerëve" që e thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësit, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.<br>Moduli 2 "Sigurimi i cilësisë së jetës", me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim i mirë i vetes, etj.<br>Moduli 3 Stilet e jetës së shëndetshme" që i udhëzon nxënësit në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, që i kundërvihet shprehive: drogës, alkoolit, duhanpirës, ndikimit gjinor, etj.<br>Moduli 4 "Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse" që thekson të kuptuarit e profesioneve që nga perspektiva e tregut, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes në lidhje me karrierën, opsionin e ndërmarrësisë si karrierë, etj.<br>Moduli 5 "Siguria personale" që i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja për të siguruar sigurinë e tyre personale dhe të të tjerëve. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Për tre ditë trajnimi apo 18 orë, pjesëmarrësit regjistrohen individualisht në platformën https://kec-elearning.org/peacock, ku dhe ndjekin kursin. Pjesëmarrësit duhet të përfundojnë detyrat e paracaktuara për të kaluar në modulin tjetër. |
| **Certifikimi:** | Në fund të këtij programi të trajnimit, pjesëmarrësit do të certifikohen me gjithsej 20 orë trajnimi. Kriteret për certifikim janë:<br>• Përshkrimi i gjithë përmbajtjes së programit të trajnimit (të gjitha temave të të 5 moduleve)<br>• Përmbushja e kërkesave të cilat dalin nga detyrat e programit të trajnimit<br>• Suksesi së paku 80% në reflektimet përgjatë kursit. |
| **Trajnerë:** | 8 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | „Shkolla gjithpërfshirëse që mbështetë arsimimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët e kthyer'' |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Adresa:** | Rr.”MusineKokolari”nr.83,<br>Prishtinë10000,<br>Republika e Kosovës |
| **E-mail:** | institutipedagogjik@gmail.com |
| **Telefoni:** | +383213831 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Akreditim: 21.12.2015<br>Riakreditim: 13.01.2018<br>**Nr.68/68 ,Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Gjithsej janë 81 orë trajnim të bartura në certifikim |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit/et e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 22 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Objektivat kryesore të kurrikulës së trajnimit janë:<br>➢ Rritja e ndërgjegjësimit të mësimdhënësve për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin e nxënësve të tyre, si edhe për rëndësinë e adresimit të çështjeve si diskriminimi, racizmi, përfshirja sociale dhe të kuptuarit ndërkulturor,<br>➢ Ofrimi i metodologjive dhe burimeve me një sfond teorik të qëndrueshëm duke u mbështetur në përvojën e Këshillit të Evropës në këtë fushë, të cilat mund të kenë përdorim praktik në aktivitetet që mund të organizohen në nivel shkolle, bazuar në një qasje që përfshin gjithë shkollën,<br>➢ Krijimi i mundësive për përfshirje aktive të mësimdhënësve në një reflektim kritik në lidhje me praktikat e tyre, në shkëmbimin e përvojave me kolegët dhe në gjenerimin e procesit të qëndrueshëm, demokratik dhe pjesëmarrës të zhvillimit të shkollëssë tyre. |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja e programit dhe aktivitetet qe sigurojnë arritjen e rezultateve të |

programit [Rezultatet dhe përmbajtja e programit të trajnimit për mësimdhënës, duhet ti përgjigjet profilit të kompetencave të mësimdhënësve dhe pasqyres së kushteve për zhvillim profesional dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve, sipas niveleve të karrierës të përcaktuara me Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë (jo më shumë se 200 fjalë)]

Programi i trajnimit të mësimdhënësve ndërtohet mbi tri pjesë bazë të trajnimit, të shpërndara në :

Përmbajtja e trajnimit për PJESËN I

- Hapja, prezantimet, objektivat, rregullat, pritshmëritë, programi,
- Pabarazia sociale, rrënjët e saj dhe pasojat tek fëmijët,
- Roli i shkollave dhe mësimdhënësve në riprodhimin e pabarazisë,
- Racizmi: Diskriminimi direkt, indirekt dhe diskriminimi strukturor,
- Qasja e gjithë shkollës për një shkollë gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore,
- Krijimi i një klase gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore,
- Shembuj të metodave, aktiviteteve dhe masave
- nxënit e bazuar në projekte,
- Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Puna ekipore,
- Detyrat e shtëpisë: Detyrat deri në Pjesën e dytë të trajnimit. Vlerësimi,

Përmbajtja e trajnimit për PJESËN II

- Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe rishikimi i Planeve të Zhvillimit të Shkollës,
- Rishikimi i rasteve studimore për fëmijët e sapoardhur në klasë,
- Nxitja e gjithpërfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinj dhe egjiptianë,
- Ushtrime për të nxënit bashkëpunues gjatë punës me fëmijët e kthyer,
- Ndërgjegjësimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor,
- Mentorimi dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve) ,
- Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve arsimorë në

| | |
|---|---|
| | shkollorë.<br>➢ Bashkëpunimi me ndërmjetësuesit dhe qendrat mësimore<br>➢ Mbyllja e pjesës 2: Detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi<br><br>Përmbajtja e trajnimit për PJESËN III<br>➢ Hapja dhe shqyrtimi i planeve për zhvillim të shkollës dhe aktivitetet në klasë<br>➢ Puna e përbashkët: ”Shtëpia e ëndrrave të mia”<br>➢ Adresimi i çështjeve të evidentuara nga analiza e aktiviteteve shkollore dhe vizitave nëpër shkolla: Planet mësimore<br>➢ Partneriteti online si mjet për arsimim ndërkulturor dhe gjithpërfshirje shoqërore<br>➢ Vlerësimi i aktiviteteve arsimore<br>➢ Si mundet që një vlerësim me pjesëmarrje participuese të mbështesë zhvillimin e shkollës,<br>➢ Mbyllja e trajnimit. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit është një kombinim i :<br>- Ligjerimeve dhe prezantimeve;<br>- Ushtrimeve interaktive, të cilat, në pjesën më të madhe mund të përsëriten ose të përshtaten për përdorim me nxënësit;<br>- Punës grupore;<br>- Punës individuale.<br>Në trajnim i jepet prioritet zbatimit të metodat interaktive dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitetin. Në seancat e fundit të trajnimit jepet hapësirë për t'ju përgjigjur nevojave shtesë specifike të pjesëmarrësve me qëllim të adresimit të temave të tjera të ndërlidhura ose thellimin e atyre temave që janë adresuar/trajtuar tashmë në seancat e mëparshme. |
| **Certifikimi** | |
| **Trajner sa trajner** | Haxhere Zylfiu, Sahare Reçica, Arbneshë Mexhuani, Hajrije Devetaku-Gojani, Luljeta Shala, Skender Mekolli |
| **Data e aplikimi** | 10.06.2022 |

| **Titulli i Programit:** | Shprehitë për Adoleshencën |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Lions International – Lions Club Peja |
| **Tipi i programit:** | Program parandalues |
| **Ofertuesi i programit:** | OJQ Lions Club Peja |
| **Adresa:** | Objekti "Ish Komiteti"pranë administratës komunale - Pejë |
| **E-mail:** | bekimshoshi1@gmail.com |
| **Telefoni:** | 044281858 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr.103/103, datë:10.06.2022<br>**Nr.102/102, datë:13.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 42 orë trajnim i drjtëpërdrejtë, 21 orë detyra dhe projekte, 63 orë për certifikim |
| **Përfituesit:** | Përfitues primar: mësuesit e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët.<br>Përfitues sekondar: drejtorët e shkollave, pedagog dhe psikolog.<br>Perfitues janë të gjithë nxënësit e shkollave dhe mësimdhënësve pjesëmarrës në trajnim. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 24 pjesëmarrës në çdo trajnim |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Rezultatet e programit janë të nderlidhura me katër fazat e mësimdhënies të cilat promovohen dhe zbatohen gjatë tërë programit. Rezultatet janë të strukturuara dhe të planifikuara si më poshtë:<br>FAZA E PARË: TË ZBULUARIT<br>Rezultati: Zbulohet se çfarë dinë që më parë për temën nxënësit. Mësuesi tregon entuziazëm për temën, nxit interesin e nxënësve, dëgjon aktivisht, tregon respekt për këndvështrimet e ndyshme dhe fillon vlerësimin e dijeve të nxënësve mbi temën.<br>FAZA E DYTË: VENDOSJA E LIDHJEVE<br>Rezultati: Ndërlidhja e dijeve ekzistuese me informacionet dhe shprehitë e reja.<br>Përdoren shpjegime të shkurtëra, shembuj dhe/ose demonstrime për të prezantuar dijet dhe shprehitë e reja dhe për të modeluar përdorimin e duhur të tyre. Për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë konceptet përfshihen fletë transparente/diapozitiva, fleta burimore, fleta informative, artikuj dhe tregime.<br>FAZA E TRETË: TË USHTRUARIT<br>Rezultati: Ushtrohen shprehitë e reja nën orientimin e mësuesit dhe reflektim mbi ato çfarë kane mësuar nxënësit.<br>Nxënësit e ushtrojnë informacionin ose shprehinë e re në një kontekst të kuptimtë dhe që ka lidhje me ta. Mësuesi e ndjek me vëmendje veprimtarinë për t'u kujdesur që nxënësit ta kuptojnë informacionin ose |

| | |
|---|---|
| | shprehinë dhe të mund ta përdorin në mënyrë të saktë. Përmes pyetjeve që kërkojnë përpunim në një nivel më të lartë, mësuesi drejton përdorimin e shprehive, integrimin e dijeve dhe përmbledhjen e ideve më kryesore.<br><br>FAZA E KATËRT: ZBATIMI<br>Rezultati: Zbatimi i informacionit dhe/ose shprehisë së re në situata të reja. Përmes shkrimit në ditar, nxënësit mendojnë se si do të përdoreshin konceptet e reja në jetën e tyre. Veprimtari të tjera ofrojnë mundësi të tjera zbatimi dhe diskutime me persona të rritur në familje dhe shkollë. |
| **Përmbajtja:** | Plani i mësimit për " Shprehitë për Adoleshencën" Është një model eklektik i mbeshtetur në punën e një morie studiuesish dhe mësuesish. Ai mbështetet në këto parime mësimore:<br><br>● Mësimi orientohet nga objektivi.<br>Ngaqë nxënësit e presin më mirë mësimin kur e dinë se cili është objektivi i tij, mësuesi u shpjegon objektivin e mësimit dhe arsyet përse po u mëson shprehitë dhe dijet konkrete.<br>● Mësimi e lidh informacionin e ri me dije të mëparshme.<br>Diskutimet dhe veprimtaritë i ndihmojnë nxënësit të vendosin ura lidhëse midis dijeve ekzistuese dhe informacioneve të reja.<br>● Mësimi zhvillohet me faza, por gjithsesi është rekursiv.<br>Organizimi në trajtë spirale e programit mësimor mundëson përsëritjen dhe përforcimin e shprehive dhe dijeve të reja.<br>● Të mësuarit ndikohet nga zhvillimi.<br>Përmbajtja, qasja dhe ritmi i çdo mësimi ndërtohet në atë mënyrë që të plotësojë nevojat e të rinjëve adoleshentë.<br>Në thelb të planit të mësimit qëndron pikëpamja se nxënësit duhen parë si pjesëmarrës aktiv, të cilët e nisin vetë të mësuarit e tyre në mënyrë të natyrshme, duke u mbështetur në kureshtjen e brendshme të tyre. Theksi vihet te ndërveprimi—një element thelbësor i lidhjes së të riut me shkollën (Hawkins, 1999). Të rinjtë punojnë së bashku për të mësuar koncepte, për të ushtuar të menduarit dhe shprehitë sociale dhe për të zbuluar përfitimet që u sjell bashkëpunimi në kuadër të arritjes së qëllimit të përbashkët.<br>Katër fazat e mësimit u japin mundësi nxënësve të mbështeten te dijet dhe përvojat e tyre, të inkorporojnë informacionet e reja, të ushtrojnë ato që mësojnë, të reflektojnë dhe t'i përdorin informacionet dhe dijet e reja në një larmi situatash të reja.<br>Gjatë trajnimit zhvillohen këto module :<br><br>MODULI 1: (Një komunitet i të mësuarit pozitiv) |

| | |
|---|---|
| | MODULI 2: (Zhvillimi personal)<br>MODULI 3: (Zhvillimi social)<br>MODULI 4: (Shëndeti dhe parandalimi )<br>MODULI 5: (Mësim –shërbimi)<br>MODULI 6: (Zbatimi i programit)<br>Dita e shtatë :Çërtifikimi i pjesëmarrësve |
| **Metodat e realizimit të programit** | Modulet e programit sigurojnë informacione bazike lidhur me shtatë temat, ndërlidhjen e tyre me kërkesat e programeve aktuale mësimore (kërkesat kurrikulare) si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel shkolle e klase. Programi trajnues ofrohet gjatë ditëve të fundjavës (kryesisht do të jetë ditën e shtunë) për të mos penguar procesin e rregullt mësimor.<br>Qasja e përzgjedhur ofron mundësi që të gjithë mësimdhënësit e shkollës të jenë të përfshirë, dhe të gjithë së bashku, nën udhëheqjen e një trajneri/fasilituesi, të diskutojnë dhe provojnë ide e forma të ndryshme të zbatimit të temave në mësimdhënien e tyre.<br><br>Kjo mënyrë e punës dhe e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve të shkollës, mundëson shtjellimin e temave të ndryshme profesionale me interes të përbashkët, konsultim formal dhe kolegial të mësimdhënësve si dhe mundësi të avancimit profesional të mësimdhënësve përmes aktiviteteve me bazë në shkollë.<br>Gjithashtu, modulet mund të përdoren për të monitoruar dhe për të mbështetur mësimdhënësit gjatë zbatimit të temave të ndryshme në klasë. |
| **Certifikimi** | Certifikimi bëhet duke u bazuar në kriteret e programit Lions Quest dhe kriteret e trajnimit. Çdo pjesëmarrës duhet të ndjekë me rregull trajnimin shtatë ditorë, të jetë aktiv dhe bashkëpunues me pjesëmarrësit e tjerë gjatë trajnimit, të shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre rreth metodologjive mësimore dhe të përvetësojnë njohuritë e reja nga programi Lions Quest, dhe ato njohuri të jenë në gjendje të i zbatojnë në praktikë gjatë procesit të mësimdhënies në shkollat e tyre. |
| **Trajner sa trajner** | Ulla Sirviö-Hyttinen, Havë Haxhiaj , Gjejlon Begolli. |
| **Data e aplikimi** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Sistemi i monitorimit dhe evaluimit - Sigurimi i cilësisë në shkolla |
|---|---|
| Titulli i organizatës: | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| Tipi i programit: | Program trajnues themelor dhe plotësues |
| Ofertuesi i programit: | Smart Bits |
| Adresa: | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| E-mail: | info@smart-bits.ch |
| Telefoni: | 044168688 |
| Numrat dhe data e akreditimit: | 63/63, 10.06.2022 |
| Kohëzgjatja e programit(orë) | 16 orë |
| Përfituesit: | • Koordinatorët e cilësisë<br>• Punonjësit e administratës së shkollës (sekretaria dhe financat)<br>• Menaxhmenti (drejtori) e shkollës |
| Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim: | 16 |
| Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: | Çdo mësimdhënës dhe punonjës i shkollës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Aftësimin në përdorimin e indikatorëve standard për monitorimin e cilësisë,<br>• Mbledhjen dhe përpunimin e informatave konform indikatorëve te cilesise,<br>• Gjenerimin e raporteve të monitorimit dhe evaluimit të cilësisë. |
| Përmbajtja: | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Të kuptoj rëndësinë e monitorimit dhe evaluimit të indikatorëve të cilësisë<br>• Të dijë t'i përdorë funksionet kyçe të platformës digjitale Busulla.COM për monitorim dhe evaluim të cilësisë<br>• Të krijoj pyetësor për të mbledhur informata për indikatorë të ndryshëm (p.sh. niveli i përmbushjes së pritshmërisë të bizneseve në raport me kurset e ofruara, apo niveli i përmbushjes së pritshmërisë të nxënësve apo mësimdhënësve në raport me materialet mësimore, etj.) |

| | |
|---|---|
| | Të gjenerojnë raporte semestrale, gjysmë-vjetore, vjetore, apo sipas nevojës. |
| **Metodat e realizimit të programit** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor**<br>Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| Titulli i Programit | STANDARDET E FASILITIMIT PËR KRYEFASILITUESIT E TË NXËNIT |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 50/12 Data 26.03.2012<br>Nr. 106/14 Data 06.06.2014<br>Nr. 25/2020 Data 03.02.2020<br>**Nr. 35/35 Data 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet fasilitatorëve shkollorë të cilët tregojnë interesim për t'u bërë kryefasilitatorë. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-24 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë:<br>• Njohuri për Standardet Fasilituese për Zhvillimin profesional, si dhe për shkathtësitë e nevojshme për ta përmbushur rolin e Kryefasilitatorit të të nxënit.<br>• Njohuri rreth sjelljeve dhe qasjeve të fasilitimit efektiv duke punuar në ekip me<br>• qëllim të përkrahjes së Fasilitatorëve shkollor.<br>• Rolin e tyre si Kryefasilitator dhe do të vlerësohen nga kolegët. |
| **Përmbajtja:** | Standardet e Lehtësimit të zhvillimit profesional; Ndikimi i Shkathtësive Relevante; Barazia Gjinore dhe Fasilitimi; Dosja elektornike; Shkathtësitë dhe arti i të Dëgjuarit dhe të Pyeturit; Puna Ekipore dhe Zgjidhja e Konflikteve; Mentorimi për praktika të mësimdhënies cilësore; Sesioni praktik dhe vlerësimi i pjesëmarrësve. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet me mbajtjen e një trajnimi 3-ditor, si dhe mbahet praktikumi gjatë zhvillimit të ndonjë kursi. |
| **Certifikimi:** | Për t'u certifikuar kandidati për Kryefasilitator, duhet të fasilitojë pjesën praktike gjatë zhvillimit të ndonjë kursi dhe të vlerësohet sipas Standardeve Fasilituese për Zhvillimin profesional. Praktika zgjat së paku dy seanca 90 minutëshe. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | STANDARDET E FASILITIMIT TË TË NXËNIT |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 50/12 Data: 26.03.2012<br>Nr. 106/14 Data: 06.06.2014<br>Nr. 25/2020 Data: 03.02.2020<br>**Nr. 36/36 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve që tregojnë interesim për t'u bërë fasilitatorë të të nxënit në shkolla. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-24 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:<br>• Të demonstrojnë njohuri për Standardet fasilituese për zhvillimin profesional, shkathtësitë e nevojshme për ta përmbushur rolin e fasilitatorit shkollor me kolegë për implementimin e risive në mësimdhënie dhe nxënie<br>• Të demonstrojnë njohuri të bazuara në Standardet, shkathtësitë dhe sjelljet e nevojshme për një zhvillim të fasilitimit efektiv të një mësimdhënësi profesional<br>• Të hartojnë planin e punës për bashkëpunimin me kolegët në shkollë me qëllim të arritjes së objektivave të reja të të nxënit të përcaktuara nga kurse të fushave të ndryshme të zhvillimit profesional. |
| **Përmbajtja:** | Ndikimi i Shkathtësive Relevante; Standardet e Praktikave te Fasilitatoreve Shkollore; Të nxënit tek te rriturit; Profesionisti reflektues/Dosja elektronike; Elementet kryesore te Fasilitimit; Shkathtësitë e të Dëgjuarit dhe të Pyeturit; Puna ekipore; Strategjitë themelore të fasilitimit; Roli i Fasilitatorit Shkollor; Gjinia dhe barazia gjinore; Dhënia dhe pranimi i komenteve efektive; Plani i Veprimit. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet me mbajtjen e një trajnimi 3-ditor. Në ditën e tretë mbahet prezantimi i përmbajtjes së një disipline për të cilën është i kualifikuar fasilitatori shkollor. |
| **Certifikimi:** | Pjesëmarrja mbi 90% në trajnim dhe vlerësimi pozitiv i prezantimit të përmbajtjes. |
| **Trajnerë:** | 4 trajnerë |
| **Data e aplikimit:** | 21.04.2022 |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Programit:** | Të Gjithë Lojëtarë Të Gjithë Miq |
| **Titulli i organizatës:** | PLAY International |
| **Tipi i programit:** | Trajnim edukativo-aktive dy ditor (2) për mësimdhënësit. Ky trajnim inovativ, aktiv e përdor sportin si një mjet për të ofruar aktivitete gjithëpërfshirëse. |
| **Ofertuesi i programit:** | PLAY International Kosovo |
| **Adresa:** | Xhelal Mitrovica 47, Prishtinë 10 000 Republika e Kosovës |
| **E-mail:** | info.kosovo@play-international.com |
| **Telefoni:** | +383 44 946 091 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 111/111, Datë: 13.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 15 |
| **Përfituesit:** | Programi është projektuar për mësimdhënësit të nivelit fillor (klasat 1 deri në 5) sidomos të cilët kanë fëmijë me nevoja të veçanta në klasat e tyre.<br><br>Dy kriteret kryesore të këtij trajnimi janë mundësia për të përdorur sallën sportive të shkollës për aktivitetet dhe prania e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë. Prandaj, duhet të aplikojnë vetëm mësuesit që mund të përdorin sallën sportive dhe janë të interesuar të mësojnë aktivitete të adaptueshme që do të përfshinin të gjithë klasën pavarësisht nga nevoja e tyre. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-30 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Ky program trajnimi synon t'i pajisë mësuesit me njohuritë dhe mjetet (1) që do t'u ofrojnë fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara mundësinë për të praktikuar një aktivitet fizik dhe për të luajtur së bashku, (2) për të pasur një mjedis gjithëpërfshirës në klasën e tyre dhe në shkollë, (3) për të mbështetur vetë-zhvillimin e nxënësve të tyre (menaxhimi i emocioneve, vetëbesimin, aftësitë motorike).<br><br>Rezultatet e pritshme për mësuesit:<br>• Mësuesit rrisin njohuritë e tyre për aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen e fëmijëve/personave me aftësi të kufizuara.<br>• Mësuesit rrisin njohuritë e tyre për aktivitetet fizike përfshirëse dhe të përshtatura dhe një metodë për të propozuar përshtatje adekuate.<br><br>• Mësuesit fitojnë njohuri dhe aftësi për të zhvilluar sesione sportive gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura.<br><br>Rezultatet shtesë të pritura për mësuesit:<br>• Mësuesit zbulojnë ose përjetojnë përdorimin e sportit si një mjet për ndryshime shoqërore. |

| | |
|---|---|
| | Rezultatet e pritshme për fëmijët-përfitues të aktiviteteve:<br>• Fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara marrin pjesë në sesione sportive gjithëpërfshirëse.<br>• Mësuesi shprehet se nxënësit e tyre janë më gjithëpërfshirës nga të tjerët; shfaqin sjellje bashkëpunuese.<br>• Mësuesi shprehet se mjedisi i klasës është më i qetë dhe miqësor.<br>• Fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara deklarojnë se i shijojnë aktivitetet.<br><br>Rezultatet e pritura shtesë për fëmijët:<br>• Fëmijët rrisin aftësitë e tyre motorike dhe psiko-sociale; ata rrisin vetëbesimin e tyre. |
| **Përmbajtja:** | Trajnimi ballë për ballë: Gjatë trajnimit mësuesit fitojnë njohuri mbi temat që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen përmes prezantimeve dhe moduleve pjesëmarrëse. Ata mësojnë rreth një modeli përshtatjeje (modeli TURM/TREE) i përdorur për të hartuar dhe zbatuar aktivitete sportive të përshtatura dhe gjithëpërfshirëse. Mësuesit kanë hapësirën të reflektojnë dhe të ndajnë përvojën e tyre në lidhje me këto tema dhe të praktikojnë sesione sportive udhëheqëse në terren. Trajnimi ofron gjithashtu një mundësi për mësuesit që të ndërtojnë një rrjet kolegësh të përkushtuar ndaj ndryshimeve sociale. Ata takojnë mësues nga prejardhje dhe shkolla të ndryshme, ndajnë përvojën e tyre të mësimdhënies dhe përdorimin e sportit si një mjet edukativ.<br><br>Zbatimi i aktiviteteve sportive: Gjatë zbatimit të seancave sportive gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura me fëmijët e shkollave të tyre, mësuesit testojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre në situata të jetës reale. Ata u ofrojnë nxënësve të tyre një hapësirë për të praktikuar sporte, për të luajtur dhe për të bashkëvepruar së bashku pa marrë parasysh aftësitë e tyre. Kjo kontribuon në përmirësimin e mjedisit të klasës dhe marrëdhënieve (bashkëmoshatarë dhe nxënës-mësues) drejt bashkëpunimit dhe pranimit. Duke marrë pjesë në aktivitete sportive që ofrojnë mjedise dhe sfida të ndryshme të lojës dhe duke qenë pjesë e një grupi të aftësive mikse, fëmijët rrisin aftësitë e tyre motorike dhe psiko-sociale; ata rrisin vetëbesimin e tyre. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Numri total i orëve të trajnimit: 15 orë<br><br>- Orët e trajnimit ballë për ballë: 12 orë (2 ditë)<br>Ndër të cilat:<br>Ushtrime në terren: 2 orë |

| | |
|---|---|
| | Teori dhe metodologji (Punëtori): 2 orë 30 minuta<br>Teori dhe metodologji (Prezantime): 2 orë<br>Monitorim dhe vlerësim (organizimi i praktikës në terren, prezantimi i mjeteve, vlerësimi i njohurive, vlerësimi i trajnimit): 3 orë 30 minuta<br>Aktivitete tjera (energizer, transporti në fushën sportive, detyra administrative etj.): 2 orë<br><br>- Zbatimi në terren (gjatë orëve mësimore) me mbikëqyrjen e trajnerëve (përfshirë përgatitjen dhe diskutimin e vlerësimit): 3 orë (1 vizitë monitoruese) |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për të përfunduar me sukses trajnimin dhe për të marrë një certifikatë:<br>- Të trajnuarit duhet të regjistrojnë të paktën 80% të pjesëmarrjes nga orët totale të trajnimit.<br>- Të trajnuarit duhet të zbatojnë të paktën 2 aktivitete në shkollën e tyre. Të trajnuarit përfitojnë nga një vizitë vijuese në terren pas trajnimit. Gjatë vizitës në terren, trajnerët vëzhgojnë dhe mbështesin të trajnuarit teksa ata zbatojnë një nga seancat sportive të programit. Pas aktivitetit, të trajnuarit do të plotësojnë një tabelë vetë-vlerësimi dhe do të diskutojnë me trajnerët të cilët do të ndajnë vëzhgimet e tyre për atë sesion dhe do të japin këshilla teknike për përmirësim.<br>- Të trajnuarit duhet të arrijnë një rezultat minimal në pyetësorin përfundimtar të njohurive. Pyetësori i njohurive mat nëse i trajnuari i ka përvetësuar nocionet kyçe në lidhje me temën e trajnimit. |
| **Trajner sa trajner** | 2 |
| **Data e aplikimi** | Thirrjet për aplikime do të jenë të hapuar gjatë vitit shkollor dhe datat e aplikimit do të shpërndahen në rrjetet sociale të organizatës tonë |

| Titulli i Programit | Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING ) |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | QAPA-Qendra për Avancimin e Perfomancës së Arsimit |
| **Tipi i programit:** | Arsimor |
| **Ofertuesi i programit:** | QAPA-Qendra për Avancimin e Perfomancës së Arsimit |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | info@qapa-ks.org |
| **Telefoni:** | 048-750-751 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr 18/18,Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një(1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi përmban 8 orë / 1 ditë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e karrierës,Mësimdhënës i avancuar |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Në program synohet të përfshihen të gjithë mësimdhënësit që I plotësojnë kushtet dhe në grup trajnimi të ketë jo më shumë se 25 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Mësimdhënësit do të jenë te aftë të:<br>Përdorin platforma të ndryshme online të mësimdhënies<br>Kombinimine mësimdhënies online me atë fizik (face to face)<br>Aplikimin e metodologjive të ndryshme të mësimdhënies përmes platformave online<br>Avancimin e mësimdhenies online (si atraktive për nxënësit dhe studentët)<br>Të përdorin nëpër shkolla platform të ndryshme online të mësimdhënies<br>Të gjejnë dobësitë e metodologjisë adekuate përmes platformave online<br>Të evidentojnë metodologjitë e caktuara që kanë pikë të fortë online aplikimin<br>Të ngriten një hap me lartë drejt digjitalizimit të shkollave dhe procesit mësimor<br>Të gjejnë vështirësi dhe përparësi në arritjen e objektivave të procesit mësimorë përmes platformave online. |
| **Përmbajtja:** | Paltformat online të mësimdhënies do të analizohen dhe kuptohen nën prizën e mësimdhënësve. Duke nxjerr në pah mangësitë, përparësitë dhe të gjitha specifikat e platformave të tilla në procesin e mësimit. Trajnimi siguron qe të ruhen cilësia e procesit të mësimit, dhe arritja e objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br>Mësimdhënësit do të jenë në gjendje që të gjejnë modalitetin e vet të punës për të ofruar veten maksimalisht përmes platformave online. Metodologjia e tyre do të jetë primare edhe në platformat online të mësimdhënies, dhe se ata do të jenë në gjendje që të gjejnë modalitete të punës me metodologjinë |

| | |
|---|---|
| | qe ata e shohin të rrugës dhe të rëndësisë në arritjen e objektivave të procesit të mësimit.<br>Të gjithë mësimdhënësit, profilet e tyre, dhe se te gjitha metodologjitë e tyre gjejne zbatim përmes platoformave online. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me thënien e më sipërme të psikologut të shquar *KurtLevinit.* Gjatë trajnimit 50% e kohës do të jetë punë teorike dhe 50 % e kohës praktike<br><br>Ligjërim<br>Pune individuale dhe Pune ne grupe<br>Studime rasti<br>Demonstrim praktik<br>Diskutim |
| **Certifikimi** | Cdo trajnim do të ketë mentorim nga një përfaqësues i QAPA-s,<br>Pjesëmarresit në trajnime do të reflektojnë për trajnimin përmes pyetësorit qe do të ketë pyetje konkrete për:<br>Saktësinë e trajnimit<br>Mësimdhënësin<br>Metodologjinë e përdorur<br>Diskutimin<br>Pjesëmarrja në diskutim<br>Atraktiviteti i ligjeratës dhe trajnimit<br>Trajneri vlerëson analizën dhe qëndrimin kritik të pjesëmarrësve për rastet e paraqitura si pjesë e ushtrimeve duke vlerësuar qëndrimin kritik për rastet në fjalë. Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 10% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit.<br>Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajnerët zbatojnë me përpikmëri agjendën e parapарë dhe përdorimin e metodologjisë së aplikuar gjatë trajnimit.<br>*Përfshirja aKtive në debat 5%*<br>*Pjesa praktike 15%*<br>*Testi vlerësues 80%* |
| **Trajner** | Besarta Taganoviq PH D cand Kujdes shëndetësor<br>Arben Hysenaj PH D cand Psikologji<br>Blerte Hyseni PH D cand Menaxhim shëndetësor<br>Aferdita Mustafa MSc. Edukim Shëndetësor |
| **Data** | 21.04.2022 |
| | |

| Titulli i Programit | **TË MËSUARIT PËRMES TEKNOLOGJISË – PËRDORIMI I PROGRAMEVE APLIKATIVE** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Adresa:** | rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë |
| **E-mail:** | qeht.konica@gmail.com |
| **Telefoni:** | 049 328 528 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr.75/75, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | 24 orë |
| **Përfituesit:** | 4. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3; 5. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të:<br>1. Ta praktikojnë mësimdhënien përmes përdorimit të teknologjisë;<br>2. Të krijojnë projekte për lëndët mësimore përmes programeve aplikative;<br>3. Të familjarizohen me metodologjinë dhe zbatimin e TIK në mësimdhënie;<br>4. Të krijojnë teste dhe mësime në formë elektronike;<br>5. T’i zotërojnë shkakthtësitë e komunikimi online. |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit të mësimdhënësve *Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative* përbëhet nga 6 module të cilat realizohen në 2 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të teknologjisë në mësimdhënie. Moduli i shtatë përfshin pjesën e monitorimit. |

| | |
|---|---|
| | Dita e parë e trajnimit:<br>Moduli 1: Teknologjia në mësimdhënie;<br>Moduli 2: Mësimi i bazuar në projekte përmes teknologjisë<br>Moduli 3: Mësimi me zgjedhje – përgatitja e projekteve shkollore<br>Dita e dytë e trajnimit:<br>Moduli 4: Puna me aplikacioni dhe krijimi i projekteve;<br>Moduli 5: Të mësuarit përmes teknologjisë dhe mësimi online<br>Moduli 6: Komunikimi online<br>Dita e tretë e trajnimit:<br>Moduli 7: Në këtë modul përfshihet pjesa e monitorimit. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike lidhur me gjashtë modulet e trajnimit dhe temat e përfshira në këto module, ndërlidhjen e tyre me kërkesat dhe nevojat e mësimdhënësve si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm të TIK në nivel klase.<br>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat që lidhen me përdorimin e TIK në klasë. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit.<br>Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës.<br><br>Qasja e përzgjedhur për këtë program të trajnimit ofron mundësi që mësimdhënësit të jenë të përfshirë në aktivitete të përbashkëta, nën udhëheqjen e një trajneri, për të diskutuar e provuar ide e forma të ndryshme të zbatimit të praktikave për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca |
| **Certifikimi** | Certifikimi, 24 orë |
| **Trajner** | Msc. Ersan Hamdiu,Msc. Matej Bushaj |
| **Data** | 28.07.2022 |

| **Titulli i Programit:** | Trajnimi i mësimdhënësve për Orientim, Këshillim në karrierë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | OJQ " ABSM" |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | OJQ " ABSM" |
| **Adresa:** | Rr. "Nëna Tereze" , pn. Gjakovë |
| **E-mail:** | info@abs-k.org, krenare.rizvanolli@abs-k.org |
| **Telefoni:** | +383 44 123 256, +383 44 759 342 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 92/92, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për një (1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 30 orë |
| **Përfituesit:** | Përfituesit:<br><br>• Mësimdhënës fillestar<br>• Mësimdhënës i karrierës<br>• Mësimdhënës i avancuar<br><br>Ky program trajnimi është zhvilluar që t'u shërbejë mësimdhënësve, të shkollave në Republiken e Kosoves, klasa 8 dhe 9 në kontekst të këshillimit dhe klasat 10, 11 dhe 12 në kontekst të vetëpunësimit dhe tranzicionit në vend të punës.<br>Mund t'u shërbejë edhe zyrtarëve për karrierë, pedagogëve brenda shkollave, psikologëve, punonjësve social, të cilët në një formë apo tjetër kanë mundësinë që të japin kontribute për përzgjedhjen e profesionit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 deri në 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarresit do të përfitojnë:<br><br>• Njohuri për karrierën në përgjithësi si shërbim edukativ<br>• Njohuri për orientimin në karrierë, sipas niveleve në sistem arsimor, sipas klasave dhe sipas sektoreve.<br>• Njohuri për vetëpunësim<br>• Teknikat e motivimit të nxënësve për të menduar drejt vetëpunësimit<br>• Levizja nga ideja në veprim praktik për themelimin e biznesit vetanak |
| **Përmbajtja:** | Përmbajtja 4 module:<br>• <u>Këshillimi në karrierë- aspektet e përgjithshme: </u>Çfarë është karriera, Dallimi me orientimin në karrierë, standadet më të reja të këshillimit dhe orientimit në karrierë si dhe mënaxhimi i |

| | |
|---|---|
| | shkathtësive të karrierës.<br>• Karakteristikat e një këshilltari mësimdhënës: Si duhet të respektoje standardet ndërkombëtare dhe të drejtat e fëmijës një mësimdhënës në karrierë, të drejtat dhe obligimet, e drejta për tu këshilluar drejtë.<br>• Analizë: Aktivitetet e shkolles për këshillim dhe orientim në karrierë, Plani vjetor i shkollës për karrierë.<br>• Edukimi dhe Punesimi: Hulumtimi i tregut, Menaxhimi i zhvillimit te karrieres dhe vendimmarrja. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Trajnimi realizohet në formë të 4 moduleve me kohëzgjatje 4 ditore, ku gjithsej përmban 30 orë dhe mbahet përgjatë fundjavave. Çdo ditë e trajnimit përfshin një modul së bashku me aktivitetet relevante dhe ofrohet nga ekspertë trajnerë, me kualifikime superiore akademike dhe përvojë relevante në fushën e këshillimit dhe orientimit në karrierë<br>Dita e parë (1) e trajnimit përfshin testin preliminar ndërsa dita e fundit (4) përfshin testin përfundimtar, vlerësimin e trajnimit si dhe shpërndarjen e çertifikatave. Kriteret për përfundimin e trajnimit përfshijnë pjesëmarrjen aktive gjatë trajnimit, 70% përqind ndjekjen e trajnimit si dhe përfundimin me sukses – 70% të testit përfundimtar.<br><br>Metodologjia e trajnimit mbështetet në parimet dhe kërkesat tjera të kurrikulës duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, punë individuale dhe grupore, diskutime, analiza të materialeve/situatave të dhëna gjatë trajnimit, si dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë në mes të kolegëve. |
| **Certifikimi** | CERTQUA Gjermani<br>Euroguidance, Irlande |
| **Trajner sa trajner** | Për këtë program trajnimi janë të paraparë 4 trajnerë:<br>5. Prof.ass.dr. Besim Mustafa<br>6. Dr.sc. Elmedina Nikoceviq- Kurti<br>7. Malush Tullumi, PhD cand<br>8. Fatos Gashi, MA |
| **Data e aplikimit:** | 21.04.2022 |

| Titulli i programit | Trajnimi i Mësimdhënësve për Parandalim, Identifikim Trajtim apo Referim të Llojeve të Dhunës në Shkollë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | Organizatë joqeveritare |
| **Tipi i programit:** | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në licencim në fushën e parandalimit dhe trajtimit të dhunës në shkollë |
| **Ofertuesi i programit:** | Syri i Vizionit |
| **Adresa:** | Rruga Isa Demaj Nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@syriivizionit.org |
| **Telefoni:** | 039 423 240/ 044 111 408 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 107/107 Datë: 10/06/2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit (orë)** | Dy vite: Trajnimi për mësimdhënës do të jenë njëditorë, respektivisht numri i orëve të programit trajnues do të jetë shtatë (7) orë (09:00 -16:00). |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 25– 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | - Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të përfshira në trajnime ka rënë numri i dhunës ndaj nxënësve;<br>- Mësimdhënësit në shkollat e përfshira në trajnime kanë njohuri për identifikim, parandalim, trajtim apo referim të dhunës ndaj nxënësve;<br>- Rritet siguria në shkollë dhe është krijuar një mjedis miqësor për nxënësit;<br>- Mësimdhënësit janë në gjendje të:<br>• Ofrojnë një përkufizim për dhunën;<br>• Tregojnë së paku katër shembuj të llojeve të dhunës në shkollë<br>• Radhisin shkaktarët potencialë të dhunës në shkollë<br>• Shpjegojnë pasojat e llojeve të dhunës tek nxënësit<br>• Ofrojnë të paktën nga dy strategji për parandalim, identifikim, trajtim apo referim të rasteve të dhunës |
| **Përmbajtja:** | Ky modul/program do t'u shërbej mësimdhënësve për të përparuar të kuptuarin e tyre në identifikimin dhe intervenimin e hershëm mbi dhunën në shkolla dhe synon t'i ngritë njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve për krijimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e një mjedisi shkollor pa dhunë, të sigurt dhe miqësor për nxënës.<br>Në këtë program trajnues përfshihen çështjet kyçe:<br>o Çfarë është dhuna? |

| | |
|---|---|
| | ○ Disa përkufizime të saj.<br>○ Dhuna në shkolla – specifikat.<br>○ Cilat janë llojet e dhunës?<br>○ Çfarë e shkakton dhunën në shkollë – faktorët.<br>○ Kë prek dhuna në shkollë?<br>○ Cilat janë pasojat e dhunës në shkollë?<br>○ Si mund ta parandalojmë dhunën në klasë/shkollë?<br>○ Sa ka rëndësi marrja parasysh e pikëpamjeve të fëmijëve për të identifikuar format e parandalimit të dhunës mbështetur në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve . |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e përdorur është e përzier:<br>- Përmban ofrimin e informacioneve të qarta dhe të sakta rreth përmbajtjes së koncepteve kyçe të temës qendrore të udhëzuesit në formë të fletushkave informative [one-page handouts];<br>- Ofron video prezantuese të rasteve specifike të dhunës në shkolla;<br>- Ofron lojë në role për t'i vendosur mësimdhënësit në 'lëkurën' e individit që ushtron ose përjeton dhunë;<br>- Ofron strategji të cilat mësimdhënësit do t'i 'lidhin' me rastet e veçanta në trajnim;<br>- Përmban diskutime të lehtësuara me qëllimin kryesor të kuptuarit e përbashkët, ndarjen e rasteve por njëkohësisht edhe të ideve për identifikim apo trajnim të rasteve të veçanta të ofruara;<br>- Përmban dy forma të vlerësimit të punëtorisë, me qëllim të sigurimit të informacionit për planifikimin dhe organizimin dhe njëkohësisht për efektivitetin e përmbajtjes së trajnimit. |
| **Certifikimi** | Të gjithë pjesëmarrësit do të certifikohen. Certifikata është e aprovuar së bashku më modulin e programit. |
| **Trajner sa trajner** | PhD Mimoza Shahini Dr. Ph Adelina Pronaj dhe MsC Ema Skeja |
| **Data e aplikimit** | 19 Prill 2022 |

| **Titulli i Programit:** | Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave profesionale për punë me të rritur. |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Tipi i programit:** | Bazik |
| **Ofertuesi i programit:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Adresa:** | Musine Kokololari , Nr. 83. Prishtinë 10.000 |
| **E-mail:** | institutipedagogjik@gmail.com |
| **Telefoni:** | 0383213831 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 115/14--- 10.09.2014<br>**Nr. 69/69,Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 120 orë trajnim |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e shkollave të mesme profesionale |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 mësimdhënës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | • Të kuptojnë parimet bazë të andragogjisë.<br>• Të shpjegojnë karakteristikat kryesore të të nxënit te të rriturit<br>• Të interpretojnë parimet bazë të të nxënit ndërveprues te të rriturit<br>• Të identifikojnë stilet e të nxënit te të rriturit<br>• Të praktikoj,<br>• Të pajisen me shkathtësi të mësimdhënësit në punën me të rriturit<br>• Të kontribuojnë në rritjen e cilëssië së reflektimit të vijuesve<br>• Të zbatojnë detyra hulumtuese<br>• Të pajisen me shkathtësi organizative në mësim gjatë të nxënit ndërveprues<br>• Të përdorin modele të ndryshme trajnimi në punën me të rriturit<br>• Të zhvillojnë trajnime me të rriturit mbështetur në kompetencat themelore të trajnerëvejnë të nxënët nga përvoja<br>• Të kuptojnë konceptet themelore të kurrikulës<br>• Të përdorin modelet kurrikularë në planifikimin e punës me të rriturit<br>• Të zbatojnë në renditjen hierarkike konceptet: objektiva, rezultatet dhe standarde<br>• Të pajisen me shkathtësi për projektimi e programeve mbi të nxënët ndërveprues<br>• Të vlerësojnë një program trajnimi në punën me të rriturit<br>• Të fitojnë dije për konceptet themelore të matjes dhe kontrollit<br>• Të përdorin lloje të ndryshme të vlerësimit, formues dhe përmbledhës |

| | |
|---|---|
| | • Të zbatojnë vlerësime të dy llojeve, objektive dhe subjektive<br>• Të përdorin forma të ndryshme të vlerësimit përmes dosjeve<br>• Të vlerësojnë nivelin e performancës në programe të ndryshme me të rriturit<br>• Të fitojnë njohuri për teorinë dhe praktikat e të nxënit elektronik<br>• Të kuptojnë mekanizmat e funksionimit të mësimit në distancë<br>• Të përdorin kompjuterat në programet e të rriturve<br>• Të zbatojnë konceptet e edukimit mediatik në botën digjitale<br>• Të përdorin të nxënët elektronik si mjet për motivimin e vijuesve në program |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit përmban pesë Module:<br><br>**1.** Metodat Andragogjike<br>**2.** Roli i mësimdhënësve për punën me të rritur<br>**3.** Aspekte të dizajnimit të planprogramit<br>**4.** Vlerësimi i të rriturve<br>**5.** E-learning në arsimin e të rriturve<br><br>Përmbajtja e programit:<br><br>**Parimet e andragogjisë**<br>Përvoja<br>Gatishmëria për të nxënë<br>Orientimi drejt të nxënit<br>Motivimi<br>**Si mësojnë të rriturit**<br>Karakteristikat e të nxënit te të rriturit<br>**Origjina e teorive të të nxënit te të rriturit**<br>**Të nxënët aktiv dhe ndërveprues midis të rriturve.**<br>**Parimet bazë**<br>**Stilet e të nxënit te të rriturit**<br>Çfarë janë stilet e të nxënit?<br>Stilet e të nxënit sipas teorisë së përvojës<br>Stilet e të nxënit sipas Honey dhe Mumford<br>Katër kategoritë e të nxënit nga përvoja<br>**Metodat e trajnimit për stilet e të nxënit**<br>Të nxënët veprues përgjatë programit<br>Të nxënët nga përvoja ose shërbimi<br>**Trajnimi në vendin e punës**<br>**Identifikimi i stileve të të nxënit**<br>**Shkathtësitë që duhet të ketë një mësimdhënës** |

Tri kategori themelore dhe kompetenca bazë
Kompetencat teknike
Kompetencat profesionale
Kompetencat personale
**Metoda të përshtatshme për punën me të rriturit**
Prezantimi i metodave
Si edukohet reflektimi
Si matet rritja e cilësisë së reflektimit të vijuesve?
Kritere per vlerësimin e niveleve të reflektimit
Hulumtimi i zgjeruara
Si organizohet auditori gjatë mësimdhënies për një të nxënë veprues
**Modele të trajnimit në programet e arsimimit të të rriturve**
Si nxënë vijuesit:
Formulimi i parimeve themelore
Konstruktivizmi
Si të zgjidhim këtë problem?
Të nxënët metakognit
Të shkruarit për të nxënë
Edukimi për përgjegjësinë shoqërore
**Matja dhe vlerësimi**
Arsyet pse bëhet vlerësimi
**Aspekte të ndryshme të vlerësimit**
**Vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës**
Testimi objektiv
Testimi ese
**Vlerësimi në shërbim të të nxwnit**
Dosjet dhe ekspozitat
Vlerësimi i dosjeve dhe i performancave
Vlerësimi i produktit-vlerësimi i procesit
Vlerësimet informale
**Teoria e të nxënit elektronik (eLearning)**
Personalizimi
Ndërveprimi
Pavarësia gjeografike dhe kohore
Funksionimi i mësimit në distancë
**Të nxënët në një botë digjitale**
Kompjuterat dhe të rriturit
Edukimi mediatik/digjital
**Shfrytëzimi i teknologjisë**
Mësimdhënia në internet
**Të nxënët elektronik dhe motivimi**

| | |
|---|---|
| **Metodat e realizimit të programit** | Realizimi i programit do të fokusohet në kombinim të metodave të punës me pjesëmarrës. Kryesisht do të realizohen prezantime (leksione dhe PP prezantime), punë e orientuar në tema të caktuara (punë individuale dhe grupore), diskutime, debate, pyetje-përgjigje, punë kreative, luajtje e roleve etj. Puna e realizuar me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë (në trajnim) do të plotësohet edhe me aktivitete hulumtuese( internet, literaturë, media, etj) të pjesëmarrësve për tema të caktuara të modulit. Gjithashtu pjesëmarrësit do të angazhohen në realizimin e detyrave praktike (punë individuale, në çifte ose punë grupore), rezultatet e të cilave do të mentorohen nga trajneri në periudhën mes ditës së dytë dhe të tretë të trajnimit dhe do të prezantohen para grupit të madh në ditën e tretë të trajnimit. |
| **Certifikimi** | Sipas Legjislacionit |
| **Trajner sa trajner** | Tre trajnerë |
| **Data e aplikimi** | 20. 04. 2022 |

| Titulli i Programit: | TRAJNIMI I TRAJNERËVE PËR PUNË ME TË RRITUR |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 28/28 ,Datë: 10.06.2022**, **Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi prezantohet në formë të trajnimit treditor me gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program i dedikohet të gjithë profesionistëve të cilët do të angazhohen si trajner me punë me të rritur. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit do të:<br>• Përzgjedhin dhe japin shembuj të përdorimit të metodave të përshtatshme të të nxënit aktiv dhe të strategjive gjatë trajnimeve në të cilat ata referojnë.<br>• Japin shembullin e tyre duke përdorur në seminar paraqitjeje atraktive dhe interesante, që merr parasysh interesat dhe nevojat e pjesëmarrësve, si dhe të drejtuesve të tjerë.<br>• Lidhin parimet me praktikën, duke dhënë shembuj të vërtetë nga fusha përkatëse.<br>• Ndajnë me kolegët e tyre përgjegjësitë e drejtimit dhe paraqitjes në trajnim.<br>• Tregojnë aftësi në planifikimin e përmbajtjes së trajnimit si dhe anës logjistike.<br>• Parashikojnë, nxisin dhe të përgjigjen me efektivitet dhe saktësi pyetjeve për parimet dhe strategjitë e programeve tajnuese.<br>• Kuptojnë stadardet dhe kërkesat që duhet të ketë një trajner cilësor |
| **Përmbajtja**: | Manuali i trajnimit ka të përcaktuara temat të cilat shtjellohen në trajnim, siç janë: Puna me të rritur - Roli i trajnerit si ekspert i dhe zotërues i aftësive dhe shkathtësive të prezantimit. Parimet dhe stilet e të nxënit tek të rriturit. Zhvillimi i një analize trajnimi. Qëllimi dhe objektivat trajnuese. Metodat e mësimit tek të rriturit. Ndërtimi dhe përdorimi i mjeteve efektive gjatë trajnimit. Zhvillimi i një plani të trajnimit. Karakteristikat e një trajneri të suksesshëm. Listë kontrolli për një trajnim të suksesshëm. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Të gjithë pjesëmarrësit marrin informata dhe materiale për trajnerin cilësor. Pastaj të ndarë në dyshe përgatisin dhe paraqesin një seancë, ku gjatë kësaj kohe |

| | |
|---|---|
| | vlerësohen për rolin e tyre si trajner.<br><br>Disa standarde që duhet t'i arrijnë trajnuesit e certifikuar janë:<br>• Puna e tyre tregon se kanë kuptuar lidhjen midis parimeve të të nxënit të të rriturve dhe praktikave të mësimdhënies, që përbëjnë thelbin e të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik.<br>• Tregojnë aftësi shumë të mira organizuese.<br>• Rregullojnë ambientin sipas kërkesave të trajnimit<br>• Demonstrojnë aftësi ndër personale shumë të suksesshme dhe të përshtatshme për të punuar me të rriturit.<br>• Vlerësojnë me efektivitet dhe këshillojnë në mënyrë profesionale pjesëmarrësit e trajnimeve<br>• Trajtojnë nevojat dhe zhvillimin e tyre profesional dhe ndajnë njohuritë dhe aftësitë e tyre me të tjerët.<br>• Mbajnë standarde dhe etikë të lartë profesionale |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin për trajner është përcjellja me rregull e kursit mbi 90% si dhe vlerësimi pozitiv për demonstrimin e aftësive të trajnerit. |
| **Trajnerë:** | 6 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Trajnimi për kompetencat e edukatorëve që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 26/2018 Data: 29.06.2018<br>**Nr. 33/33, Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një seminari 3-ditor dhe ka gjithsej 24 orë |
| **Përfituesit:** | Ky program iu dedikohet edukatorëve, drejtorëve, pedagogëve inspektorëve dhe zyrtarëve komunale institucioneve parashkollore dhe klasave përgatitore. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | • Njohjen e koncepteve të përgjithshme të<br>• kompetencave të edukatorëve<br>• Aftësi për të planifikuar punën duke ju përshtatur nevojave dhe<br>• interesave të fëmijëve dhe familjeve të tyre<br>• Shkathtësi për të vëzhguar dhe vlerësuar fëmijët sipa<br>• potencialit të tyre zhvillimor<br>• Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që<br>• nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko- social, fizik, shoqëror, gjinor<br>• Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtë<br>• për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë<br>• Aftësi për organizimin e mësimit bashkëpunues që nxit<br>• bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm<br>• Shkathtësi për përdorimin e pyetësorit për vlerësimin apo<br>• vetëvlerësimin e edukatores<br>• Shkathtësi për përdorimin e data-bazës për përpunimin e të<br>• dhënave nga pyetësori<br>• Aftësi për të planifikuar masa të cilat do të përmirësojnë cilësinë e punës |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit është i ndarë në 12 sesione që zhvillohen si punëtori |

| | |
|---|---|
| | tre ditore dhe përfshijnë 4 sesione në ditë. Gjatë ditës së tretë pjesëmarrësit duhet të zhvillojnë vizitë monitoruese në një klasë parashkollore apo përgatitore<br>Trajnimi është i konceptuar ashtu që:<br><br>Ditën e parë pjesëmarrësit kuptojmë parimet themelore të kompetenca të edukatoreve të cilat punojnë me grup-moshat 3-6, si dhe marrin informata rreth krijimit të tyre dhe procesit të njohjes së kompetencave nga MASHT Po ashtu arrijnë të kuptojnë dhe analizojnë bazën e shtatë fushave të kompetencave te edukatorit:<br>1 Ndërveprimet<br>2 Familja dhe komuniteti<br>3 Përfshirja, diversiteti dhe vlerat e demokracisë<br>4 Planifikimi dhe vlerësimi<br>5 Strategjitë e mësimdhënies<br>6 Mjedisi i të nxënit<br>7 Zhvillimi profesional<br><br>Ditën e dytë pjesëmarrësve u shpërndahet instrumenti i vlerësimit me të cilin gjatë ditës analizohet dhe diskutohet deri në detaje. Po ashtu paraqitet edhe data- baza elektronike të cilën e praktikojnë në formë elektronike<br><br>Ditën e tretë bëhet zbatimi i monitorimit në një klasë parashkollore apo përgatitore. Pas përfundimit të monitorimit zhvillohet intervista me edukatoren e monitoruar dhe pastaj bëhet plotësimi i instrumentit vlerësues dhe analizohen rezultatet. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Programi i trajnimit ka pjesën teorike dhe praktike, që zhvillohet gjatë 12 sesione, të përfshira në tre ditë.<br>Dy ditët e para me metoda interaktive dhe punë grupor pjesëmarrësit mësojnë rreth dallimit të treguesve të kompetencave. Po ashtu ushtrojnë edhe përdorimin e data-bazës elektronike.<br>Ditës e tretë zhvillohet pjesa praktike në një klasë apo dhomë -pune, ku paraprakisht merret leja nga shkolla apo I.P për të ushtruar instrumenti i vlerësimit. Pjesëmarrësit individualisht plotësojnë instrumentin e vlerësimit dhe më pas në grupe nga 3-4 veta diskutojnë për rezultatet të cilat i kanë vlerësuar. Qëllimi i këtij ushtrimi është të krijohet një besueshmëri e të kuptuarit dhe vlerësimit të kompetencave. Pasdite të dhënat nga instrumenti i vlerësimit futen në data-bazë ku pjesëmarrësit mësojnë si të lexojnë të arriturat dhe çka mund të bëjnë me këto të dhëna. |
| **Certifikimi** | 24 orë trajnimi |
| **Trajner sa trajner:** | 9 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | Udhëheqja e Institucioneve Arsimore në Kosovë |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) |
| **Tipi i programit:** | Plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) |
| **Adresa:** | Rr. “Martirët e Gjilanit”, nr. 17, 60000, Gjilan |
| **E-mail:** | ngo.kcic@gmail.com |
| **Telefoni:** | +38344177320 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Numër:105/105, Datë:13 qershor 2022,Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Një (1) vit |
| **Përfituesit:** | Përfitues janë të gjithë të interesuarit që janë të ndërlidhur me çështjen e arsimit si mësimdhënësit e shkollave fillore (niveli 1-5), mësimdhënësit e shkollave të mesme të ultë (niveli 6-9), mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta (niveli 10-12) dhe të gjithë të tjerët që janë të ndërlidhur me punën në arsim, si bie fjala zyrtarët e drejtorive komunale të arsimit. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Maksimum 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Programi Trajnues “Udhëheqja e Institucioneve Arsimore në Kosovë”, është një ofertë për të gjithë punëtorët arsimorë që të aftësohen që të drejtojnë në mënyrë të suksesesshme institucionet arsimore në Kosovë.<br><br>Qëllimi i këtij programi është të ndihmohen drejtorët e tanishëm dhe të gjithë ata që pretendojnë të drejtojnë një institucion edukativo-arsimor, për të përmbushur më së miri standardet që duhen për të kryer detyrën e drejtorit.<br><br>Programi trajnues ofrohet si një tërësi e ndarë sipas temave dhe të grumbulluara sipas seminareve, ditëve të trajnimit për secilin seminar, udhëzimeve të udhëzuesit për trajner dhe agjendës ditore të secilës ditë të trajnimit. Pjesëmarrësit në seminare pra, përfitojnë në mënyrë specifike njohuritë themelore dhe aftësitë për të drejtuar dhe menaxhuar institucionet arsimore në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet themelore zyrtare.<br><br>Objektivat e trajnimit, sipas këtyre seminareve, janë: |

| | |
|---|---|
| | 1. Analiza, shpjegimi dhe përpunimi i aspekteve lidhur me Arsimin në Kosovë dhe gjithëpërfshirja në arsim - Baza ligjore; fushave të cilësisë së zhvillimit shkollor, gjithë përfshirjes si faktor kryesor në sigurimin e edukimit cilësor për të gjithë dhe rolit të udhëheqjes në edukimin cilësor;<br>2. Përfitimi i njohurive dhe shkathtësive për përmirësimin e përformancës së punës së shkollës duke u mbështetur mbi parimet e një Mësimdhënia cilësore dhe mësimnxënia; të lidhura me standardet e cilësisë, hapat e vlerësimit të cilësisë së tanishme të arsimit dhe zhvillimin e vizionit afatgjatë së bashku me mësimdhënësit, prindërit, Këshillin drejtues të Shkollës;<br>3. Ngritja e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për Përgatitjen dhe Menaxhimin e Projektit; në të gjitha fazat e zhvillimit të tij – nga identifikimi I problemit e deri te faza finale e përfundimit të projektit;<br>4. Ofrimi i mbështetjes së drejtorëve të shkollave në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës; përmes një qasje praktike për planifikim të bazuar në modelin e ndërtuar ne tre hapa konkret;<br>5. Kujdestaria e klasës dhe aktivet profesionale - Komunikimi dhe bashkëpunimi në shkollë; nxit një qasje affirmative në komunikimi dhe bashkëpunimin efektiv dhe të suksesshëm në mes të udhëheqjes së shkollës, personelit mësimor (kujdestarëve të klasave), nxënësve, organizatave rinore shkollore, prindërve dhe grupeve tjera të interest;<br>6. Analiza, shpjegimi dhe përpunimi i aspekteve lidhur me bazat e Udhëheqjes e Menaxhimit të Personelit; si dhe në lidhje me masat dhe hapat e planifikimit, monitorimit dhe menaxhimit të personelit.<br>7. Administrimi i dokumentacionit shkollor dhe organizimi i takimeve; ndihmon në “shkollën” e organizimit të takimeve dhe në kuadër të kësaj udhëzimet lidhur me plotësimin dhe sistemimin e dokumentacionit shkollor, nga faza inicuese e deri te arkivimi.<br><br>Pjesëmarrësit që do të ndjekin këtë program trajnues pritet që të i arrijnë rezultatet themelore si në vijim:<br>1. Zhvillojnë të kuptuarit bazik për natyrën e ndryshimit,<br>2. Fitojnë dije që do të lehtësojë ngritjen e praktikave të udhëheqësisë,<br>3. Kuptojnë thelbin se çka është edukimi cilësor,<br>4. Kuptojnë dhe dinë rolin e rëndësishëm të drejtorëve të shkollave,<br>5. Identifikojnë sfidat e sigurimit të arsimit të cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët në Kosovë, |

| | |
|---|---|
| | 6. Kuptojnë rolin qendror të mësimdhënies dhe nxënies,<br>7. Njoftohen me rolin udhëheqës të menaxhimit arsimor për edukim cilësor në shkollë,<br>8. Fillojnë të identifikojnë dhe kuptojnë sfidat specifike në shkollën e tyre,<br>9. Udhëheqjen e procesit të kërkimeve duke respektuar ndryshimet e obligueshme,<br>10. Zbatojnë rregulloret e shkollës në tërësi duke bërë ndërlidhjen e të gjitha grupeve të interest;<br>11. Rritja e bashkëpunimit të kujdestarit në komunikime me prindër dhe mënyra e udhëheqjes së takimeve;<br>12. Identifikimi i sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për gjithpërfshirje të nxënësve;<br>13. Aplikimi i formave të plotësimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit pedagogjik; |
| **Përmbajtja:** | Programi Trajnues përmban shtatë (7) seminare:<br>1. Arsimi në Kosovë dhe gjithëpërfshirja në arsim – Baza ligjore;<br>2. Mësimdhënia cilësore dhe mësimnxënia;<br>3. Përgatitja dhe menaxhimi i projektit;<br>4. Plani zhvillimor i shkollës;<br>5. Kujdestaria e klasës dhe aktivet profesionale – Komunikimi dhe bashkëpunimi në shkollë;<br>6. Udhëheqja dhe menaxhimi i personelit dhe<br>7. Administrimi i dokumentacionit shkollor dhe organizimi i takimeve.<br><br>Secili seminar do të zgjasë nga tri (3) ditë, nga 8 orë në ditë, që në total janë 21 ditë trajnimi apo gjithsej 168 orë trajnim. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues bazohet në:<br>• Ligjërata dhe komente të shkurta gjatë diskutimeve – për të nxitur pjesëmarrësit;<br>• Informata kthyese ose reagimet e pjesëmarrësve – duke u përgjigjur ose duke ofruar sugjerime apo komente sipas nevojës;<br>• Video sekuenca – Pjesë të shkurta dhe të zgjedhura mirë nga CD-të ose video vegëzat, mund ti ilustrojnë çështjet për diskutim të mëtejmë apo prezantime lidhur me studime të rastit për punën e mëtutjeshme të grupit;<br>• Loja e roleve ne grupe – iu mundëson pjesëmarrësve qe ti praktikojnë aftësi dhe ti përjetojnë aktivitet, duke ofruar përvoja të mira të situatave jetësore reale dhe ti mësojnë konceptet; |

| | |
|---|---|
| | • Puna grupore, në çifte, grupe të vogla ose të mëdha, detyrat dhe prezantimi i tyre – Ilustron çështjen duke iu mundësuar pjesëmarrësve qe ti shërbejnë idetë përvojat dhe pikëpamjet si dhe ta thellojnë kuptimin e tyre të detyrës dhe temës së grupit punues;<br>• Seanca plenare – këtu shkëmbehen informatat dhe qëndrimet në një grup të tërë, pjesëmarrësit mund të inkurajohen që të kontribuojnë duke parashtruar komentet, reagime ose pyetje; |
| **Certifikimi** | Për të siguruar cilësinë e programit trajnues do të aplikohen këto kuota të vlerësimit të trajnimit të cilat duhet të i sigurojë vijuesi në mënyrë që të konstatohet se me sukses e ka përfunduara këtë Program Trajnimi:<br>1. Vijueshmëria e pjesëmarrësit në trajnim duhet të jetë së paku 90% e ditëve të trajnimit ose shprehur në ditë, së paku 19 ditë nga 21 sa janë në kuadër të Programit Trajnues<br>2. Angazhimi gjatë punëtorive në trajnim, sipas seminareve<br>3. Prezantimi i detyrave konkrete/ studime rasti dhe dosja e pjesëmarrësve. Të obligueshme janë tri detyra:<br>• Përgatitja e një Projekt-propozimi bazuar në një problem të identifikuar brenda shkollës ku punon vijuesi i trajnimit<br>• Përgatitja e Planit Zhvillimor të Shkollës (PZhSh) në të cilën punon vijuesi trajnimit<br>• Përgatitja e planit vjetor, dymujor dhe javor për Kujdestarinë e Klasës, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës. |
| **Trajnerët** | Organizata ka rekrutuar 12 trajnerë të cilët janë sprovuar tanimë me angazhime konkrete në teren e të cilët kanë qenë po ashtu të kyçur në përgatitjen e këtij Programi Trajnues.<br><br>Në të kaluarën, këta trajnerë kanë pasur angazhime konkrete anë e mbanë Kosovës – kanë realizuar Programin Trajnues “Udhëheqja në Arsim”, që është realizuar nga organizata e jonë dhe është monitoruar nga organizata gjermane GIZ. |
| **Data e aplikimit** | 29 korrik 2022 |

| **Titulli i Programit:** | Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Tipi i programit:** | Program themelor i trajnimit |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime ‘’KONICA’’ |
| **Adresa:** | rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë |
| **E-mail:** | qeht.konica@gmail.com |
| **Telefoni:** | +393 49 328 528 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 76/76, Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy (2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 50 orë |
| **Përfituesit:** | 5. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3;<br>6. Koordinatorët e cilësisë nga shkollat dhe DKA;<br>7. Pedagog shkolle;<br>8. Drejtorë shkollash;<br>9. Zyrtarë të DKA-ve dhe anëtarë të ekipeve profesionale të DKA-ve. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pjesëmarrësit do të:<br>▪ Përforcojnë informatat bazë për konceptet: kontroll, matje dhe vlerësim;<br>▪ Diskutojnë dhe njihen me standardet e vlerësimit dhe me kompetencat e mësimdhënësve në fushën e vlerësimit të nxënësve;<br>▪ Hulumtojnë konceptet kyçe të vlerësimit dhe qasjet e ndryshme të vlerësimit të nxënësve;<br>▪ Zhvillojnë kompetencat për proceset, metodat dhe strategjitë për vlerësimin e nxënësve;<br>▪ Zhvillojnë aftësi për zhvillimin e instrumenteve për vlerësim formativ dhe vlerësim përmbledhës;<br>▪ Përcaktojnë drejtë qëllimet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve;<br>▪ Praktikojnë qasje të ndryshme të vlerësimit të nxënësve varësisht prej qëllimit dhe rezultateve të nxënit, të cila shpien në mbështetjen e të nxënit të nxënësve;<br>▪ Përgatiten për zbatimin efektiv të vlerësimit të nxënësve sipas |

| | |
|---|---|
| | kurrikulës së bazuar në kometenca |
| **Përmbajtja:** | Programi i trajnimit të mësimdhënësve Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, përbëhet nga pesë module të cilat realizohen në 6 ditë trajnimi. Modulet 1,3,4 dhe 5 kanë nga një ditë trajnimi, ndëra moduli 2 ka dy ditë trajnimi të drejtëpërdrejtë më mësimdhënës. Secili modul, përfshirë edhe detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të vlerësimit.<br>**Moduli 1.** Të kuptuarit e vlerësimit, standardeve të vlerësimit dhe kompetencave në fushën e vlerësimit<br>**Moduli 2.** Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca<br>**Moduli 3.** Vlerësimi formativ dhe vlerësimi përmbledhës<br>**Moduli 4.** Metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit<br>**Moduli 5.** Planifikimi i vlerësimit |
| **Metodat e realizimit të programit** | Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat që lidhen me vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit.<br>Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës. |
| **Certifikimi** | |
| **Trajner sa trajner** | 1. Selim Mehmeti<br>2. Diana Qarkaxhija |
| **Data e aplikimi** | 28.07.2022 |

| Titulli i Programit: | Vlerësimi i potencialit dhe interpretimi i rezultateve të testeve të vetë-njohjes |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor - plotësues |
| **Ofertuesi i programit:** | Smart Bits |
| **Adresa:** | Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë, Kosovë |
| **E-mail:** | info@smart-bits.ch |
| **Telefoni:** | 044168688 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr.59/59,Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për dy(2) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 16 orë |
| **Përfituesit:** | • Mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 16 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Interpretimi i rezultateve të testeve IVAP-it (interesave, vlerave, aftësive dhe potencialit).<br>• Ofroj këshilla nxënësve për ndërlidhjen e profesioneve me rezultatet e IVAP-it dhe testeve të potencialit<br>• Të shpjegoj instrumentet e IVAP-it per orientim ne karriere<br>• Të kuptoj relevancën e këtyre instrumenteve dhe të dijë të komunikoj të njëjtën.<br>Të dijë përgjigjet në pyetjet më të shpeshta të parashtruara. |
| **Përmbajtja:** | Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:<br>• Perdorimi i platformës Busulla.COM<br>• Njohja me testin e IVAP-it<br>• Si janë të ndërlidhura pyetjet e këtyre testeve me profesionet e ndryshme<br>• Çfarë do të thotë nëse një përdorues ka % të lartë në një kategori të testit e % të ultë në një kategori tjetër?<br><br>Interpretimi i suksesshëm i rezultateve të testeve per orientim ne karriere. |
| **Metodat e realizimit të** | • **Kombinimi i proceseve të të mësuarit personal dhe grupor** |

| | |
|---|---|
| **programit** | Pjesëmarrësit do të inkurajohen për të zhvilluar një Plan Personal të Zhvillimit si bazë për planifikimin dhe vlerësimin e mësimit të tyre individual, të ndërlidhur me kompetencat që ata duan të zhvillojnë më tej, ndërsa në në të njëjtën kohë duke ndjekur një proces të të mësuarit në grup.<br>• **Pjesëmarrësit në qendër**<br>Vijuesit e trajnimit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, duke i shndërruar ata në bashkë-menaxhues dhe negociues së bashku me instruktorët e tyre të trajnimit dhe me bashkë-vijuesit e tyre; duke e rritur kështu ndërgjegjësimin dhe vetëdijen, dhe duke pasur përgjegjësi në marrjen e vendimeve.<br>• **Orientimi në projekte**<br>Mësimet e orientuara në projekte i shërbejnë shumë qëllimeve: ndihmojnë në zhvillimin e përvojës praktike, por po ashtu projekte e zhvilluara në kuadër të programeve të trajnimit janë iniciativa konkrete të klientit (në këtë rast të shkollave dhe MASHT) për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës/arsimit.<br>• **Integrimi i evaluimit në procesin mësimor**<br>Evaluimi i programeve trajnuese dhe procesit mësimor të organizatës sonë, merr një pozicion neutral në raport me të gjithë akterët e këtyre proceseve dhe kërkon një pajtim pozitiv të të gjitha pikëpamjeve dhe praktikave. Qëllimi i evaluimit të proceseve tona është përmirësimi I vazhdueshëm i cilësisë së programeve tona trajnuese dhe shërbimeve tona.<br>• **Kombinimi i metodave të ndryshme të mësimit**<br>Programet tona të trajnimit kombinojnë metoda të ndryshme për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin drejt realizimit të objektivave të trajnimi: aktivitete për formimin e grupeve, grupet reflektive, ushtrimet simuluese, grupet diskutuese, metodat e vet-njohjes, planet e zhvillimit personal, mentorimi, sesionet e zhvillimit të projekteve, hulumtimet, vlerësimet dhe testimet, punëtoritë, aktivitete outdoor, loja e roleve, grupet në mbështetje të kolegëve, komuniteti virtual, methoda e vlerësimit, etj. |
| **Certifikimi** | Certifikate e kompetencave (75% sukses në provim) |
| **Trajner sa trajner** | 7 |
| **Data e aplikimi** | 29.03.2022 |

| **Titulli i Programit:** | **VLERËSIMI PËR TË NXËNË** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 108/2019 Data: 24.10.2019<br>**Nr. 51/51 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi ka 24 orë trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë të plota; plus 6 orë të kalkuluara për implementimin e aktiviteteve në shkollë gjatë procesit të reflektimit /mentorimit). |
| **Përfituesit:** | Të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Sipas kurrikulës bërthamë të këtij niveli të gjithë mësimdhënësit do të duhej të kenë njohuri për VpN, prandaj ky program synon të përfshijë të gjithë mësimdhënësit në marrëdhënie pune në arsimin e mesëm të lartë. Numri i pjesëmarrësve nuk është i kufizuar, por varësisht nga interesimi, do të synohet që të gjithë mësimdhënësit të kalojnë nëpër këtë trajnim. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të jenë në gjendje të:<br>• Dallojnë vlerësimin formativ/vlerësimin për të nxënë (VpN), nga vlerësimi sumativ/përmbledhës;<br>• Shqyrtojnë elementet, parimet dhe karakteristikat e VpN, dhe rolin e tij në procesin e të nxënit të nxënësve;<br>• Shqyrtojnë ciklin e VpN-së dhe strategjitë e këtij lloj vlerësimi;<br>• Zhvillojnë aftësitë për zbatim të strategjive të VpN për aftësitë komunikuese, shqyrtimin e informacionit, planifikim strategjik dhe arsyetimin kritik;<br>• Reflektojnë për implementimin e teknikave të VpN (përparësitë, vështirësitë dhe sfidat) në klasat e tyre;<br>• Zbatojnë strategjitë e VpN për vlerësimin e 'shkathtësive të buta' (shkathtësitë për jetë dhe punë);<br>• Planifikojnë mësime modele që përshijnë aktivitete me bazë vlerësimin për |

| | |
|---|---|
| | të nxënë. |
| **Përmbajtja**: | Ky program ka për bazë Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Standardet e Vlerësimit, Kodin e Etikës së Vlerësimit, UA (08/2016) për vlerësimin e nxënësve dhe me aktivitetet tjera për ngritjen profesionale të mësimdhënësve. Në pjesën e parë të kursit, pjesëmarrësit njoftohen me llojet e vlerësimit, elementet dhe parimet e vlerësimit për të nxënë, dhe strategjitë e zbatimit të vlerësimit. Pastaj, në pjesën e dytë vazhdojnë me vlerësimin e ndërsjellë, përdorimin e informatave kthyese, dhe njoftohen me planifikimin e mësimeve duke patur për bazë vlerësimin për të nxënë.<br>Ndërmjet ditës së dytë dhe të tretë, pjesëmarrësit mentorohen në klasë duke zbatuar teknikat e VpN në orën mësimore me nxënës, dhe marrin këshilla dhe sugjerime se si duhet të arrijnë të priturat e kursit. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht nga grupi i synuar, do të marrin pjesë në punëtori 3 ditore, secila ditë me nga 4 sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. Kjo përfshinë mësimdhënie ndërvepruese, prezantime, diskutime, punë individuale, punë në dyshe, punë në grupe, etj. Pas ditës së dytë të trajnimit do të ketë hapësirë kohore prej së paku 3-4 javësh për të zbatuar VpN me nxënësit e tyre dhe gjatë kësaj periudhe do të mentorohen dhe observohen në klasë nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim. |
| **Certifikimi:** | Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 24 orë të plota trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë; plus 6 orë të plota të kalkuluara për implementimin e aktiviteteve në shkollë dhe gjatë procesit të reflektimit /mentorimit).<br>Kriteret për certifikim janë:<br>• 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;<br>• Prezantimi i produktit final të realizuar me nxënësit duke dokumentuar të gjitha strategjitë dhe teknikat e realizimit të vlerësimit për të nxënë sipas udhëzimeve nga kursi.<br>• Prezantimi me gojë para fasilituesve dhe pjesëmarrësve të trajnimit. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit:** | Zhvillim profesional për mësimdhënës të gjuhës angleze |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | **Peace Corps Kosovo (Korpusi i Paqes Kosovë)** |
| **Tipi i programit:** | Trajnim dy-ditor me pjesëmarrje të përbashkët të mësimdhënësve të gjuhës angleze dhe vullnetarëve amerikan të Korpusit të Paqes |
| **Ofertuesi i programit:** | Peaece Corps Kosovo |
| **Adresa:** | Peace Corps Kosovo, Perandori Justinian, Nr. 114 & 116, 10000 Prishtinë |
| **E-mail:** | kosovo@peacecorps.gov, ekiserialo@peacecorps.gov hhalimi@peacecorps.gov; |
| **Telefoni:** | +383 49 820 700; +383 49 816 100 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | **Nr. 115/115, Datë:13. 06. 2022, Programi aprovohet për një(1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 9 orë |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e gjuhës angleze të shkollave fillore dhe të mesme të cilat bashkëpunojnë me vullnetarë amerikanë të Korpusit të Paqes ne kuader te programit TEFL |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 30 pjesëmarrës |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në përfundim të trajnimit si dhe përgjatë aplikimit të njohurive të reja:<br>Pjesëmarrësit do të demonstrojnë praktika efektive të mësimdhënies të cilat inkorporojnë njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme të mësimdhënies dhe përfshijnë elemente të mësimit të gjuhës angleze si dhe do të akomodojnë dallimet në kulturat arsimore.<br><br>Pjesëmarrësit do të demonstrojnë strategjitë dhe modelet e bashkë-mësimdhënies dhe bashkë-planifkimit në klasë në kuader të kontekstit aktual kosovar. Ata do të identifikojnë modelet e bashkë-mësimdhënies që janë më të përshtatshmet për lloje të ndryshme të aktiviteteve në klasë për të nxitur zhvillimin profesional të mësuesve, arritjet e nxënësve dhe angazhimin e komunitetit në shkolla<br>Pjesëmarrësit do të zhvillojnë korniza mësimore dhe materiale mësimore, si dhe mënyra për t'iu qasur, organizuar dhe ruajtur ato që u përgjigjen nevojave të studentëve;<br><br>Pjesëmarrësit do të demonstrojnë strategjitë e menaxhimit të klasës duke diskutuar teknika të ndryshme dhe duke ofruar sugjerime për përmirësimin ose përshtatjen e strategjisë së menaxhimit të klasës. |

| | |
|---|---|
| | Pjesëmarrësit do të demonstrojne mënyrat dhe benefitet se si të mësuarit me nxënësin në qendër ndryshon nga të mësuarit tradicional. Ata gjate punes ne grupe do të zhvillojne aktivitete origjinale sipas konceptit "pjesemarrje nga të gjithë".<br><br>Pjesëmarrësit do të demonstrojnë të kuptuarit e mendimit kritik duke vënë në dukje sfidat e përbashkëta në mësimin e të menduarit kritik, duke ofruar shembuj që përforcojnë nevojën për të menduarit kritik dhe vendosjen e një konteksti të rehatshëm për të menduar rreth mënyrës së mësimit të të menduarit kritik.<br><br>Pjesëmarrësit do të demonstrojnë shkathtësi në mësimdhënie në klasa me nxënës të niveleve të ndryshme të njohurive gjuhesore me qëllim të përmbushjes së nevojave specifike grupore apo individuale për mësimxënie të nxënësve në klasë. |
| **Përmbajtja:** | Ky program trajnimi implementohet si program dy ditor i përbërë nga 12 sesione 45 minutëshe që në total permblidhen në 9 orë (60 min) trajnim.<br>Temat e sesioneve të trajnimit të cilan u ofrohen pjesëmarrësve:<br>Moduli 1: Menaxhimi i klases (90 Min)<br>Moduli 2: Bashkë-mësimdhënia dhe bashkë-planifikimi në kontekstin kosovar I (90 min)<br>Moduli 3: Bashkë-mësimdhënia dhe bashkë-planifikimi në kontekstin kosovar II (90 min)<br>Moduli 4: Mendimi kritik (90 min)<br>Moduli 5: Mësimdhënia në klasa me nivele te ndryshme shkathtësish – Instruksione për diferencim (90 min)<br>Moduli 6: Mësimdhënia me nxënësin në qendër (90 min)<br><br>Modulet përqëndrohen në trajnimin e mësimdhënësve të gjuhës angleze së bashku me vullnetarët e Korpusit të Paqes për të ngritur efektivitetin e mësimit ekipor dhe përmirësimin e kualitetit te mësimdhenies në klasë. Ky trajnim organizohet në nëntor te vitit 2022 dhe parasheh pjesemarrjen e përbashkët të mësimdhënësve kosovar dhe vullnetarëve amerikanë të Korpusit të Paqes.<br>Parashihet që mësimdhënësit e gjuhës angleze dhe vullnetarët që punojnë së bashku të zbatojne mësimin dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimit në klasat e tyre ne fusha te ndryshme te mesimdhenies ne kontekstin aktual, duket filluar qe nga bashke-planifikimi dhe bashke-mesimdhenia, ngritja e shkathtesive te mendimit kritik e deri te ngritja e njohurive dhe shkathtesive digjitale si dhe mesimdhenia e kombinuar me prezencë fizike |

| | |
|---|---|
| | ne klase dhe mesimi online etj.<br><br>Ky trajnim mes tjerash u ofron mësimdhënësve dhe vullnetarëve mundësinë për të reflektuar mbi përvojat e tyre te meparshme, krijon hapesire për të diskutuar metodat, teknikat dhe aftësitë efektive per perdorim në klasë. Gjithashtu trajnimi mundëson diskutim rreth sfidave, si dhe siguron hapësirë për të adresuar pyetjet ose çështjet nga përvoja e praktikës në klasë. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Gjate ketij programi trajnues pjesemarresit do te angazhohen nëpërmes një kombinimi të metodologjive te cilat kryesisht mbështeten në teknika të ndryshme të punes grupore, në çifte apo edhe individulale.<br><br>Stafi trajnues angazhon pjesëmarrësit me detyra të ndryshme praktike në perfundim të të cilave ata reflektojnë dhe shkëmbejnë pervojat e tyre nëpërmes diskutimeve te natyrës komunikative dhe interaktive mes pjesemarrësve.<br><br>Kjo metodologji bazohet në faktin se ajo u mundeson pjesëmarrësve shkëmbim te pervojave me te mira ne mes te mesimdhenesve amerikan dhe atyre vendor. Si rezultat kjo u ndihmon atyre ne ngritjen e shkathtesive te ndryshme te cilat kane te bejne me zoterimin e dinamikes se teknikave te ndryshme te mesimdhenies, ngritjen e aftesive kreative per zhvilimin e materialeve shtese mesimore, ngritjen e kualitetit te procesit të planifkimit te njesive mesimore si dhe aktiveteve të ndryshme të ndërlidhura me procesin e mesimdhenies së gjuhes angleze.<br><br>Përgjate gjithë trajnimit pjesëmarresit angazhohen nëpër aktivitete nëpërmes te cilëve ata ngarkohen me detyra specifike të cilat janë të ndërlidhura me përmbajtjen e moduleve të trajnimeve me qëllim ëe përvetësimit të njohurive dhe shkathtësive te reja dhe aplikim tyre gjatë procesit të mësimdhënies në shkollë. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrëseve u ofrohen certifikata pas përfundimit të trajnimit. Certifikatat nënshkruhen dhe vulosen nga përfaqësuesit respektivë të Peace Corps Kosovo dhe MASHTI. |
| **Trajner sa trajner** | 1 trajnere + 3 ndihmës trajnerë |
| **Data e aplikimi** | Tetor 2022 – Organizata nikoqire shpërndan ftesat per pjesëmarrje në trajnim për të gjithë mësimdhënësit e gjuhës angleze nga shkollat të cilat aplikojnë për bashkëpunim me Vullnetarët e Korpusit të Paqes. |

| Titulli i Programit: | ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË LEXIMIT NË KLASAT E HERSHME |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48., Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 77/13 Data 12.06.2013<br>Nr. 127/2015 Data 29.06.2015<br>Nr. 134/2015 Data 21.12.2015<br>Nr. 85/2018 Data 12.11.2018<br>**Nr. 30/30 Datë: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor, si dhe bëhet zbatimi praktik në shkollë nga mësimdhënësit. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve të shkollave fillore të cilët dëshirojnë të përfitojnë nga ky program pune që fokusohet në zbatimin e teknikave dhe strategjive për të përmirësuar shkathtësitë e shkrim-leximit te nxënësit e klasave të hershme. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:<br>• Të kuptojnë fazat e zhvillimit të shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijëve të moshave të reja;<br>• Të dallojnë komponentët e shkrim-leximit dhe t'i lidhin ato në procesin e zhvillimit të shkathtësive gjuhësore te nxënësit;<br>• Të përvetësojnë strategji dhe teknika për ngritjen e shkathtësive të nxënësve për vetëdijen fonemike, fonetikën, dëgjim-kuptimin, lexim-kuptimin, rrjedhshmërinë dhe fjalorin;<br>• Të identifikojnë llojet e vështirësive që nxënësit hasin në lexim dhe të përvetësojnë strategji për t'u ndihmuar atyre nxënësve;<br>• Të praktikojnë teknika të krijimit të librave, për të ushqyer shkathtësitë e të shkruarit te nxënësit;<br>• Të demonstrojnë shkathtësi për të analizuar aspektet gjinore dhe koherencën shoqërore<br>• në tekstet shkollore dhe librat tjerë për fëmijë;<br>• Të analizojnë mënyra të ndryshme për angazhimin e prindërve në zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit te fëmijëve të tyre. |
| **Përmbajtja:** | Shikim i përgjithshëm për shkrim-leximin; Vlerësimi i leximit në klasat e hershme (EGRA); Dëgjim-kuptimi; Vetëdija fonemike/tingullore; Fonetika; |

| | |
|---|---|
| | Rrjedhshmëria; Fjalori; Lexim-kuptimi; Të shkruarit; Nxënësit me vështirësi në të lexuar; Aspektet gjinore në literaturë; Përfshirja e prindërve. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet mbajtjes së një trajnimi 3-ditor si dhe bëhet realizimi i aktiviteteve praktike me nxënës në shkollë. |
| **Certifikimi:** | Pjesëmarrja mbi 90% në trajnim dhe realizimi i së paku 5 planeve mësimore me teknikat/njohuritë e përfituara nga kursi. |
| **Trajnerë:** | 4 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| Titulli i Programit: | ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË SHEKULLIT 21 NË LËNDËN E MATEMATIKËS |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) |
| **Adresa:** | Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë |
| **E-mail:** | office@kec-ks.org |
| **Telefoni:** | 038/244-257, lok. 109 |
| **Numrat dhe data e akreditimit:** | Nr. 72/13 Data: 03.04.2013<br>Nr. 126/2015 Data: 29.06.2015<br>**Nr. 21/21 Data: 10.06.2022, Programi aprovohet për tri(3) vite** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | Programi organizohet në formë të një trajnimi 3-ditor, si dhe bëhet zbatimi praktik në shkollë nga mësimdhënësit. Programi ka gjithsej 24 orë. |
| **Përfituesit:** | Ky program u dedikohet mësimdhënësve të shkollave fillore dhe mësimdhënësve të matematikës të shkollave të mesme të ulëta. |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | 20-25 |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:<br>• Kuptojnë procesin e hulumtimit në matematikë<br>• Kuptojnë strategjitë sipas Polyas për zgjidhjen e problemeve<br>• Kuptojnë për hulumtimet e reja në lidhje me zhvillimin e fëmijëve dhe zhvillimin e trurit<br>• Organizojnë aktivitete në klasë për të zgjeruar të kuptuarit e numrit tek nxënësit<br>• Organizojnë probleme praktike në klasat e tyre<br>• Shpjegojnë konceptet matematikore nëpërmjet shembujve konkretë nga përditshmëria jonë<br>• Mësojnë disa lojëra që mund të ndërlidhen me njësitë përkatëse nga matematika<br>• Njihen me punën e kalkulatorit dhe programeve kompjuterike (Geogebra, Excel, Logo)<br>• Njihen me disa burime të rëndësishme në internet<br>• Kërkojnë, përmes makinave të kërkimit, për burime të tjera të informacionit, e që lidhen drejtpërdrejt me punën e tyre të përditshme në shkollë. |
| **Përmbajtja:** | Kompetencat kryesore të Kurikulës së re dhe shkathtësitë e shekullit 21; Çka është matematika : Disa sfera të përditshme jetësore në të cilat gjen zbatim matematika, dhe strategjitë për zgjidhjen e problemeve sipas Polyas; Matematika Moderne dhe Shiriti i Mobiusit; Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe Fjalori i matematikës; Numrat (1-5) dhe (6-9); Matematika në jetën reale dhe lojërat; Kalkulatorët dhe përdorimi i tyre; Puna me projekte dhe |

| | |
|---|---|
| | Excel; Geogebra dhe FMS Logo; Përdorimi i kompjuterit dhe burimet në internet. |
| **Metodat e realizimit të programit:** | Programi realizohet mbajtjes së një trajnimi 3-ditor si dhe bëhet realizimi i aktiviteteve praktike me nxënës në shkollë. |
| **Certifikimi:** | Kusht për certifikimin është përcjellja me rregull e kursit treditor me së paku 90% të orëve të trajnimit, realizimi i së paku pesë planeve mësimore duke përdorur njohuritë e fituara në kurs, dhe dokumentimi i punës në dosjen profesionale të mësimdhënësit e cila në fund verifikohet me nënshkrim nga drejtori i shkollës. |
| **Trajnerë:** | 5 trajnerë |
| **Data e aplikimit** | 21.04.2022 |

| **Titulli i Programit** | **Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit në arsimin fillor** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës** | EDUMEN-K Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë |
| **Tipi i programit:** | Themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | EDUMEN-K |
| **Adresa:** | Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | edumen.rks@gmail.com |
| **Telefoni:** | 048751752 |
| **Numrat dhe data e aprovimit:** | **Nr. 10/10, Datë:10.06.2022, Programi aprovohet për një(1) vit** |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 16 orë në total: 10 orë në auditor dhe 6 orë praktikë në institucione arsimore 9-vjeçare opsionale. Pra nëse kemi mësim fizik, do të kemi edhe mentorim, përndryshe na mbetet vetëm trajnim teorik |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit mentor. Arsyeja e zgjedhjes së këtij grupi bëhet për arsyen se ky grupacion mësimdhënësish, me përvojën e tyre këshillojnë, mbështetin dhe inkurajojnë një ose më shumë mësimdhënës me më pak përvojë. Këta mësimdhënës pas trajnimit, kanë mundësi të ndajnë shkathtësitë dhe përvojat personale e profesionale të fituara, për të ndihmuar në avancimit më tej të zhvillimit të të menduarit kritik tek nxënësit në arsimin fillor |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Rezultatet e pritshme në këtë trajnim mund ti listojmë si më poshtë:<br>1. Mësimi i nxënësve si t'i qasen në mënyrë kritike secilës lëndë e bën atë më relevante për ta.<br>2. Përftimi i aftësive nga mësuesit sesi tu ndihmojmë nxënësve të mendojnë në mënyrë kritike – të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë në mënyrë të sinqertë, t'i dëgjojnë të tjerët dhe t'i analizojnë mendimet duke u bazuar në fakte.<br>3. Përdorimi i strategjive dhe metodave mësimdhënëse që e nxjerrin fëmijën "jashtë kutitsë" dhe nxisin mendimin e tij krijues për çështje nga më të ndryshmet. |
| **Përmbajtja:** | Programi i këtij trajnimi parashihet si një mundësi më shumë për nxitjen e mendimit kritik dhe krijues tek nxënësit në moshë të hershme të shkollimit të tyre, siç është arsimi fillor. Programi i |

| | |
|---|---|
| | trajnimit synon gjithashtu, të aftësojë mësimdhënësit, të ndërmarrin më shumë iniciativë me qëllim që të kuptojnë vetë dhe të përcjellin tek kolegët dhe nxënësit e tyre, definiconin se: Mendimi kritik është modalitet i të menduarit që është i qartë, racional, i hapur dhe i informuar në bazë të dëshmive. Përfshin shkathtësi të të menduarit të nivelit të lartë si analiza, vlerësimi dhe krijimi. i parë në këtë këndvështrim, mësimdhënësit mentor, shikohen si të duhurit, në pikëpamjen e përgatitjes profesionale, që mund të shërbejnë si transmetues të kësaj filozofie të re mësimdhënie. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Ky trajnim do të mbështetet në metodologjinë demonstruese. Në këtë trajnim do ti jepet përparësi zbatimit të metodat ndërvepruese dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitet, mbi mundësitë që na jep programi PISA, për të përmirësuar punën tonë në procesin mësimdhënies dhe mësimnxënies. |
| **Certifikimi** | Kandidatët të cilët ndjekin me rregull gjithë programin e trajnimit vlerësohen në përfundim të trajnimit me testim |
| **Trajner** | Prof. Dr. Ndricim Mehmeti<br><br>Prof. dr. Saranda Shatri – Doktore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare.<br><br>Prof. Dr. Anila Beshaj |
| **Data** | 21.04.2022 |